

Gjuha shqipe

Rita Petro
Natasha Pepivani

(lexim, të folur, të shkruar, njohuri për gjuhën)

Për klasën e 4-t të shkollës 9-vjeçare

4



Botime shkollore Albas

Me vendim Nr. më datë të Ministrisë së Arsimit
dhe Shkencës së Maqedonisë, lejohet përdorimi i këtij teksti në shkollë.

Botues:

Latif AJRULLAI

Rita PETRO

Konsulent shkencor:

.....

Redaktore:

.....

Recensente:

.....

Arti grafik:

Eva KUKALESHI

Ilustruese:

Ledia KOSTANDINI

Kopertina:

Ledia KOSTANDINI

© Albas, 2009

Shtëpia Botuese Albas

Në Tiranë: Rr. Budi, Pall. "Clasic Constuction", zyra n. 2

Tel/Fax: ++ 355 4 2379184

e-mail: albas_tr@yahoo.com

Në Tetovë: Rr. Ilindenit, nr.105

Tel: 044 344047

e-mail: albas_te@yahoo.com

Në Prishtinë: Rr. Eqrem Çabej, nr.47

Tel: 038 5457139

e-mail: albas_pr@yahoo.com



Kriteret e hartimit të tekstit

Teksti është ndërtuar me katër rubrika kryesore, në të cilat materiali mësimor është grupuar sipas tematikës së pjesëve:

1. Unë mësoj nga të rriturit, ku përfshihen pjesë me tema nga jeta e përditshme e fëmijëve dhe marrëdhëniet e tyre me të rriturit. Varësisht prej kësaj teme janë zgjedhur lloje tekstesh të tilla, si: tregime realiste, përshkrime të mjediseve të përditshme (në fshat e në qytet) ditarë, letra etj., si dhe janë shpjeguar elemente të strukturës së tekstit tregimtar, si: hyrja, zhvillimi, mbyllja, tema dhe ideja (mesazhi) etj.

2. Unë mësoj nga miqtë e mi, ku përfshihen pjesë me tematikë nga marrëdhëniet shoqërore që japin mesazhe të miqësisë së pastër, të mirëkuptimit, të mbështetjes për fëmijët në nevojë, të paqes e barazisë dhe të të drejtave të njeriut, veçanërisht të fëmijëve. Varësisht prej kësaj tematike janë zgjedhur lloje tekstesh të tilla, si: shkrimi i revistës, mesazheve, letrave, ditarit, postës elektronike etj. Gjithashtu, në këtë rubrikë përfshihen pjesë me tema që lidhen me lojërat e fëmijëve, aventurat dhe udhëtimet e tyre në vende reale dhe imagjinare.

3. Unë mësoj nga natyra, ku përfshihen pjesë që sjellin imazhet e katër stinëve të vitit me bukurinë e peizazheve të tyre si dhe veprimtaritë e ndryshme të njerëzve. Në këtë rubrikë mbizotëron shkrimi përshkruar, i cili synon të gërshetojë tingujt, aromat dhe ngjyrat. Gjithashtu qëllimi i rubrikës është kultivimi i dashurisë për natyrën dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e saj.

4. E shkuara në përralla e tregime, ku përfshihen përralla gojore dhe të shkruara nga shkrimtarë, si përralla me princër, me kafshë e me figura fantastike, fabula etj. Nëpërmjet tyre studiohen elemente të strukturës së përrallave, analizohen personazhet, duke zbërthyer moralin apo mesazhin që ato sjellin, si dhe tërhiqet vëmendja e nxënësve të figuracioni i tyre, i cili i lihet nxënësit që ta kuptojë dhe ta zbërthojë në mënyrë intuitive. Gjithashtu, në këtë rubrikë ka legjenda, shkrime të llojit historik, që sjellin personazhe e ngjarje të vërteta historike. Në këtë rubrikë sillen informacione për figura të shquara të Rilindjes Kombëtare, trajtohet shkrimi biografik e autobiografik, tekste në dialekt, fjalë të urta etj.

Ndërmjet këtyre rubrikave integrohet dhe **Rubrika e poezive**, e cila sjell poezi të llojeve të ndryshme sipas tematikave përkatëse.

Njohuritë gjuhësore në tekst janë integruar me pjesët letrare dhe joletrare si dhe me ushtrime për të folurin, të shkruarin dhe të dëgjuarin. Në mungesë të mjeteve elektronike, ushtrimet e të dëgjuarit parashikohen të lexohen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kërkohet të plotësojnë testin e të dëgjuarit.

Një nga synimet kryesore të hartimit të tekstit është rimarrja e njohurive pothuaj në të gjithë librin, ku i kërkohet nxënësit që të krahasojë pjesët të ndryshme për të zbuluar të përbashkëtat dhe të veçantat e llojeve të shkrimit. Nëse deri në klasë të tretë nxënësi më tepër është ushtruar në të lexuar e në të kuptuarin e tekstit, tani i kërkohet që të dallojë elemente të veçanta të tekstit, si: titullin, autorin, temën, idenë, zhvillimin e ngjarjeve, strukturën e poezisë, rimën e strofën, kuptimin e figurshëm të fjalëve, si: krahasimin apo dhe shpirtëzimin e sendeve e të mjediseve.

Rubrikat didaktike synojnë një integrim të gjithanshëm të teksteve me njohuri nga muzika, piktura, media, filmi, gazeta e revista.



Si është ndërtuar teksti?

... të rriturit

... miqtë e mi

... natyra

... përrallat



... tregimet

Çfarë rubrikash ka teksti?

LEXOJMË

Kush banon këtu pranë?

Një ditë mamaja e pyeti Valbonën:

- A e di si quhen ata që banojnë pranë ne?
- Fajnjëjt tanë,
- u përfaqë menjëherë Valbona.
- Po a njih ti cilët janë ata?
- Po, I njoh, Emalin, Dritën, Mimozën, që ka një mackë të bardhë dhe Tikun, që ka një qenush.
- Po fajnjëjt e ritur a i njih? Ku punojnë ata?

Mamaja e Emalit është infermiere, ndërsa babai është rrobapëpës; mamaja e Dritës është shkrimtare, ndërsa babai është inzhinier; mamaja e Mimozës është drejtore shkollë.

- Mamaja e Valbonës është nëpunëse, - e ndërpreu mamaja.

- Mamaja e Valbonës është nëpunëse, - e ndërpreu mamaja.

- Ç'është t'atë t'atë t'atë? - pyeti Valbona.

- Njëditë që punojnë në zyrë ose ata që janë në vende drejtuese quhen nëpunës.

- Edhe ti, mami, punon në zyrë, pra, je nëpunëse.

- Po, ke të drejtë, - tha mamaja, - por me profesion unë jam arkitekte.

- Siç, e sheh, - ndërrimi babai, - fajnjëjt tanë të ritur punojnë në vende të

Lexojmë tekstin

Kuptojmë tekstin

LEXOJMË

KUPTOJMË TEKSTIN

Fjalorih

Emëlkora - dyzan ku shiten ëmbësira turrë kësht në shënjë poverim - pohlai pa zë, sha po me shënjë.

Pyetje rreth tekstit

1. Pse vajza i përçigjë shënjës me shënjë?
2. Cilin ëmë me faj autori fëmijën apo prindërit?
3. Pse autori e kalton gjuhën e nënës me qumështin e nënës?
4. Cila është e drejta që u jep autori fëmijëve?
5. Cila është e drejta që kanë fëmijët për gjuhën e nënës?

SHKRUAJMË ATË NË FLETORIN TËNË.

Kthethu te tekstin

Shëno me dhe fjalë e mëposhtme:

Vajza ka qenë 4 vjeçe kur ka shkuar në Itali me prindërit. Autori e dërgoi letërën në postë. Edhe zemra ka gjuhën e saj. Autori ua drejton letërën vetëm fëmijëve që jetojnë jashtë vendit. Në letër gjenden këto fjalë: gjerman, gjermanisht. Fëmijët duhet të kërkojnë të drejtën për të mësuar gjuhën e nënës.

Plotëso me fjalë

<input type="checkbox"/>	nyjë shqiptar	-	gjuhë shqipe
<input type="checkbox"/>	nyjë anglaz	-	nyjë grek
<input type="checkbox"/>	nyjë italian	-	nyjë rus
<input type="checkbox"/>	nyjë francez	-	nyjë kosovar

Cila është gjuhë e nënës për _____

Cilët prej tyre kanë gjuhë të njëjtë? Trego për ndonjë shok ose të afërm që jeton jashtë shtetit. Si e flet ai gjuhën shqipe?

SHKRUAJMË

Intervista

Personi që pyet! Personi që përgjigjet!

Kur do që të bësh një intervistë, është mirë t'i përgatitesh më parë pyetjet. Për, duhet ta kesh të qartë se për ç'qëllim do ta pyesh personin që interviston.

Zgjidh një ose dy nga situatat e mëposhtme.

Situata A
Ti do të dish se si ka qenë mësuesja jote në kohën e fëmijërisë. Shkruaj katër pyetje për mësuesen.

Situata B
Shkruaj katër pyetje që do t'i bësh një shkrimtari për fëmijë. Ti do të dish se kur ka filluar të shkruajë, çfarë librash ka shkruar etj.

Situata C
Shkruaj katër pyetje që do t'i bësh një shoku. Ti do të dish disa të dhëna për familjen e tij.

Situata D
Shkruaj katër pyetje që do t'i bësh kryetarit të Klubit të miqve. Ti do të dish se sa anëtarë të rinj kanë hyrë kohë e fundi; a është larguar ndonjë anëtar i vjetër etj.

RËNDOMËTËSITË

- Kur ke qenë...?
- Çfarë ke bërë...?
- Çfarë të ka pëlqyer...?
- Kur ke filluar...?
- A anëtarë...?
- A kenë pasur...?
- Sishkoni...?
- Pse ka ndodhur që...?

Shkruajmë

BISEDOJMË SË BASHKU

Filmat me kartonë

Princesha dhe Hëna

Ky është një film shqiptar, i cili flet për një vajzë të vogël me emrin Dina. Ajo u nis për në hënë së bashku me lepuarutin e saj, Lufinë. Vetëaj i saj, Arbi, shkonte për të kështuar morrin me mikun e tij, Bullin. Në hënë ata kaluan aventura shumë të bukura dhe zunë miq të rinj. Për disa kohëish ata u këmbëzën në tokë, ndërsa hëna i përshëndet me mall nga larg.

Personazhet

- Arbi
- Dina
- Lepuaruti Lulu
- Bull
- Miqaku

Për të përgatitur filmat me kartonë, miratim jepësh shumë veta. Diskutaj shkruar pjesën (skenarin) diskutaj bën ilustrimet, diskutaj shënoj, diskutaj bën muzikën e filmat, të bërë të përshëtin zërin e tyre personazhet të filmat etj. Të gjithë drejtohen nga regjisor.

1. Shiko fotografat e marra nga filmat dhe toq për to?
 - A të pëlqejnë si janë vizatuar personazhet?
 - Po mjediet përreth?
 - Të pëlqejnë ngjyret që kanë përdorur piktorët?
2. Po të bësh filmat me kartonë? Pse?
 - Trego për rëndësinë prej tyre.
 - Cilat janë personazhet?
 - Çfarë bëjnë ata?
 - Si përshëtin filmat?

Regjisor: Ergis Faj, Miroslava Pajazit, Regjisor: Ergis Faj, Beni Shkëmbi

Bisedojmë së bashku

Njohim gjuhën tonë

NJOHIM GJUHËN TONË

Teksti dhe paragrafi

Lexo tekstin dhe thuaj nga sa pjesë përbëhet?

Pas mësimit, mësuesi i edukatës i dhe Mirës një libër. Në atë libër ishin shkruar të drejtat e fëmijëve. Mësuesi i tha se librin duhet t'ua jepte dhe shokëve të tjerë.

Të nesërmen Mira ia dha librin Dritanit. Ai filloi ta lexonte menjëherë. Dina fjalë lu dukën të vështira. Pyeti Mirën, por dhe ajo nuk i kahte kuptuar mirë. Fëmijët vendosën të pyesnin babën e Mirës, që është jurist.

Kur babai u kthye nga puna, fëmijët i shkuan pranë. Ata kishin fillë se mos e beçdonin. Por babai i Mirës i priti me buzëqeshje. Ai u shpjegoi fëmijëve të gjitha fjalët që nuk i kuptonin.

Në orën e edukatës Dritari e ngjiti duarën i pari. Mësuesi u kënaq nga përgjigjet e tij. Ai mori 10. Po këshu dhe Mira.

Sic e vjere re ky tekst të kësht rjeshtë. Çdo pjesë e tekstit quhet **paragraf**. Paragrafi, shkon si fjalë e tekstit, lidhen me një-tjetrin sipas kuptimit.

Mbaj mend! Çdo paragraf fillon me kryetardhë.

→ Për pyetjet, diskutaj e diskutaj i dhe Mirës një libër. Në atë libër ishin shkruar të drejtat e fëmijëve. Mësuesi i tha se librin duhet t'ua jepte dhe shokëve të tjerë.

Përmbajtja

Koha vrapon (Xh. Spahiu) 11

Pushimet verore 12

UNË MËSOJ NGA TË RRRITURIT

Udha (De Amiçis) 14

Zanoret dhe bashkëtingëlloret 16

Teksti dhe fjalia 17

Fëmija mëson atë që jeton 18

Gentiana (E. Maqellara) 19

Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm 21

A keni ngrënë ndonjëherë libra (M. Arxhili) 23

Emrat konkretë dhe abstraktë 25

Skeda e librit 26

Ani pianistja (Sh. Vreto) 27

Ndërtimi i tregimit 29

Gjinia e emrit 30

Kthimi i përrallës (R. Kukaj) 32

Njëjësi dhe shumësi i emrave mashkullorë 34

Një gërvishtje e lehtë (T. Papuçiu) 36

Pikat e planit 38

Mbiemri i nyjshëm dhe i panyjshëm 39

Përshkruajmë me mbiemra 40

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit 41

Kali i vjetër (Xh. Petiëns) 42

Mos (A. Spire) 44

Tema dhe ideja e poezisë 45

Vizatimi i vogëlushes (O. Grillo) 46

Piktura - Portreti i nënës sime 47

Është fat me një shoqe si Fatbardha 48

Letër revistës për fëmijë 49

Pëllumbi i bardhë (R. Kukaj) 50



Përmbajtja

UNË MËSOJ NGA MIQTË E MI

- 52 Mirëserdhët në klubin e miqve
- 53 Rregullorja
- 54 **Pjesët kryesore të fjalisë (kryefjala dhe kallëzuesi)**
- 55 Macja jonë Kiti
- 57 Intervista
- 58 Një diskutim në klasë (R. Petro)
- 60 **Gjuha e folur (Diskutimi, dialogu)**
- 61 **Rendi i pjesëve plotësuese të fjalisë**
- 62 Tri gëzimet (V. Kikaj)
- 64 Krahasimi dhe kuptimi i figurshëm
- 65 **Zgjerimi i fjalisë së vogël**
- 67 Miku i vërtetë (A. Çajupi)
- 68 Jemi të ndryshëm
- 69 Për shoqen që ndërroi qytet (S. Janku)
- 71 Letra
- 72 Guzhinieri ynë
- 73 Receta e gatimit
- 74 **Shkurtimi i fjalisë së vogël**
- 76 Lushi shpëtimtar (A. Demolli)
- 78 Biblioteka
- 79 **Lëvizim fjalët ose grupet e fjalëve në fjali**
- 81 Hajdi dhe Klara (J. Spiri)
- 83 Ata janë si ne
- 84 Bredhi i parë i Vitit të Ri
- 86 Kartolina
- 86 **Thonjëzat**

UNË MËSOJ NGA NATYRA

- 88 Gjithçka ndryshon
- 89 Si ke ndryshuar ti



Përmbajtja

Koha e tashme, e shkuar, e ardhme	91
Vjeshta (Xh. Spahiu)	92
Poezia dhe proza	93
Letër në dimër	94
Përemri vetor dhe Folja	95
Kur bie shi (M. Hoxha)	96
Folja <i>Jam</i> dhe <i>Kam</i> në kohën e tashme dhe të ardhme	97
Peizazhi i pyllit (D. Agolli)	98
Zgjimi i ariut (Q. Batalli)	99
Përshkruajmë pranverën	101
Në bregun e pulëbardhave (H. Ulqinaku)	102
Plani i veprimtarisë	104
Ditari i pemës	105
Gazeta dhe Revista - T'i mbrojmë pemët	106
Folja <i>Jam</i> dhe <i>Kam</i> në kohën e pakryer	107
Dielli	108
Folja <i>Jam</i> dhe <i>Kam</i> në kohën e kryer të thjeshtë	110

UNË MËSOJ NGA PËRRALLAT DHE TREGIMET

Princesha mollë (I. Kalvino)	112
Ndërtimi i përrallës	114
Hyrje përrallash	115
Rosaku i vogël i shëmtuar (K. Andersen)	116
Mbyllje përrallash	118
Sinonimet	119
Luani dhe miu	120
Teatri - Luajmë në role	121
Iriqi dhe mollët	122
Antonimet	123
Zogu dhe djali (N. Frashëri)	124
Dheu është flori (S. Frashëri)	126

Përmbajtja

- 128 Kthimi i Ymer Agës
- 130 Flamuri magjik (P. Koçi)
- 132 Himni i flamurit shqiptar (Asdreni)
- 133 Kështjella (I. Kadare)
- 136 Vjersha për Skënderbeun
- 137 Gjyshja ime Sevasti Qirjazi
- 137 Biografia
- 138 **Fjalori - Të kuptojmë fjalët**
- 140 Andrea i vogël
- 140 Autobiografia
- 141 Fjalë të urta
- 142 **Poezia në dialekt**
- 144 **Dialektet e gjuhës shqipe**
- 145 Lulja ma e bukur (T. Hatipi)
- 147 **Gjuha standarde shqipe**
- 148 Kali i drunjtë (N. Pappleka)
- 149 Krijojmë një personazh
- 150 Filmat me kartonë
- 151 Të flesh në verë (M. Qirici)
- 152 Përshkruajmë verën



Koha vrapon

Mëngjes. Mesditë. Mbrëmja tretet...
Nga kalendari fleta ra
Shkoi dhe një ditë; unë pyes vetveten:
“Ditës ç’i dhe e çfarë të dha?”

Një ditë shkon, pas saj vjen tjetra,
Ti mbjell një pemë, një gur ti vë
Nga guri, ja, u ngrit ndërtesa,
Dhe pema pyll i madh u bë!

Koha vrapon. Vrapon si lumë;
Nga kalendari fleta ra.
Vetvetes pyetjen i bëj unë:
“Ditës ç’i dhe e çfarë të dha?”

Xhevahir Spahiu



? Pyetje rreth tekstit

1. Si ikin ditët sipas poetit:
shpejt apo ngadalë?
Në cilin varg duket kjo?
2. Çka ndodh pasi mbjellim farën e një peme?
3. Çka ndodh kur i vëmë gurët njëri mbi tjetrin?
4. Çka ndodh kur ditët ikin njëra pas tjetrës?
5. Si e kupton vargun e poetit:
“Ditës ç’i dhe e çfarë të dha?”

! Po ti?

- a. A ikën shpejt për ty pushimet verore?
- b. Si u ndjeve ditën e parë të shkollës?
- c. Ç’ ndryshime vure re te shokët e tu?
A dukeshin ata më të rritur?

! Detyrë

Tani që filloi viti shkollor është e mira të bësh një plan ditor.
Kujdes: Mundohu që gjatë ditës ta planifikosh mirë edhe kohën e studimit, edhe kohën e argëtimit.





Pushimet verore

♦ Përpara se të shkruash duhet t'i shikosh rrathët me fjalët kyç.


Fjalë kyç për ata që i kanë kaluar pushimet **në bregdet**.

Det pa kufi, ujë i njelmët, i ngrohtë, rërë e nxehtë, në breg, pulëbardha, anije, notoj lehtë, bëj kala, shoh anije, çadër plazhi, peshq, mbledh guaska etj.



Fjalë kyç për ata që i kanë kaluar pushimet **buzë liqenit**.

Liqen i rrethuar, ujë i ëmbël, freskët, guraleci në breg, peshq, barishte, lejlek, barkë, notoj me vështirësi etj.



Fjalë kyç për ata që i kanë kaluar pushimet **në mal**.

Gjelbërim, pisha, bredha, vend kampingu, çadër kampingu, dita e freskët, nata e ftohtë, ketra, drerë, ngjitem, zbres, ajër i pastër, pjekim mish etj.



Rubrika I



Unë mësoj

*nga
të rriturit*



Udha

Sonte unë po të shikoja nga dritarja, kur ti u përplase me një grua. Shiko më mirë kur ecën në udhë, sepse edhe aty duhet të zbatosh disa rregulla. Nëse ti i mat sjelljet e tua në shtëpi, atëherë përse të mos veprosh po kështu dhe në udhë, që është shtëpia e të gjithëve! Mos harro, po ta kesh vëth në vesh, o Enrik: sa herë që të takosh një plak, një të varfër, një grua me foshnjë në duar, një të çalë me paterica, një burrë të ngarkuar, një familje të veshur me të zeza, lirojua udhën me nderim. Ne duhet të nderojmë pleqtë, të varfërit, dashurinë e nënës, të sëmuret, të munduarit, të vdekurit.



Sa herë që të shohësh ndonjë njeri që rrezikohet nga një makinë, në qoftë fëmijë, largoje, në qoftë burrë, lajmëroje. Pyete fëmijën që e sheh të vetëm dhe duke qarë se ç'nevojë ka; jepja plakut shkopin që i ka rënë përdhe. Kur zihen dy fëmijë, ndaji; në qofshin burra, largohu e mos e shiko atë pamje të keqe, të vrazhdë që të fyen e të nguros zemrën. Preje fjalën e të qeshurën me shokët e tu, kur të takosh ndonjë të sëmurë rëndë, që e përcjellin për në spital. Shikoi me nderim të gjithë fëmijët e instituteve që shkojnë dy nga dy: të verbrit, shurdhmemecët, të gjymtuarit, jetimët. Bëj sikur nuk e shikon atë që ka ndonjë të metë trupore. Sa herë që të gjesh përpara këmbëve të tua ndonjë shkrepëse të ndezur, mos harro ta shuash, se ajo mund t'i rrezikojë ndonjërit jetën. Përgjigjju me njerëzi udhëtarit që të kërkon rrugën. Mos shiko njeri duke përqeshur, mos vrapo pa nevojë, mos thërrit. Nderoje udhën! Edukata e një populli gjykohet sipas sjelljes që tregon në udhë. Atje ku gjen njerëz të liq në udhë, do t'i gjesh dhe nëpër shtëpi. Studioi udhët, studioje qytetin ku jeton; në të qëlloftë ndonjëherë të gjendesh larg vendit tënd, do të të vinte mirë ta mbaje mend qytetin ku ke lindur - atdheun tënd - ai që për ty ka qenë për shumë vjet bota jote, - ku ke bërë hapat e parë, ku të është çelur mendja, ku ke gjetur miqtë e parë. Ai ka qenë një nënë për ty; të ka mësuar, të ka dëfryer e të ka mbrojtur. Studioja udhët e banorët dhe duaje e, kur të dëgjosh se ta fyen njeri, dilli zot.

Edmondo de Amicis



Fjalorth

i çalë - që ka një këmbë më të shkurtër se tjetrën ose të dyja të shtrembëra, të sëmura, prandaj nuk ecën drejt, çalon.

patericë - shkop ose mjet tjetër që përdor njeriu që çalon ose që ka këmbë të sëmura.

Pyetje rreth tekstit

1. Çka mendon ti, kush po flet dhe kujt i drejtohet?
2. A duhet të sillemi njësoj si në shtëpi, ashtu edhe në rrugë?
3. Kujt duhet t'ia lëshosh udhën me nderim?
4. Nga çka gjykohet edukata e një populli?
5. Pse duhet t'i studiosh udhët e qytetit?
6. Me kë krahasohet vendlindja, atdheu dhe pse?
7. Kur duhet t'i dalësh zot atdheut?
8. Cilat janë këshillat që të lanë më shumë mbresë?

Plotëso

Kur një fëmijë është duke qarë në rrugë, unë duhet

Kur një njeri është me paterica

Kur zihen e shahen dy fëmijë

Kur shoh një shkrepëse të ndezur

Kur një të sëmurë e çojnë

Kur ta shan dikush atdheun

Po ti?

- Si e kupton shprehjen: *Nderoje udhën*?
- Po ti si sillesh në rrugë? Trego ndonjë rast, kur ke gabuar, dhe ndonjë rast, kur ke vepruar sipas këshillave të mësipërme.

Detyrë

Zgjidh një nga temat e mëposhtme.

1. Përshkruaj udhët e lagjes ku jeton.
2. Trego një ngjarje me sjellje të keqe të një nxënësi dhe sjellje të mirë të një fëmije.



Zanoret dhe bashkëtingëlloret

Kujto

Alfabeti i gjuhës shqipe ka 36 shkronja

a, b, c, ç, d, dh, e, ë, f, g, gj, h, i, j, k, l, ll, m, n, nj, o, p, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, xh, y, z, zh.

1. Shkruani numrin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve nën secilën fjalë:

ëmbëlsira

z b

dëshirë

z b

ylli

z b

lumenj

z b

krehër

z b

dielli

z b

2. Nënvizo emrat e vendeve që fillojnë me zanore:

Shkup, Ohër, Strugë, Elbasan, Dibër, Ogrozhden, Ersekë, Itali, Prishtinë, Angli, Hungari, Austri.

3. Rretho zanoret në fjalët e mëposhtme. Ndani fjalët në rrokje.

barka

kali

raketa

bredhi

flutura

jeleku

veshi

lapsi

xhamadani

4. Shqipto fjalët e mëposhtme. Thuaj kuptimin e secilës fjalë.

hallë - halë

mal - mall

arrë - arë

pulë - pullë

hedh - hell

muaj - luaj

dru - tru

ruaj - rruaj

5. Shkruaj nga një fjalë që të fillojë me shkronjat ç, q, xh, g, gj, h dhe lexoji bukur.

ç _____

q _____

xh _____

g _____

gj _____

h _____

6. Rretho fjalën që është futur gabimisht në listat e fjalëve të mëposhtme.

tokë, top, them, temë, tapë, gërshet, garë, gjarpër, gur, gisht.



Teksti dhe fjalia



Shiko figurën dhe krijo katër fjali me gojë dhe me shkrim. →

Mbaj mend

Teksti përbëhet nga disa fjali që lidhen sipas kuptimit me njëra-tjetrën. Teksti shpreh një kuptim të plotë.



Kujto

Në shembullin e mëposhtëm gjej cilat janë fjali dhe cili është tekst?

Orën e dytë klasa IV ka matematikë. Mira është ulur në bankën e parë. Në bankën e dytë është Drita. Besimi qëndron pas Dritës. Mësuesja shkruan në tabelë ushtrimin. Të gjithë nxënësit e dëgjojnë me vëmendje.

Çdo gjë që ne e shohim ose e mendojmë, mund ta tregojmë ose ta shkruajmë me një ose me shumë fjali.

Ushtrohu

1. Cila nga fjalitë është futur gabimisht në këtë tekst? Si e dalluat?

Sot është dita e parë e shkollës. Erdeta me mamanë po shkon në shkollë. Para shkollës ka shumë prindër dhe fëmijë. Në oborr Erdeta shikon mësuesen e klasës së tretë. Rruga është e shkurtër. Ajo e përshëndet me ëmbëlsi. Erdeta e donte shumë mësuesen e saj të klasës së tretë. Por në klasën e katërt ajo ka mësuese Zanën.

2. Vendos sipas radhës së duhur fjalitë e këtij teksti.

Ditën e parë kjo e trishtoi. Klasa e Emirit sivjet është në katin e dytë. Ai ka ndërruar jo vetëm katin, por edhe mësuesen. Këtë vit ato janë më të vështira. Emiri duhet të mësojë më shumë. Më pas ai mendoi për mësimet.

3. Lexo tekstin e mëposhtëm. Dallo ato që nuk janë fjali.

Zilja ra. Nxënësit po drejtohen. Në korridore ka shumë lëvizje. Shumë nxënës nuk e dinë ende klasën. Këta janë nxënësit e rinj. Ata vijnë për herë. Mësuesit thërrasin emrat e nxënësve. Kjo rrëmujë e këndshme. Filloi viti i ri shkollor.

- ◆ Ktheji në fjali grupet e fjalëve që nuk janë fjali.



**Fëmija
mëson atë
që jeton**

Në qoftë se fëmija jeton me kritikën,
mëson të kundërshtojë.
Në qoftë se fëmija jeton me armiqësinë,
mëson të sulmojë.
Në qoftë se fëmija jeton talljen,
mëson të dyshojë.
Në qoftë se fëmija jeton me sharjet,
mëson të ndihet fajtor.
Në qoftë se fëmija jeton me tolerancën,
mëson të jetë i durueshëm.
Në qoftë se fëmija jeton me vlerësimin,
mëson të jetë i sigurt në vetvete.
Në qoftë se fëmija jeton me arsyen
mëson të respektojë të tjerët.
Në qoftë se fëmija jeton me drejtësinë,
mëson të jetë i ndershëm.
Në qoftë se fëmija jeton me sigurinë,
mëson të besojë.
Në qoftë se fëmija jeton me dashurinë,
mëson të kërkojë dhe të gjejë
miqësi dhe dashuri në botë.

 **Fjalorth**

kritikë - zbulim i të mirave e të metave të një veprimi, person etj.
dyshoj - s'jam i bindur plotësisht
tolerancë - mirëkuptim

 **Pyetje rreth tekstit**

1. Cilat janë disa nga sjelljet e mira që mëson fëmija nga të rriturit?
2. Cilat janë disa nga sjelljet jo të mira të rriturve?
3. Cilat janë më të rëndësishme: këshillat që japin të rriturit apo sjelljet dhe veprimet e tyre? Pse?

Lidh me shigjetë

armiqësia	fajësia
toleranca	durimi
arsyeja	besimi
kritika	respekti
drejtësia	kundërshtimi
sharja	siguria
vlerësimi	sulmi
siguria	ndershmëria
dashuria	dyshimi
tallja	miqësia



Gentiana, nxënësja e klasës së katërt, ishte kureshtare të dinte diçka më tepër për prejardhjen e emrit të saj. E dinte se ky emër lidhej me një bimë shumëvjeçare, që ndryshe e quanin dhe Sanëza.

Një ditë, kur mësuesi po shpjegonte historinë e ilirëve, shpalosi mbi dërrasën e zezë një hartë. Vendosi shuplakën e dorës në zonën e Shkodrës dhe tha:

- Këtu Genti ka sunduar rreth dy shekuj para erës sonë. Në klasë ne kemi një nxënëse që mban emrin e tij, Gentianën.

Gentiana, sa dëgjoji emrin e saj, u ngrit në këmbë me krenari. Të gjithë kthyen kokën nga ajo. Gentiana ngjante vërtet si një mbretëreshë në sytë e shokëve dhe shoqeve të klasës.

Mësuesi u tregoi shumë gjëra për Gentin. Ai kishte pasur një ushtri të fuqishme dhe kishte zotëruar pasuri të mëdha. Por ai kishte studiuar edhe vetitë shëruese të bimëve. Genti kishte zbuluar që në rrënjët e një bime, e cila rritej në zonat malore të mbretërisë së tij, si edhe në zona të tjera, gjendej një lëndë, që e ndihmonte njeriun të luftonte dobësitë trupore, dhe të rimerrte veten kur humbiste shumë gjak. Këtë bar Genti e përdorte për të mjekuar ushtarët.

Pasardhësit e Gentit vërtetuan vetitë shëruese të rrënjëve të bimës që përdorte Genti për të mjekuar ushtarët, prandaj ata e quajtën me emrin e tij. Kështu njihet edhe sot.

Gjithashtu mësuesi u tregoi nxënësve se farmacistët e njihnin mirë këtë bar shërues.

Gentiana dëgjonte me kureshtje të madhe dhe vendosi që ta studionte më gjatë historinë me të cilën lidhej emri i saj.

E. Maqellara

Gentiana



Sanëza

Fjalorth

kureshtar - ai që ka dëshirë të madhe për të ditur sa më shumë

prejardhje - origjinë; fillesa e diçkaje

vërtetoj - provoj se diçka është e vërtetë ose e saktë

Pyetje rreth tekstit

1. Përse ishte kureshtarë Gentiana?
2. Çka donte ajo të dinte më shumë?
3. Çka u tregoi mësuesi i historisë nxënësve?
4. Si u vërtetuan vetitë shëruese të bimës së Sanëzës?
5. Përse Gentiana u ndje krenare para shokëve?

Kthehu te teksti

Shëno me fjalinë e saktë dhe fjalinë e gabuar:

- Gentiana ishte në klasën e tretë.
- Mësuesja tha se Genti kishte jetuar rreth dy shekuj p.e.s.
- Paraardhësit e Gentit vërtetuan vetitë shëruese të bimës.
- Farmacistët nuk e njohin këtë bar shërues.
- Gentiana ishte vajzë shumë kureshtarë.

Po ti?

Pyeti prindërit për historinë e emrit tënd dhe tregoj shokëve në klasë.

Kush ta ka vënë emrin?

A ka emri yt domethënie?

Detyrë

Bëj në shtëpi një tabelë të tillë duke shkruar anash disa nga emrat e shokëve dhe shoqeve të klasës.

Plotëso tabelën.

Gjej lidhjen ndërmjet emrit dhe origjinës së tij.

Emri	emër ilir	emër vendi	fjalë e shqipes
Agim			
Rozafë			
Ardian			
Adriatike			
Bamir			
Besnike			
Drin			
Dritë			
Dardan			
Erzanë			
Fatijonë			
Genc			
Valbonë			
Korab			
Jon			
Urim			
Teutë			



Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm



Mbi bar ka çelur një **lule**.



Unë quhem **Lule**.

Kujto

Gjej ç'lloj emrash janë fjalët me ngjyrë blu dhe ato me të kuqe.




Në qiell ndriçon **ylli**.



Unë quhem **Ylli**.



Poshtë urës kalon një **lumë**.



Ai është **Drini**.



Pjata e **qenit** është bosh.



Ai quhet **Balo**.

Emrat që tregojnë njerëz, kafshë, sende e vende quhen **emra të përgjithshëm**.

Emrat që i dallojnë njerëzit, kafshët, sendet dhe vendet nga të tjerët quhen **emra të përveçëm**.

Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe.

Ushtrahu

1. Gjej emra të tjerë të përgjithshëm dhe të përveçëm sipas shembujve të mësipërm.

2. Vendos në emrat e përgjithshëm dhe në emrat e përveçëm.

- | | | | | |
|---------------------------------|--------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|-----------------------------------|
| <input type="checkbox"/> djali | <input type="checkbox"/> nëna | <input type="checkbox"/> gjyshi | <input type="checkbox"/> era | <input type="checkbox"/> kërmilli |
| <input type="checkbox"/> Agimi | <input type="checkbox"/> mjeku | <input type="checkbox"/> Kiti | <input type="checkbox"/> miza | <input type="checkbox"/> Struga |
| <input type="checkbox"/> Mira | <input type="checkbox"/> syzet | <input type="checkbox"/> flokët | <input type="checkbox"/> lepuri | <input type="checkbox"/> breshka |
| <input type="checkbox"/> kafazi | <input type="checkbox"/> Drita | <input type="checkbox"/> qeni | <input type="checkbox"/> Ohri | <input type="checkbox"/> Drini |

3. Nënvizohet shkronjën që është shkruar gabim në fjalët e mëposhtme:

Mësuese arta
usta Flamuri

nënë drita
Doktor Astriti

Macja kiti
qeni rodi

kukulla barbi
këngëtare valbona



3. Cilët nga emrat e mëposhtëm përdoren edhe si emra njerëzish? Shkruaji ata në fletore me shkronjë të madhe.

shqiponja
drita
kafaz i
trëndafili

zambaku
kanarina
agimi
era

luani
hëna
bilbili
vera

4. Emrat e nëvizuar ndaji në fletore sipas skemës së mëposhtme:

Dielli doli prapa malit. Fshati u zgjua nga kënga e gjelit. Nëna, babai dhe fshatarët e tjerë u ngritën herët në agim. U zgjuan edhe lopët, pulat, gjeli, qeni Rodi e macja Bjanka. Të gëzuar këtë mëngjes u zgjuan edhe Drita, Agimi dhe të gjithë fëmijët e tjerë.

emra njerëzish		emra kafshësh		emra sendesh e vendesh	
të përgjithshëm	të përveçëm	të përgjithshëm	të përveçëm	të përgjithshëm	të përveçëm
nëna	Drita				

5. Plotëso fjalitë me emra të përveçëm.

- Unë jam (emri / mbiemri) dhe jam nga (qyteti/fshati).....
- Po ti si quhesh dhe nga je?
- Unë quhem dhe jam nga.....
- Të pëlqejnë kafshët?
- Po. Unë kam në shtëpi një qen të bukur. Atë e quajnë
- Një ditë në oborrin e pallatit tim ne gjetëm tre këlyshë qeni. Ne i quajtëm, dhe Ata ishin shumë të bukur. Ne luanim me ta; edhe macja vraponte pas nesh.. Nëna e na ndihmonte t'i ushqenim. U bëmë edhe një kolibe të madhe.



A keni ngrënë ndonjëherë libra?!



- Do të budallalloseni duke shikuar gjithë ditën televizor! Nuk do të ishte më mirë të lexonit?

Ne nuk e kuptonim dot pse mësuesit dhe prindërit e kishin kaq inat televizorin. Por ata këmbëngulnin:

- Kur ne ishim të vegjël, lexonim gjithë ditën; i hanim librat me dhëmbë.

Kjo, natyrisht, ne na çudiste jashtë mase. E si mund të haheshin librat?!

Një ditë prej ditësh në qytetin tonë një shkrimtar botoi një libër, pas të cilit ne fëmijët linim kokën. Kur e morën në një intervistë dhe e pyetën për këtë, ai tha:

“T’i bësh fëmijët që t’i duan librat, duhet të shkruash për tema që pëlqehen prej tyre”.

Dhe ai kishte të drejtë. Ne filluam vërtet t’i hanim me dhëmbë librat, ashtu siç na thoshin shpesh prindërit. Nëse deri në atë kohë librat na i blinin prindërit, tani ne i blinim vetë. I harxhuam të gjitha kursimet që kishim mbledhur me mundim gjatë vitit. Një herë shkrimtari nxori në qarkullim një poemë shumë të vështirë për krokodilët. Libri kishte plot 312 faqe, por ne e përpimë të gjithë. Filluam madje dhe të dallonim shijet e ndryshme të librave. Disa na ngjanin me shijen e akullores; disa me atë të kikirikëve të përzier me çokokrem; disa me shije babanesh apo luleshtrydesh.

Me një fjalë, me t’i zbuluar sa të mirë ishin librat, ne i hanim me dhëmbë me të vërtetë, duke i kthyer faqet njëra pas tjetrës. Dikush i kafshonte drejtpërsëdrejti, dikush i mbliidhte top e pastaj i gëlltiste. Kishte edhe nga ata që i hanin me kapituj.

Librat jo vetëm që ishin të shijshëm dhe treteshin lehtë, por edhe na rritnin, na shëndoshnin e na i skuqnin faqet.

Por si gjithmonë, tamam atëherë kur ne filluam ta merrnim me qejf këtë gjë, të rriturit filluan të shqetësoheshin e të na thoshin:

- Mjaft më me librat, se do të budallalloseni! Shikoni pak dhe televizor!

Marçelo Arxhili

Fjalorth

do të budallallosesh – kjo folje vjen nga emri *budalla*. Ka kuptimin: *do të humbasësh mendjen; do të të prishet mendja.*

linim kokën – na pëlqenin shumë

nxori në qarkullim librin – e nxori librin në shitje

Pyetje rreth tekstit

1. Përse në fillim të tregimit prindërit ishin të shqetësuar?
2. Çka u thoshin ata fëmijëve për kohën e tyre fëmijërore?
3. Përse fëmijët linin kokën pas librave të shkrintarit?
4. Cilat ishin shijet më të pëlqyera të fëmijëve:
.....
.....
.....
.....?
5. Si e kuptoni këtë fjali: *Librat na rritnin, na shëndoshnin, na skuqnin faqet...*
6. Pse në fund të tregimit përsëri prindërit ishin të shqetësuar? A ju bëjnë për të qeshur fjalët e tyre? Pse?

Kthehu te teksti

Gjej sa herë përdoret në tekst fjala *libra* ____.

Gjej sa herë përdoret në tekst fjala *dhëmbë* ____ .

Gjej dhe lexo fjalinë ku tregohet se:

Fëmijët pëlqejnë librat që i përgjigjen moshës së tyre.

Libri ishte shumë i madh.

Libri kishte kapituj.

Po ti?

Çka të pëlqen më shumë:

të lexosh libra apo të shohësh televizor? Pse?

Cila është dobia e librave dhe e televizorit?

Cilët janë disa nga titujt e librave që ti ke lexuar?

I zgjedh vetë librat apo t'i rekomandojnë të rriturit?

Fol për një libër që të ka pëlqyer dhe për një libër që nuk të ka pëlqyer.

Trego arsyet.



Emrat konkretë dhe abstraktë

- Lidh me shigjetë emrat me figurën. Cilët nga emrat nuk i lidhe dot? Pse?

djali
flokët
sytë
fytyra
duart
rripi
pantallonat
zëri



sjellja
frika
mirësia
gëzimi
mendimi
lumturia
lodhja
ëndrra

Një emër është **konkret**, kur tregon njerëz, kafshë, sende që i shikojmë, i dëgjojmë, i prekim ose i dallojmë me anë të shqisave.

Një emër është **abstrakt** kur tregon diçka që nuk e kapim me anë të shqisave. Emrat abstraktë tregojnë ndjenja, gjendje shpirtërore, mendime.

Ushtrahu

1. Vendos tek emri konkret shkronjën e shqisës përkatëse. Kujdes, disa emra mund të lidhen me disa shqisa.

... pema lulishtja
... kënga molla
... lulja lidhësja
... goja era
... supa bubullima
... tingëllima limoni
... dëbora zilja
... shkrepitima zhurma
... thartira zogu
... kripa cicërimë
... sheqeri shiu
... ëmbëlsia deti

a. veshi (dëgjojmë)
b. gjuha (shijojmë)
c. syri (shohim)
ç. dora (prekim)
d. hunda (nuhasim)

2. Vendos **K** për emrat konkretë dhe **A** për emrat abstraktë.

toka (.....), topi (.....), tymi (.....), lodhja (.....), ndershmeria (.....), mësimi (.....), mësuesi (.....), klasa (.....), lule (.....), lulëzimi (.....), drejtësia (.....), dashuria (.....), dhimbja (.....), vështirësia (.....), liria (.....), sëmundja (.....), mjeku (.....), tinguj (.....), sukcesi (.....), koncerti (.....)

3. Shkruaj emrin abstrakt që i përgjigjet fjalës së mëposhtme:

mik	miqësi
i ri
fëmijë
plak
i varfër
i gëzuar
i pasur
i dëshpëruar

4. Shkruaj emra abstraktë me kuptim të kundërt:

mirësi
frikë
varfëri
gëzim
lumturi
drejtësi

Skeda e librit

◆ Ti ke vënë një bast me shokët për librat që do të lexosh gjatë një muaji. Që ata të besojnë se ti vërtet i ke lexuar librat, mëso më parë të bësh skedën e librit.

◆ Prit disa copa kartoni me madhësi të njëjtë. Pastaj bëj një skedë të ngjashme me skedën e mëposhtme. Për çdo libër që do të lexosh, duhet të plotësosh skedën.



Titulli i librit - Pinoku
Emri i autorit - Karlo Kolodi
Lloji i librit - Përrallë
Numri i faqeve - 100 f.
Ngjyrat - me ngjyra

Detyrë

- Plotëso 4 skeda, sipas shembullit të mësipërm, për librat që ke lexuar.



Ani pianistja

Hyrja

Ani erdhi në shkollën e muzikës të qytetit tonë tre muaj pasi kishte filluar viti shkollor. Ishte truphedhur dhe simpatike. Kishte flokë të gjatë dhe ngjyrë gështenjë. Anit i pëlqente të fantazonte. Ajo ishte e padjallëzuar, mësonte mirë dhe i kryente me rregull detyrat. E mundonte pak gjeografia dhe hartat, ama në mësimin e pianos ishte e jashtëzakonshme.

Zhvillimi

Një ditë Anin e ftuan në një koncert, që e organizonte Bashkia e qytetit. Kjo u ra si bombë dy shoqeve të saj të klasës, Elës dhe Enit. Pa ardhur Ani, ato mbaheshin më të mirat në piano. Prandaj u bënë ziliqare.

Salla ishte mbushur plot. Dirigjenti i bëri me shenjë Anit që të fillonte. Por Ani nga hutimi dhe shqetësimi e mori këtë gjest si përshëndetje. Ajo u ngrit e i dha dorën dirigjentit. Në sallë u dëgjuan të qeshura. Dy shoqet e klasës vështruan njëra-tjetrën: “Budallaqja, e kemi thënë ne.” Por shumë shpejt salla u magjeps. Nga duart e pianistes së vogël filluan të dilnin tinguj të mrekullueshëm. Suksesi ishte i jashtëzakonshëm; njerëzit nuk pushonin së duartrokrituri. Atë natë Ani nuk fjeti fare nga lumturia.

Të nesërmen, e gjithë klasa e priti me duartrokkitje. Pastaj fëmijët filluan të thërrisnin: “Ani! Ani! Je e madhe!” Kjo ishte një surprizë e cila, sa e gëzoi, aq dhe ia skuqti faqet nga turpi. Vetëm dy shoqet ziliqare nuk e uruan.

Në pushimin e madh, kur Ani vajti në banjë, njëra mbajti dorezën e derës, kurse tjetra futi dorën brenda dhe i hodhi përsipër një gotë me ujë të ftohtë të ngjyrosur. Ani bërtiti dhe deshi të hapte derën, por brava u këput dhe ajo mbeti brenda... Ngjarjen e morën vesh të gjithë. Mësuesja kujdestare dhe drejtori e pyetën Anin se kush ia bëri këtë rreng. Por Ani nuk u tregoi asgjë. Kjo sjellje zemërgjerësie i bëri shoqet që të ndiheshin shumë keq.

Kaloi një javë dhe pendimi po i gërryente nga brenda. Pasditen e së shtunës ato shkuan në shtëpinë e Anit. Derën ua hapi mamaja e Anit.

Ajo i ftoi brenda, por ato i lanë një pako në dorë dhe ikën.

Mbyllja

Ani gjeti në pako një kukull me flokë të gjatë, në xhepin e së cilës ishte vënë një pusullë. Atje shkruhej:

“Ani, je e madhe!

Me dashuri nga Ela dhe Eni”.

Shpresa Vreto

Pyetje rreth tekstit

1. Pse dy shoqet e kishin zili Anin?
2. Cili ishte gabimi që bëri Ani në fillim të koncertit?
Cili ishte shkaku i keqkuptimit:
ndrojtja nga skena,
paditura,
mendjemadhësia? Pse?
3. Si e pritën shikuesit interpretimin e Anit?
4. Çka i ndodhi Anit të nesërmen në shkollë? Cila ishte:
e papritura e këndshme,
e papritura e keqe?
5. Si e përshkruan autorja Anin?

Po ti?

- Si duhet të sillesh me një mik që:
ka arritur sukses,
është i ndrojtur,
humbet në një garë,
të ka bërë një të keqe?

Ti nuk e arrin dot suksesin duke pasur zili tjetrin, por duke e marrë atë si shembull.

Zbulo te vetja aftësitë e tua të veçanta dhe përpiqu më shumë.

Atëherë sukcesi do të trokasë patjetër te ti.



Fjalorth

truphedhur - trup i zhvilluar mirë
e padjallëzuar - që sillet e vepron me çiltërsi, pa qëllime të këqija ndaj të tjerëve.

u ra si bombë - u erdhi e papritur
rreng - lojë me qëllim të keq

Punë në grup

- Bashkëbisedoni me shokët për pasionet tuaja. Sa ju kënaqin dhe si përpiqeni t'i zhvilloni ato.



Ndërtimi i tregimit

Tregimi ka një ndërtim (strukturë) të caktuar, i cili përbëhet nga: hyrja, zhvillimi dhe mbyllja.

- **Kthehu te tregimi *Ani pianistja*.**

Me ndihmën e mësueses analizo përbërësit e tij.

HYRJA	Në hyrje paraqiten personazhet, koha, vendi ku ndodh ngjarja.
ZHVILLIMI	Gjatë zhvillimit të tregimit tregohet se çfarë ndodh . Kjo është pjesa më e gjatë, e pajisur me dialog, me përshkrime, me situata e të papritura, me sjelljet e veprimet e personazheve etj.
MBYLLJA	Në mbyllje të tregimit tregohet si përfundon ngjarja.

TEMA

(Për të gjetur lehtësisht temën, bëj pyetjen.)

→ **Për çfarë flet ky tregim?**

Tregimi “Ani pianistja” flet për një vajzë shkollare. Ajo është shumë e talentuar në piano, por kjo e bën të përballet me xhelozinë e shoqeve të veta.

IDEJA

(Për të gjetur lehtësisht idenë, bëj pyetjen.)

→ **Cili është mesazhi që na jep shkrimtarja?**

(Çfarë mësimi a porosia kërkon të na japë shkrimtarja?)

Në tregimin “Ani pianistja” shkrimtarja na jep mesazhin, se ne të gjithë duhet të jemi zemërgjerë ndaj sukseseve të tjetrit.

Gjinia e emrit

 **Ushtrohu**

Kujto

Emrat e gjinisë mashkullore mbarojnë me **-i, -u**.

Emrat e gjinisë femërore mbarojnë me **-a, -ja**.

Lepuri dhe breshka do të bëjnë një garë vrapimi. Miu mban në dorë flamurin. Lepujt e tjerë janë ulur mbi bar. Bari sapo ka mbirë. Miu drejton garën. Flamuri ulet dhe gara fillon. Në fund rruga ka një tabelë. Tabela tregon vendin ku mbaron gara. Zogu qëndron mbi tabelë. Në tabelë është shkruar: "Mbërritja".



1. Emrat e nënvizuar ndaji sipas gjinisë në bashkësitë e mëposhtme.

Gjinia mashkullore

lepuri

.....

.....

.....

Gjinia femërore

breshka

.....

.....

.....



2. Formo çifte duke lidhur emrat e gjinisë femërore me emrat e gjinisë mashkullore.

mamaja	gjyshi	pela	dashi
motra	babai	lopa	ariu
dentistja	mësuesi	delja	kau
mësuesja	vëllai	ujkonja	kali
gjyshja	dentisti	arusha	ujku

3. Gjej gjininë femërore të emrave të mëposhtëm:

mësuesi	pëllumbi
këngëtari	maçoku
punëtori	luani
fshatari	gjeli
sportisti	cjapi
mjeku	rosaku

4. Shkruaji fjalitë dhe një herë duke i zëvendësuar emrat e gjinisë femërore me emra të gjinisë mashkullore.

Valltarja e grupit është **Yllka**.

P.sh.: **Valltari** i grupit është **Ylli**.

Motra e Evës është **këngëtare**.

.....

Gjyshja e Seditës ka qenë **mësuese**.

.....


Mjekja e lagjes është **mamaja** e Andit.

.....

Macja e Artës quhet **Bardhoshe**.

.....

5. Shiko figurën dhe krijo një tekst duke përdorur emra të gjinisë mashkullore dhe femërore.



Kthimi i përrallës

Drini ishte pesë vjeç. Një natë dimri i tha gjyshit piktor:

- Gjysh, më vizato përrallën "Borëbardha dhe shtatë shkurtabiqët!"

Gjyshi mori një fletë të gjerë dhe së pari vizatoi Borëbardhën e bukur. Rreth saj pastaj vizatoi pesë shkurtabiqë të lezetshëm e kureshtarë. Sapo u bë gati të vizatonte shkurtabiqin e gjashtë, dikush i ra ziles në derë.

Atë natë gjyshin e morën policët.

Ai nuk u kthye as atë natë, as shumë net të tjera. Drini i vogël e pyeste babanë:

- Ku është gjyshi?

- Ka udhëtuar diku larg...

- Pse nuk udhëtoi vetëm, po me policët?

Një vit më vonë nipi i mësoi të gjitha. Gjyshi ishte në burg.

- Pse e kanë dënuar? - pyeti Drini atëherë.

- Që ti të kesh shkollën! - i tha i ati.

Kaluan pesë vjet pikëllimi. Nipi mbushi dhjetë vjeç. Ishte në klasën e tretë, kur u kthye gjyshi piktor në shtëpi.

U përqaftuan; u çmall tërë familja. Drini u bë sërish zog me flatra.

Vajti te dollapi i vet, në fund kishte fshehur diçka. E nxori letrën e gjerë dhe ia shtriu gjyshit përpara.

- Gjysh, - i tha, - na duhen edhe dy shkurtabiqë.

Gjyshi i vizatoi dy shkurtabiqët. Tani përralla u bë përrallë, por nipi ishte rritur. Gjyshi e pa me dhembje.

- Sa bukur, gjysh! - tha Drini i vogël. - Po ia japim Buqes...

Buaja ishte pesë vjeçe dhe i po i shihte e habitur me sytë e saj të kaltër shend e verë.

Kështu përralla u kthye në shtëpi dhe solli lumturinë që për pesë vjet kishte ikur...

Rifat Kukaj





Pyetje rreth tekstit

1. Çka po bënin një natë dimri gjyshi dhe nipi?
2. Cilët e morën me vete gjyshin? Përse?
3. A u shqetësua Drini i vogël për gjyshin? Si i përgjigjej atij babai?
4. Pas sa vjetësh erdhi gjyshi në shtëpi?
Çfarë ndryshimesh kishin ndodhur gjatë këtyre viteve?
5. A të pëlqen fundi i tregimit? Pse?
6. Po ti si mendon pse gjyshi u dënua:
kishte bërë ndonjë faj
apo
se luftonte për lirinë e Kosovës?



Kthehu te teksti

- Gjej dhe nënvizo fjalitë ku përdoret fjala *polic*.
- Gjej dhe nënvizo fjalitë ku përdoret e kundërta e fjalëve *pesë vjet lumturie*.
- Gjej sa herë përdoret në tekst fjala *burg*.
- Gjej fjalinë që tregon se piktura përfundoi.
- Gjej fjalinë ku përmendet titulli i tregimit.



Po ti?

Pyeti prindërit për një nga njerëzit që është dënua ose ka rënë dëshmor për lirinë e Kosovës. Tregoju për të shokëve të klasës.



Detyrë

- ◆ Lexo çfarë ka shkruar për lirinë një nxënëse.

Erdhi liria!

Liria është një yll që e pritëm për shumë vite të ndriçonte në qiellin e errësuar të Kosovës. Tani liria trokëti në dyert e çdo shtëpie, të cilat u hapën njëherë e përgjithmonë. Ylli i lirisë ndriçon edhe në shkollat tona që kishin mbetur të shkreta, pa zërat e fëmijëve.

Tani dhe dielli lind i lirë mbi qiellin kaltërosh të Kosovës. Ai ndriçon mbi tokën e djegur dhe i ngroh eshtrat e dëshmorëve tanë të rënë për liri.

Tokën e Kosovës ne do ta gjelbërojmë me lulet më të bukura të lirisë, do ta ndërtojmë dhe do ta ruajmë si sytë e ballit. Sepse deri tash fjalën LIRI vetëm e kemi dëgjuar dhe e kemi ëndërruar, por tash atë po e shijojmë.

Kjo për ne është një gjë me shumë vlerë.


Vjosa Ratkoceri, Prishtinë

- ◆ Shkruaj dhe ti tre-katër rreshta për këtë temë.


Njëjësi dhe shumësi i emrave mashkullorë

Kujto

Emri është në numrin njëjës dhe shumës.



Një peshk ka dalë nga akvariumi.



Në akvarium janë **disa peshq**.



Lapsi im është i kuq.



Lapsat e tjerë janë të motrës.

një peshk ————— **numri njëjës** ————— lapsi

disa peshq ————— **numri shumës** ————— lapsat

Pra, emrat e gjinisë mashkullore përdoren në numrin njëjës dhe në shumës.

Ushtrahu

1. Ndaji në dy bashkësi (njëjës dhe shumës) emrat mashkullorë me ngjyrë blu.

Mjeshtri i cirkut shkoi në **kopshtin** zoologjik. Me vete mori dhe **arinjtë** e tij. Makina u fut në mes të **pyllit**. Gjethet fëshfërinin në **plepat** e lartë. Aty pranë shtrihej **një liqen** i vogël. Në ujin e liqenit lëviznin **peshqit** e kuq. Më pas ishte **kopshti** zoologjik i qytetit. **Shumë fëmijë** ishin mbledhur te **majmuni**. Të tjerët po dëgjonin **zogjtë**. Një djalë i hodhi **disa** thërrime buke.

NUMRI NJËJËS

mjeshtri

NUMRI SHUMËS

arinjtë



2. Shkruaj në fletore shumësin e këtyre emrave:

një punëtor	<i>disa punëtorë</i>	punëtori	<i>punëtorët</i>
një valltar	valltari
një këngëtar	këngëtar
një murator	muratori
një shtegtari	shtegtari
një shqiptar	shqiptari
një afrikan	afrikani

3. Kthe në numrin njëjës emrat:

disa bilbila	<i>një bilbil</i>	disa shoferë	<i>një shofer</i>
disa lapsa	disa majmunë
disa çelësa	disa telefona
disa zinxhirë	disa dollapë
disa gurë	disa lisa

4. Vendos në numrin shumës emrat në kllapa.

Aty gjen (bilbil) e (laps),
 (Çelës) e tapa shishesh,
 Stema, (gur) e kopsa
 (Zinxhir) e boçe pishe.




5. Kthe në numrin njëjës emrat e gjinisë mashkullore.

Në pyjet tona ka drurë të llojeve të ndryshme.
 Aty jetojnë edhe kafshë të egra, si: arinjtë, ujqërit,
çakajtë, gjarpërinjtë, lepujt, fazanët, bilbilat,
gushëkuqët, lejlekët, skifterët etj.

P.sh.: *pyjet* – *pylli*; *arinjtë* – *ariu*;

6. Shiko figurën dhe shkruaj për të katër fjali me emra mashkullorë në numrin njëjës dhe shumës.





NJË GËRVISHTJE E LEHTË

Shoku ynë Taulanti u shtrua papritur në spitalin e qytetit tonë. Ne i lutëm babait të Orionit, që është mjek, të na lejonte ta takonim. Dhe ai na e plotësoi dëshirën...

Në korridoret e spitalit pamë shumë mjekte e mjekë të veshur me të bardha. Infermieret nxitonin duke shtyrë karrocet me rrota ku mbanin

ilaçet, shiringat e lloj-lloj shishesh të vogla me barna.

Në dhomën e Taulantit kishte dhe dy të sëmurë të tjerë. Sapo na pa, ai u hodh përpjetë nga gëzimi. Deshi të ngrihej, por babai i Orionit nuk e lejoi.

- Si je tani, Taulant? - foli e para Etleva. - A do të rrih dhe shumë në spital?

- Më mirë jam, - tha Taulanti dhe e nguli vështrimin te babai i Orionit: A do të rri shumë në spital?

- Edhe nja dy-tri ditë. Veç kjo duhet të të bëhet mësim, - shtoi ai me qortim.

- Pse iu ënjt këmba kaq shumë Taulantit, o babi? - e pyeti Orioni të atin.

Mjeku mori një karrige, u ul pranë nesh dhe nisi të fliste shtruar.

- Gjatë lojës mund të ndodhë të vriteni ose të gërvishteni. Shumica prej jush nuk i jep rëndësi kësaj. Kur lëkura e një pjese të trupit çahet dhe gjakoset, ka rrezik të ënjtet e të bëhet plagë. Prandaj ajo duhet mjekuar menjëherë. Duhet pastruar me alkool ose jod dhe të lidhet me fashë të pastër. Ndërsa Taulanti nuk e ka pastruar si duhet. Ai vetëm sa e ka shpëlarë me ujë dhe e ka prekur me duar të papastrat. Nga kjo pakujdesi iu futën në gjak mikrobet dhe këmba iu mahis.

- Çudi, sa të këqija qenkan këto mikrobet! - tha Beni. - Unë s'kam parë ndonjëherë si janë.

Babi i Orionit qeshi dhe tha:

- Ejani pas meje, - dhe na futi në një dhomë që quhej laborator.

- Afrohuni me radhë dhe shikoni këtë aparat që quhet mikroskop, - tha mjeku. Ne u afruam njëri pas tjetrit dhe vumë syrin mbi një tub prej xhami. Në fund të tij pamë disa qenie të çuditshme: disa si krimba të gjatë me shumë këmbë, disa të



rumbullakët, me nga një bisht të hollë, disa si ca buburreca të vegjël, shumë të vegjël, që dukej sikur lëviznin në një lëng.

- Ja, këto janë mikrobet, - tha babai i Orionit. - Janë shumë të vogla, nuk shihen me sy, por janë shumë të rrezikshme. Mikrobe ka kudo: në tokë, në ajër. Ato zënë vend e shtohen në sende të papastra, në duar të palara, në thonj të paprerë, në rroba të pista dhe bëhen shumë të rrezikshme kur futen në trup.

Pastaj babai i Orionit hapi një kuti të ndihmës së shpejtë. Aty brenda kishte një shishe me alkool, pambuk, fashë, një kuti me pomadë e ca hapje në një tub prej qelqi. Pastaj ai na tha:

- Në çdo shtëpi duhet të ketë kuti të ndihmës së shpejtë.

T. Papuçiu

Pyetje rreth tekstit

1. **Ku** ishte Taulanti dhe **çfarë** bënë shokët e tij?
2. **Çka** i kishte ndodhur Taulantit?
3. **Çfarë** u shpjegoi mjeku fëmijëve?
3. **A** kishin parë fëmijët mikrobe? **Ku** i panë ato?
4. **Pse** janë të rrezikshme mikrobet?
5. **Çka** kuptuan fëmijët në fund të tregimit?

Fjalorth

mahis - plaga fillon të fryhet, të mbledhë qelb, një lëng të trashë me ngjyrë të verdhë, me erë të keqe.

laborator - vend ku bëhen prova shkencore.

mikroskop - mjet i cili përdoret për të zmadhuar ose për të parë trupa të vegjël, që nuk mund të shihen me sy.

P o t i ?

A ke në shtëpi kuti të ndihmës së shpejtë?

Si mendon, pse ai që përdor makinë e ka të domosdoshme kutinë e ndihmës së shpejtë?

Plotëso

Në kutinë e ndihmës së shpejtë ka:

.....

.....

.....

.....

.....





Pikat e planit

Nëse mësuesi/ja të kërkon ty të thuash **përmbajtjen e pjesës**, më parë duhet të nxjerrësh **pikat e planit**.

Tregimi “Një gërvishtje e lehtë” është një tekst i përbërë nga gjashtë paragrafë. Çdo paragraf është përmbledhur në një fjali, e cila përmban kuptimin kryesor. Kjo fjali përbën pikën e planit.

- Lexo planin. Ai s’është gjë tjetër, veçse përmbajtja e tregimit, e thënë shumë shkurt.

1. Shokët vizitojnë Taulantin e shtruar në spital.

Shoku ynë Taulanti u shtrua papritur në spitalin e qytetit tonë. Ne iu lutëm babait të Orionit, që është mjek, të na lejonte ta takonim. Dhe ai na e plotësoi dëshirën...

Në korridoret e spitalit pamë shumë mjeke e mjekë të veshur me të bardha. Infermieret nxitonin duke shtyrë karrocën me rrotat ku mbanin ilaçet, shiringat e lloj lloj shishesh të vogla me barna. Në dhomën e Taulantit kishte dhe dy të sëmurë të tjerë. Sapo na pa, ai u hodh përjetë nga gëzimi. Deshi të ngrihej, por babai i Orionit nuk e lejoi.

2. Taulantit i ishte ënjtur këmba.

- Si je tani, Taulant? - foli e para Etleva. - A do të rri dhe shumë në spital?
- Më mirë jam, - tha Taulanti dhe e nguli vështrimin te babai i Orionit, si për ta pyetur: “A do të rri shumë në spital?”
- Edhe nja dy-tri ditë. Veç kjo duhet të të bëhet mësim, - shtoi ai me qortim.

3. Mjeku u shpjegon fëmijëve shkakun e sëmundjes.

Mjeku mori një karrige, u ul pranë nesh dhe nisi të fliste shtruar.

- Gjatë lojës mund të ndodhë të vriteni ose të gërvishteni. Shumica prej jush nuk i jep rëndësi kësaj. Kur lëkura e një pjese të trupit çahet dhe gjakoset, ka rrezik të ënjetit e të bëhet plagë. Prandaj ajo duhet mjekuar menjëherë. Duhet pastruar me alkool ose jod dhe të lidhet me fashë të pastër. Ndërsa Taulanti vetëm sa e ka shpëlarë me ujë dhe e ka fshirë me duar të papastra. Nga kjo pakujdesi iu futën në gjak mikrobet dhe këmba iu mahis.

- Çudi, sa të këqija qenkan këto mikrobet! - tha Beni. - Unë s’kam parë ndonjëherë si janë.

4. Fëmijët panë për herë të parë mikrobe në mikroskop.

Babi i Orionit qeshi dhe tha:

- Ejani pas meje, - dhe na futi në një dhomë që quhej laborator.

- Afrohuni me radhë dhe shikoni këtë aparat që quhet mikroskop, - tha mjeku. Ne u afroam njëri pas tjetrit dhe vumë syrin mbi një tub prej xhami. Në fund të tij pamë disa qenie të çuditshme: disa si krimba të gjatë me shumë këmbë, disa të rrumbullakët, me nga një bisht të hollë, disa si ca buburreca të vegjël, shumë të vegjël, që dukej sikur lëviznin në një lëng.

5. Mikrobet ndodhen kudo dhe janë shumë të rrezikshme.

- Ja, këto janë mikrobet, - tha babai i Orionit. - Janë shumë të vogla, nuk shihen me sy, por janë shumë të rrezikshme. Mikrobet ka kudo: në tokë, në ajër. Ato zënë vend e shtohen në sende të papastra, në duar të palara, në thonj të paprerë, në rroba të pista dhe bëhen shumë të rrezikshme kur futen në trup.

6. Kutia e ndihmës së shpejtë është shumë e rëndësishme.

Pastaj babai i Orionit hapi një kuti të ndihmës së shpejtë. Aty brenda kishte një shishe me jod, pambuk, fashë, një kuti me pomadë e ca hapje në një tub prej qelqi. Pastaj ai na tha:

- Në çdo shtëpi duhet të ketë kuti të ndihmës së shpejtë.



Detyrë

Pikat e planit gjenden kollaj edhe nëpërmjet pyetjeve që bëhen për të kuptuar pjesën.

- **Kthehu** te rubrika “Kupto tekstin” dhe shih nëse ato përputhen.

Ndahuni në dy ose tri grupe.

Zgjidhni një nga pjesët e leximit që keni studiuar deri tani. Lexoni me kujdes paragrafët. Nxirrni për çdo paragraf fjalinë kryesore. Krahasoni pikat e planit. Cili grup ka dhënë shkurt dhe në mënyrë të plotë përmbajtjen?



Mbiemri

Fëmijët **e vegjël** këndojnë një këngë **të gëzuar** në kopshtin **e gjelbëruar**. Ana **flokëkuqe** drejton korin. Beni **flokëverdhë** dhe Andi **flokëzi** shoqërojnë vajzat. Ç'fëmijë të **hareshëm** dhe **entuziastë**.



Mbiemri qëndron zakonisht pas emrit dhe tregon cilësinë e tij. Mbiemri e bën më të qartë dhe më të gjallë kuptimin e emrit.

Mbiemrat janë:

të nyjshëm:

e vegjël ,

të panyjshëm:

flokëkuqe,

	Numri njëjës	Numri shumës
Gjinia mashkullore:	kopsht i madh, djalë gazmor,	djem të shkathët, djem gazmorë
Gjinia femërore:	këngë e bukur, vajzë simpatike,	vajza të vogla, vajza simpatike



Ushtrahu

1. Nënvizo me të kuqe mbiemrat e nyjshëm dhe me blu mbiemrat e panyjshëm.

i ëmbël, i athët, kundërmues, i rëndë, i fortë, i mprehtë, i lartë, i zi, gri, jeshil, i qetë, i trishtuar, kaçurrel, serioz, i thjeshtë, kryelartë, krenar, mendjemadh, i gjatë, mesatar, thatanik, i madh, i vogël.

2. Lidh mbiemrin me emrin.

aromë	e ëmbël	djalë	e vogël	nxënës	e hijshme
limon	i fortë	vajzë	mesatar	sjellje	kokëfortë
mollë	i thartë	trup	të shpupurisur	vajzë	i bindur
ftua	e këndshme	flokë	i gjatë	djalë	shembullor

3. Shkruaj në fletore në dy kolona mbiemrat e nyjshëm dhe ata të panyjshëm.

Andi *i vogël* jeton pranë një zonje *të moshuar*. Zonja punon tërë ditën në një makinë *qepëse*. Ajo qep përparëse *të bukura*. Puna *e madhe* e pengon zonjën të gatujë. Andi *zemërmirë* kujdeset shumë për të. Ai sot do t'i bëjë një drekë të *shijshme*. Këputi në kopsht sallatë *jeshile* e rrepa *të kuqe*. Në një tenxhere *të madhe* zieu patate të mëdha. Zonja Fink e falënderoi Andin e papërtuar për gjellën *e shijshme*.




Përshkruajmë me mbiemra

Njerëzit ne mund t'i përshkruajmë nga disa anë:

NGA PAMJA FIZIKE:

Ngjyra dhe lloji i flokëve: kafe, kafe e çelur, kafe e errët, kuqaloshë, të verdhë, të zinj, të kuq, të thinjur; të krehur, të pakrehur, të shpupuritur, të dredhur, të lëshuar, kaçurrelë, të mbledhur, të butë, të ashpër etj.



Tiparet e fytyrës dhe shprehja

Balli: i lartë, i ngushtë, i ulët, i gjerë;

Sytë: të kaltër, kafe, larushë, gri, jeshilë, të zinj;

Shprehja: e gjallë, e gëzuar, e qeshur, e habitur, e qetë, e ëmbël, e trishtuar, e lodhur, e menduar, e inatosur...

Zëri: i ulët, autoritar, i prerë, lutës, bindës, i lartë, i ngjirur, melodioz etj.

Trupi: i gjatë, elegant, i hollë, thatanik, mesatar, normal, i shkurtër, i imët, i shëndoshë, i tretur, i rregullt etj.

Qëndrimi i trupit: i drejtë, i ngrehur, i përkulur, kryelartë, serioz, i shkujdesur, i thjeshtë etj.

NGA KARAKTERI DHE SJELLJA

i dashur, i hapur, i ndjeshëm, i respektueshëm, i gëzuar, i hareshëm, i qetë, entuziast, optimist, pesimist, i trishtuar, melankolik, nervoz, krenar, i qetë, i pasigurt, i paqëndrueshëm, i pavendosur, krenar, mendjemadh etj.



Drejtshkrim

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit

Kur shkruajmë, kemi nevojë të ndajmë fjalën në fund të rreshtit. Le të kujtojmë disa rregulla: kur ndahen dhe kur nuk ndahen fjalët në fund të rreshtit.

Fjalë që ndahen në fund të rreshtit:

a. Ndahen në fund të rreshtit fjalët sipas rrokjeve, kur dy bashkëtingëllore kanë në mes një zanore.

• Si do t'i ndaje në fund të rreshtit fjalët:

molla, bredhi, dorë, punë, lisat, fytira?

Nënvizo rrokjet.



b. Kur ndërmjet dy zanoreve ndodhen dy a më shumë bashkëtingëllore, ndarja është e lirë.

Ko-**dra** ose kod-ra,

po-**sta** ose pos-ta,

ek-**sk**avator ose eks-kavator.

ko-**kr**ra ose kok-rra,

kri-**mb**i ose krim-bi,

ba-**rka** ose bar-ka



Ushtrohu

1. Provo t'i ndash fjalët e mëposhtme në fund të rreshtit:

lëng	populli	këpuca
ngjall	atdheu	lakra
mushka	flutura	lavdia
xixëllonja	tryeza	libri

• Fjalët me shumë rrokje ndaji në disa mënyra.

2. A janë ndarë si duhet fjalët e mëposhtme? Pse? Si do t'i ndaje ti? Provoje.

Shk-ëmb, zmb-raps, ngj-all, kop-sht, përro-it, fto-in, shkr-uan

Fjalët, si: korre, mbjellje ndahen **korr-je** dhe jo ~~ko-rrje~~, **mbjell-je** dhe jo ~~mbje-llje~~.
 I dhimb-shëm dhe jo i ~~dhimbsh-ëm~~

3. Provo si do t'i ndash fjalët e mëposhtme në fund të rreshtit:

bir, funksion, vepra, libra, ketra, dhelpira, shkruan, çast, përkthyesit, pyll, i arsyeshëm, i pavdekshëm, lodhje, i ndershmi, i jashtëzakonshëm, hekurudhë, shitje, yll.

Shkronjat dyshe nuk ndahen kurrë në fund të rreshtit

Kali i vjetër

Një ditë, ndërsa ne fëmijët po ushqenim kalin tonë të vjetër, dëgjuam mamanë që i thoshte babait:

- Nuk e kuptoj pse e mbajmë kalin ende. Më mirë ta shesim. Nuk vlen për asgjë. Vetëm e ushqejmë.

Ne pamë njëri-tjetrin në sy. Na ngriu gjaku, sepse e donim shumë kalin. Ai ishte i urtë dhe ne mund të hipnim kollaj mbi të. Megjithëse kali ishte i vjetër, neve na dukej vetja si kalorësit nëpër filma.

Disa ditë më vonë, kur babai po punonte tokën, traktori i tij bëri një zhurmë të çuditshme. Ai po nxirrte tym. Babai ynë merr vesh nga makineritë dhe e kuptoi se traktorit i ishte prishur një vegël.

Ai shkoi te mekaniku i fshatit.


- Më vjen keq, po këtë pajisje nuk e kam, - tha mekaniku. - Unë do ta porosis atë në qytet. Po, derisa të vijë këtu në fshat, duhet një javë.

- Po tani si do t'ia bëjmë për të pluqur tokën? - pyeti mamaja babanë, kur ai u kthye në shtëpi.

- Mos u mërzit. Kam një ide, - tha babai.

Të dy shkuan në stallë dhe babai i tregoi asaj plugun e vjetër.

- Kali ynë i vjetër do ta tërheqë këtë plug dhe një javë rresht ne nuk do ta ndërpresim punën.





Plugu nuk ishte përdorur që kur babai kishte qenë fëmijë, por ai punonte mjaft mirë. Me pak praktikë babai ia mori dorën plugut të vjetër dhe filloi t'i pëlqente kjo punë. Po ashtu edhe kali dukej se ishte i kënaqur që po na ndihmonte. Edhe ne u gëzuam dhe shkoni pas tyre. Ndërsa mamaja nuk e shau më kalin tonë të vjetër.

Xhon Petiëns

Fjalorth

na ngriu gjaku - u trembëm shumë

pajisje – vegël

plugu – vegël prej hekuri që përdorin fshatarët për të punuar tokën.

plugoj tokën – punoj tokën me plug për ta mbjellë

me pak praktikë – duke e përsëritur një punë

ia mori dorën - e mësoi ta përdorte

Pyetje rreth tekstit

1. Pse u trembën fëmijët nga fjalët e mamasë?
2. Çka ndodhi disa ditë më vonë?
3. Çka i tha babait mekaniku i fshatit?
4. Cila është zgjidhja që gjeti babai?
5. A kishte të drejtë mamaja që tha se kali i vjetër nuk vlente?

Kthehu te teksti

Shëno me dhe fjalitë e mëposhtme:

- Fëmijët e donin kalin e vjetër.
- Babai donte ta shiste kalin e vjetër.
- Traktori kishte nevojë për disa vegla të reja.
- Toka plugohet me autokombajnë.
- Plugu ishte përdorur kur babai ishte fëmijë.
- Derisa traktori u rregullua, toka nuk mbeti pa punuar.

Si mendon ti?

1. A duhet t'i shajmë gjërat e vjetruara?
2. A mund të vlejné dhe ato?
3. Numëro disa sende të vjetra, që ke në shtëpi:
 - një lodër të vjetër
 - një enë të vjetër, që e ka pasur gjyshi
 - një veshje të prindërve, kur kanë qenë fëmijë etj.

◆ Shikoji me kujdes ato. Paramendo se si kanë qenë të reja. Thuaj përse janë përdorur.

Mos harro
Sa herë që blejmë një gjë të re, duhet të falënderojmë më parë gjënë e vjetër.

MOS....

Kur dëshiroja diçka,
më thoshin: Mos, mos, mos!

Kur dëshiroja diçka
që e kisha aq qejf.

Ruhu nga zjarri,
më thoshte ungji,

Mos qesh në klasë,
më thoshte mësuesja.

Mos u afro te pushi,
më thoshte gjyshja.

Mos vrapo kaq shpejt,
do të qullesh në djersë;

Mos bisedo në rrugë,
mos vështro përpjetë;

Mos vështro djathtas,
këtëj është luleshitësja.

Mos vështro majtas,
Këtëj është librashitësi.

Mos e kalo lumin,
mos hip në kodrinë,
mos u fut në pyll.

Unë mora një kapelë,
duke qeshur me vete,
mora kapelë e shkop,
dhe thashë: Mos, mos!

Mos lumin e kodrinën,
pyjet e mëdha: mos, mos,
mos, mos sytë e bukur
dhe problemat sidomos!

*Andre Spire
(Përktheu: Ndoc Papleka)*

Pyetje rreth tekstit

1. A ju pëlqen poezia? Pse?
2. Kë imiton djali në dy strofat e fundit?
3. A ju bën për të qeshur vargu i fundit?
4. Cilët kritikon djali me këtë poezi:
të rriturit
apo
veten e tij?
5. A është e lehtë kjo poezi për t'u mësuar përmendsh? Pse?

Plotëso

Poezia ka **strofa**.
Strofat kanë secila **vargje**.
Fjala **mos** përsëritet herë.

Detyrë

Mësoje poezinë përmendsh. Recitoje atë bukur,
duke imituar zërat e të rriturve. (Kujdes, secili
prej tyre ka zë karakteristik.)



Tema dhe ideja e poezisë

- Cila është **tema** e poezisë?

- Pasi mbarove së lexuari poezinë, a t'u duk sikur e kishe shkruar ti? Pse?

Poeti ka kujtuar fëmijërinë e tij. Edhe ai, kur ka qenë i vogël, e ka ndier kujdesin e tepruar të të rriturve.

Përfytyroje veten të rrethuar vetëm nga:

~~mos
mos mos mos
mos mos mos mos
mos mos mos~~

Çka ndien brenda vetes:

të merret fryma
të pritët oreksi
të shtrëngon zemra
hidhërohesh
sheh shpesh nga dritarja
thua shpesh: Ah sikur...!

- Cila është **ideja** e poezisë (mesazhi i poetit)?

A nuk të vjen që edhe ti t'u thuash të rriturve me zë të lartë: MOS!

Atëherë ngrije dhe ti zërin, sepse në këtë rast ke të drejtë. Është e drejta jote për të ngritur zërin. Sepse po ndenje urtë, do të mendojnë se trembesh. Ose do të mendojnë se ndihesh mirë ashtu i ndrydhur. Mendo se ke gjithnjë pranë dikë që të mbrohet. Ky është poeti, miku më i mirë i gjithë fëmijëve të botës.

- Diskuto me shokët për të gjitha këto. Duhet t'i shprehësh hapur ndjenjat e tua.

Pastaj përgatitni për të rriturit disa **këshilla** që fillojnë me fjalët:

BOTËS SË TË RRITURVE

Mos na i ndrydhni dëshirat.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



VIZATIMI I VOGËLUSHES

- Ç'është kjo që ke vizatuar,-

Më pyeti mësuesja e re?

- Është mamaja ime, - dy herë përsërita,

Për kokën e mamit ju bëj be.

- Po nënat s'janë ngjyrë portokalli,

as të blerta ato nuk janë,

Mos vizatoni kurrë me njolla,

se pikturat kuptim nuk kanë.

Pa fillo ta vizatosh përsëri,

se nuk është ndonjë punë e rëndë.

Flokët e krehur me kujdes

Në dorë çantën e trupin drejt.



- Të lumtë, - mësuesja më tha,

- vizatimin e ke bërë mirë ...

Po kur takoi atë ditë nënën time,

për një çast mbeti e ngrirë.

Ajo kishte veshur fustanin e blertë,

Si dhe bluzën e portokalltë,

Në kokë kishte një kapelë rozë,

Siç e kisha vizatuar në klasë.

Mësuesja uli kokën, kur e pa,

- Vogëlushe, më fal, - më tha.

Vizatimi yt nuk kishte asnjë të metë,

ti kishe vizatuar nënën e vërtetë.

? Pyetje rreth tekstit

1. Kë kishte vizatuar vajza?
2. Pse mësuesja nuk e pëlqeu vizatimin e saj?
3. Si ishte në të vërtetë mamaja e vogëlushes?
4. Cila kishte të drejtë: vajza apo mësuesja? Pse?
5. A të pëlqen si veprroi mësuesja në fund të vjershës?

Plotëso

- Fustani i nënës ishte ngjyrë portokalli.
- Bluza e nënës ishte e blertë.
- Kapela e nënës ishte ngjyrë rozë.
- Vizatimi i vajzës kishte të meta.
- Mësuesja i kërkoi të falur vajzës.



Portreti i nënës sime

Në poezinë “Vizatimi i vogëlushes” mësuesja gaboi, sepse kishte në mendje një portret tjetër për nënën. Çdokush prej nesh sapo dëgjon fjalën “nënë” përfytyron nënën e vet. Bëj përshkrimin e nënës duke përdorur fjalë nga thesi i fjalëve në f.38.

Tiparet e fytyrës:

.....

.....

.....

Trupi:

.....

.....

Ecja:

.....

.....

Sjellja:

.....

.....

Cilësitë e karakterit:

.....

.....

.....

- Shiko tablonë. Atje është pikturuar një nënë me fëmijën e saj, në vitin 1906. Thuaj me fjalë dallimin ndërmjet saj dhe nënës sate.



P. A. Renoir, *Shëtija*, 1906.

Është fat të kesh një shoqe si Fatbardha

E dashur revista “Ylberi”,
Ti tani je bërë mikja ime më e dashur, prandaj po të shkruaj. Unë jam Eneida, një vajzë në klasën e katërt. Dua të të shkruaj për shoqen time të ngushtë Fatbardhën. Ashtu si emrin, ajo ka edhe zemrën.

Bardha është një vajzë rome shumë e lezetshme. Ajo ka flokë të zinj dhe sy të gjelbër. Vrapon shumë shpejt dhe ka një zë të mrekullueshëm. Unë u njoha fare rastësisht me të. Familja ime banon pranë rrugës ku jetonë shumë familje rome. Shumë prindër i këshillojnë fëmijët e tyre që të mos shoqërohen me ta. Dhe kështu, edhe mua, pa dashjen time, m’u krijua mendimi se duhet të rrija sa më larg fëmijëve romë.

Por një ditë, pa arritur ende te pallati im, dëgjova një të lehur qeni. Fillova të vrapoja, ndërsa ai m’u sul edhe më keq. Atë kohë nga porta aty pranë doli një vajzë, e cila e shtyu qenin

me shkop, duke i bërtitur:

- Ik, ik, qen i keq!

Por ndërkaq ai e kafshoi në dorë. Unë fillova të bërtisja e të qaja me të madhe. Shumë të rritur na u afruan. Erdhi dhe i zoti i qenit duke vrapuar. Ai po thoshte se e kishte qenin të vaksinuar. Fatbardha nuk nxirrte asnjë fije zëri, vetëm e mbante grushtin të shtrënguar. Shkopi i kishte rënë nga dora.

- Eja, - i thashë, shkojmë në shtëpinë time. Unë e kam mamin infermiere.

Fatbardha tundi kokën në shenjë pohimi dhe erdhi pas meje.

Kur po hynim në shtëpi, mami po dilte, se kishte turnin e dytë. Unë fillova t’ia shpjegoja të gjitha, ndërsa mami hapi kutinë e ndihmës së shpejtë dhe filloi t’ia mjekonte plagën Fatbardhës.

- Tani, hajde të shkojmë te shtëpia e Fatbardhës t’i njoftojmë, sepse kjo vajzë duhet patjetër të bëjë vaksinën.

Nuk i zihet besë të zotit të qenit.

Dhe ashtu bëmë. Fatbardha i duroi gjilpërat si heroinë. Shtrëngonte dhëmbët dhe herë pas here i shpëtonte ndonjë lot nga sytë. Nuk e di, po atë çast u ndieva keq. Ajo po vuante për shkakun tim. Fatbardha e kuptoi gjendjen time, më shihte me sytë e gjelbër plot dashuri dhe vinte buzën në gaz.

Që atëherë ne jemi bërë shoqe të ngushta. Dhe ta dini, Fatbardha jo vetëm më shpëtoi prej qenit, por prej saj njeriu mund të mësojë shumë gjëra. Edhe ajo thotë se është me fat që më ka mua shoqe.

E dashur revistë,

gjithandej shkruhet e thuhet se ne të gjithë jemi njëllor, pavarësisht nga raca, ngjyra, feja e të tjera si këto. Ndërsa unë thjesht doja të të tregoja një gjë të vërtetë që më ka ndodhur mua.

Me dashuri, Eneida



Dëgjojmë

Pas leximit të mësueses duhet të plotësosh:

revista titullohet “Ylberi”
vajza që shkruan letrën
shoqja e saj
ngjyra e syve.....
ngjyra e lëkurës.....
ngjyra e flokëve
Cilën kafshoi qeni?.....
Kush e mjekoi?.....
Cila nga vajzat është me fat për shoqen që ka zgjedhur?

Diskutoni në grup

Lexoje dhe një herë me zë të lartë paragrafin e fundit të letrës.

- Pse Eneida ia ka dërguar këtë letër revistës:
 - për t’i bërë qejfin Fatbardhës,
 - për të treguar se di të shkruajë bukur,
 - për t’u dhënë një mesazh bashkëmoshatarëve të saj?
- Cili është **mesazhi** që u përcjell bashkëmoshatarëve të vet Eneida?



Letër revistës për fëmijë

Sipas modelit të letrës së mësipërme shkruaj dhe ti një letër.

TEMA : Të gjithë jemi njësoj, pavarësisht nga ngjyra e lëkurës, nga gjendja shëndetësore, nga prejardhja etj.

Së pari. Zgjidh revistën ku do ta dërgosh letrën.

Së dyti. Mos harro të vësh datën

Së treti. Drejtoju revistës.

Së katërti. Meqë këtu ngecin të gjithë, me siguri dhe ti do të kruash kokën. Por mos u tremb. Fillimi është gjithnjë i vështirë.

Mendoje mirë se në **ç'formë** do ta dërgosh letrën.

- Mund të shkruash diçka nga përvoja jote: P.sh., *Edhe unë kam një shok rom... Ose: Shoku im është i ndrojtur, sepse i merret goja... ose Nuk rrija dot pa ju shkruar për një ngjarje që më ka ndodhur...*

- Mund të shfaqësh mendimet e tua për këto probleme kaq të rëndësishme: P.sh., *Të rriturit na këshillojnë dhe na mësojnë shumë gjëra me vlerë. Por ndonjëherë harrojnë se çfarë kanë thënë. Sot në botë shumë njerëzve u shkelen të drejtat. Unë mendoj se.....*

Së pesti. Mos harro përshëndetjen e fundit.



Mëso më shumë

- Nëse do ta nisësh letrën me postë, shkruaje adresën në zarf.
- Nëse do ta nisësh nëpërmjet kompjuterit, me postë elektronike, atëherë duhet ta shkruash letrën edhe një herë në kompjuter.
- Kontrollroje mirë revistën, se në fund të faqes së parë ose të fundit mund të jetë adresa e saj postare ose elektronike.

Atij pëllumbi të bardhë
(në botë më i miri),
që në sqep fort mban
një degëz ulliri...

Atij pëllumbi të lehtë
që po fluturon,
e besoj vërtetë
kur Dreni e pikturon..

Në sytë e tij ninëzat
e tua po shkrihen,
e në zemër ritmet
me tuat përtërihen...

Vizatoje, ngrije n' erë
duke e mbajtur në dorë,
sille disa herë
rreth globit tokësor!

Rifat Kukaj

PËLLUMBI I BARDHË



? Pyetje rreth tekstit


Fjalorth
ninëz/ë - bebja e syrit

1. A ju pëlqen pëllumbi? Pse:
ka ngjyrë të bardhë,
është shpend i butë,
 2. Çka tregon dega e ullirit? Përse të rriturit e quajnë pëllumbin shpendi i paqes?
 3. Në cilat vargje i krahason poeti:
sytë e fëmijës me sytë e zogut,
ritmet e zemrës së pëllumbit me ato të fëmijës?
- Vizato dhe ti një pëllumb me flatrat e hapura duke fluturuar.

Detyrë

- Mësoje vjershën përmendsh dhe recitoje me zë të ëmbël.

Rubrika II



Unë mësoj nga miqtë e mi



Mirëserdhët në klubin e miqve të mirë!

Klubi i miqve

Dy miqtë e ngushtë Ina dhe Arjani donin të krijonin një klub. Po për të bërë një klub duhen më shumë se dy veta. Prandaj ftuan fillimisht Ilirin, Arditin dhe Mimozen. Kështu ata u bënë pesë veta dhe e shpallën të krijuar "Klubin e miqve". Pastaj vendosën që të bënin rregulloren e klubit, me qëllim që ai të zgjerohej edhe me anëtarë të tjerë. Pasi u mbledhën të pestë, diskutuan gjatë ndërmjet tyre dhe më në fund, shkruan disa rregulla.

Rregullat e klubit

Miqtë mbeten miq edhe sikur njëri të shkojë diku larg.

Miqtë e mirë i ndajnë gjërat me njëri-tjetrin.

Miqtë e ndihmojnë shokun kur ka nevojë.

Miqtë nuk e kanë zili shokun.

Miqtë duhet ta kuptojnë njëri-tjetrin edhe pa folur.

Miqtë asnjëherë nuk duhet t'i tregojnë të fshehtat e të tjerëve.

Miqtë nuk duhet ta mbajnë gjatë inatin.

Çdokush mund të jetë anëtar i klubit, pavarësisht nga ngjyra e lëkurës apo nga problemet shëndetësore.



? Pyetje rreth tekstit

1. Sa veta duhen për të krijuar një klub?
2. Sa rregulla shkruan gjithsej shokët?
3. Çka tregojnë fjalët në hyrje të klubit?
4. Çka tregon rregulla e fundit?

! Po ti?

- A je në ndonjë klub ose në ndonjë shoqatë?
 Thuaj disa rregulla që keni vendosur bashkë.
 A i respektoni të gjithë këto rregulla?
 Ndosht që ndonjë shok të largohet nga klubi?
 Pse? Trego se si keni vepruar ju.

Rregullorja

Vendose veten në situatat e mëposhtme. Në rregulloren tuaj të vjetër mungojnë disa rregulla që duhet t'i shtoni.

Shkruaj nga një rregull për secilën situatë.

Situata 1

Një vajzë rome sapo ka ardhur në lagjen tuaj. Ajo do të hyjë në klubin e miqve. Vera dhe Artini kundërshtojnë. Ti dhe shokët e tjerë doni ta pranoni. Për këtë duhet të shkruani një rregull.

Situata 2

Majlinda do të bëhet anëtare e klubit tuaj. Ju nuk pranoni, sepse e dini që ajo nuk di të mbajë të fshehta. Pasi ajo ju lutet shumë, ju pranoni, por shkruani një rregull që Majlinda ta ketë parasysh.

Situata 3

Edi do të shkojë të jetojë me prindërit jashtë shtetit. Ai ju lutet të mbetet përsëri anëtar i klubit. Disa nga ju e kundërshtojnë, por shumica është e mendimit se duhet të shkruhet një rregull për këtë rast.

Situata 4

Mira ka fituar çmimin e parë në konkursin e piktorëve të vegjël. Dy nga shoqet tuaja u mërzitën, sepse donin të fitonin vetë. Ato thanë që pikturat e Ermirës nuk ishin aq të mira. Ju i këshilluat t'i kërkonin të falur shoqes dhe menduat se ishte e nevojshme të shtohet një rregull për këtë gjë.



Pjesët kryesore të fjalisë



Vajza lexon.

Kryefjala dhe kallëzuesi janë pjesët kryesore të fjalisë.



Djali vrapon.

Kryefjala tregon për kë flitet. Ajo gjendet me pyetjet: Kush?, Cili?, Cila? etj.

Kush lexon? **Vajza.**

Kallëzuesi tregon se ç' bën kryefjala. Ai gjendet me pyetjen Ç'bën? Ç'bën vajza? **Lexon.**

Po të ndryshojë kryefjala, ndryshon edhe kallëzuesi. Nëse kryefjala është në numrin shumës, edhe kallëzuesi (folja) vihet në numrin shumës. *P.sh.: Djali vrapon. Djemtë vrapojnë.*

Ushtrohu

1. Lidh me shigjetë kryefjalën me kallëzuesin.

Ai	kanë të drejtat e tyre.
Ana e vogël	ke dy kanarina në shtëpi.
Ti	ka shumë shoqe.
Unë	janë shokët e mi.
Artani dhe Dritani	lexoj shumë libra.
Fëmijët	shkoni çdo ditë në stërvitje.
Ju	është shoku im.

Kryefjala zakonisht qëndron para kallëzuesit.

2. Nënvizo me të kuqe kryefjalën dhe me blu kallëzuesin.

Nata **është** e errët. Hëna ndrit në qiell. Pemët ndriçojnë nga drita e Hënës. Peshqit kërcëjnë në ujë. Një djalë rri buzë liqenit. Ai mban në dorë kallamin me grepin. Djali ka në kokë një kapelë të kuqe. Peshqit afrohen te grepi. Djali kapi shumë peshq atë natë.

3. Shkruaj si duhet kallëzuesin që është në kllapa.

Sot unë (kemi)ditëlindjen. Ne po (festoj) Unë po (bën) listën e gjërave. Mami me nënën po (bëj) një tortë të madhe. Unë (presim)..... me padurim shokët. Ata më (dhuroat)..... një robot.



Macja jonë Kiti

(Intervistë)

Drita, Ana, Vjollca dhe Ina janë shumë shoqe. Me to shpesh rri dhe vëllai i vogël i Inës, të cilin ajo e merr me vete. Ato na u lutën t'u bënim disa fotografi me macen e tyre të përbashkët, Kitin, për revistën tonë. Ndërsa ne u morëm atyre një intervistë.

Gazetarja: E kujt është kjo mace?

Vajzat: E të gjithave.

Gazetarja: Po kush e mban, kush e ushqen?

Ana: Këtë mace e kemi gjetur. Një të diel ne kishim dalë të luanim dhe e pamë macen te rrugica e lagjes.

Drita: Ne na erdhi shumë keq për të, se ishte shumë e vogël dhe e pambrojtur.

Vjollca: Ajo kishte humbur mamanë. Si mund ta linim në mes të rrugës?

Gazetarja: Po ju çfarë bëtë?

Ina: Ne e morëm ngadalë në dorë,

e përkëdhelëm dhe vendosëm ta ushqenim derisa të rritej.

Ana: Ne e mbanim me radhë në shtëpi, megjithëse prindërit na shanin.

Gazetarja: Çfarë ju thoshin ata?

Drita: Pse ju do t'i mbani tërë kafshët e rrugës? Ne nuk jemi të përgatitur për të mbajtur mace.

Ana: Ne qanim, atyre u vinte keq dhe kështu kalonin ditët, Macja po rritej nga pak.

Gazetarja: Me çfarë e ushqeni atë?

Drita: Me sakrificë... Me lekët që na japin prindërit, ne blejmë qumësht dhe ushqim për macen.

Gazetarja: Po emrin kush ia vuri?

Vjollca: Ia vuri Sigi. Ajo ka dhe një qen që quhet Ledi.

Drita: Po më shumë nga ne të gjitha për të kujdeset Ana.

Ana: Njëherë unë dhe Drita po luanim

me çunat futboll dhe e lamë macen në bar. Aty pranë kaloi një qen i madh dhe iu sul Kitit. Ajo mjaulliu e frikësuar. Sigi iu sul me shkop qenit, ndërsa unë e mora Kitin dhe i thosha: "Shpirt i vogël, mos qaj se na ke ne këtu".

Ina: Tani nuk e mbajmë ne macen.

E gjetëm mamanë e saj dhe e lamë të lirë. Për kujtim po bëjmë këto fotografi.

Ana: Unë kam shkruar diçka në ditarin tim për Kitin. A do të ma botoni?

Gazetarja: Patjetër. Dhe tani, mirupafshim, vajza!

Pyetje rreth tekstit

1. Me kë e bëri intervistën gazetarja?
2. Ku e kishin gjetur vajzat macen?
3. Si e ushqenin atë?
4. Kush e mbante në shtëpi?
5. Çka donte të dinte gazetarja për prindërit e vajzave?
6. Cila nga vajzat kishte shkruar në ditar për Kitin?



Kthehu te teksti

- ◆ Gjej cila nga fjalitë e vajzave është pyetëse.
- ◆ Gjej cila nga fjalitë e gazetares nuk është pyetëse.
- ◆ Gjej në tekst:
 - të kundërtën e fjalëve *u vinte mirë*;
 - fjalinë që tregon se kush e mbante macen në shtëpi;
 - fjalinë që tregon se gazetarja do të dijë se kush e ushqen macen;
 - fjalinë ku përdoren fjalët *shpirt i vogël*.

Po ti?

- A të pëlqen sjellja e vajzave?
- Për çfarë kanë të drejtë prindërit e tyre dhe për çfarë nuk kanë?
- Një mackë e vogël mjaullin në të qarë, sepse:
 - ka uri,
 - ka mbetur në një pellg me ujë,
 - është drejtuar nga rruga ku kalojnë makinat,
 - dikush po e gjuan me gur.

Çka do të bëje ti?

- ◆ Bëji pyetje shokut të bankës për kafshën shtëpiake që ai pëlqen ose që mban në shtëpi.



Intervista



- ◆ Kur do që të bësh një intervistë, është mirë t'i përgatitësh më parë pyetjet. Pra, duhet ta kesh të qartë se për ç'qëllim do ta pyesësh personin që interviston.
- ◆ Zgjidh një ose dy nga situatat e mëposhtme.

Situata A

Ti do të dish se si ka qenë mësuesja jote në kohën e fëmijërisë. Shkruaj katër pyetje për mësuesen.

Situata B


Shkruaj katër pyetje që do t'i bësh një shkrimtari për fëmijë. Ti do të dish se kur ka filluar të shkruajë, çfarë librash ka shkruar etj.

Situata C

Shkruaj katër pyetje që do t'i bësh një shoku. Ti do të dish disa të dhëna për familjen e tij.

Situata D

Shkruaj katër pyetje që do t'i bësh kryetarit të *Klubit të miqve*. Ti do të dish se sa anëtarë të rinj kanë hyrë kohët e fundit; a është larguar ndonjë anëtar i vjetër etj.



PËRDOR KËTO PYETJE:

Kur ke qenë...?

Çka ke bërë...?

Çka të ka pëlqyer...?

Kur ke filluar...?

Sa anëtarë...?

A keni pasur...?

Sishkonit...?

Pse ka ndodhur që...?

NJË DISKUTIM NË KLASË



Ditën e parë të shkollës mësuesja solli në klasë Ermalin, nxënësin e ri të klasës.

Për ta njohur me ne, mësuesja hapi një diskutim me temë: "Ku është më mirë të jetosh, në fshat apo në qytet?"

- Le ta pyesim më parë Ermalin, se si ndihet ai larg vendlindjes,- tha mësuesja.

Fillimisht Ermali u skuq dhe belbëzoi ngadalë:

- Mirë..., jo dhe aq mirë..., çka.
- Disa nxënës filluan të qeshnin.
- Mos qeshni, - u tërhoqi

vëmendjen mësuesja, - kini durim. Ermali është ca i ndrojtur, sepse sapo është njohur me ju.

- Mësuese, - ngriti dorën Dritoni, - a mund t'i bëj një pyetje Ermalit?
- Patjetër, Driton.
- Ermal, për çfarë të merr më shumë malli tani që je larg?
- Për kopshtin, - u çel Ermali. - Sa bukur është të rrih në kopshtin para shtëpisë!
- Eh, porqe ka sa të duash edhe këtu, - u hodh Artini.
- Më merr malli dhe për shokët e shoqet e klasës, mësuesen, fqinjët e rritur, teta Shpresën që pastronte rrugicën, xhaxhi Gimin që na rregullonte dritat...,- vazhdoi me të vetën Ermali.
- Kjo është një gjë e mirë, se tregon që ti, Ermal, ke pasur shumë miq. Por edhe këtu mund të gjesh plot, - i tha me dashuri mësuesja.
- Eh, këtu ka kaq shumë njerëz!... S't'i hedh njeri sytë. Ne në fshat i përshëndetim të gjithë, kur kalojmë në rrugë.
- Epo, dihet, qyteti ka shumë më tepër banorë se fshati, - tha si me mburrje Elona.
- Jo, pse? - kundërshtoi Lindita. - Lagjja ku banoj unë i ngjan fshatit tënd, Ermal. Ne e njohim shumë mirë njëri-tjetrin.
- E shikon, Ermal? Mbase janë ditët e para dhe qyteti të ka futur frikën, - ndërhyri mësuesja.



- Mësuese, - mua s'më pëlqen të banoj në fshat, sepse në qytet ndihem më i rëndësishëm, më modern, - foli me zë të lartë Berti.
- Ti je budalla, - e shau atë Elona, shoqja e bankës.
- Elona, mos e shaj shokun, ndërsa ti, Berti, mos e ngri aq shumë zërin, - u tërhoqi atyre vërejtje mësuesja.
- Mësuese, - mori leje për të folur Dritoni, - unë mendoj se për të qenë njeri i mirë dhe modern nuk ka rëndësi ku jeton, në fshat apo në qytet.
- Mësueses i ndriti fytyra nga përgjigjja e tij. Edhe shokët e miratuan duke lëvizur kokën.
- Unë mendoj se në fshatin e Ermalit ka shumë gjelbërim dhe ajri është i pastër, - tha Dritoni.
- Po, ashtu është, - pohoi Ermali. Ai filloi ta ndiente veten si në shtëpinë e tij.

R. P

Pyetje rreth tekstit

1. Ku kishte banuar më parë Ermali?
2. Pse në fillim ai ishte i ndrojtur?
3. Për çfarë e kishte marrë malli Ermalin?
4. Përse diskutuan shokët e klasës dhe mësuesja?
5. Kujt i tërhoqi vëmendjen mësuesja? Pse?
6. Si u ndie Ermali në fund të diskutimit?

Fjalorth

bëlbëzoj - flas duke m'u mbajtur goja *shpërngulem* – iki nga vendi ku banoj dhe shkoj për të banuar në një vend tjetër.
modern – që ka tiparet më të përparura të kohës.
miratoj – pajtohem me diçka; e quaj diçka të drejtë.

Plotëso

Bëj dallimin ndërmjet qytetit dhe fshatit.



rrugë të gjera

.....


.....

.....

.....

.....

.....



.....

.....

.....

.....

.....

.....



Diskutimi, biseda dhe dialogu

• Kthehu te tregimi: *Një diskutim në klasë.*

1. Cila ishte **tema** e diskutimit?
2. Kush e **udhëhiqte** diskutimin?
3. Cilët **morën pjesë** në diskutim?
4. **Ç'gabime** bënë gjatë diskutimit Berti dhe Elona?

• Bëj dallimin.

RREGULLAT GJATË DISKUTIMIT

- Mendohu para se të flasësh.
- Shprehu qartë.
- Mos e ngri zërin dhe shmang përsëritjet e shpeshta.
- Dëgjo me vëmendje atë që thonë të tjerët.
- Mos e ndërprit tjetrin kur flet.
- Fol kur të të vijë radha.



1. Në një **diskutim**, dy ose më shumë persona **i thonë njëri-tjetrit** mendimet e tyre për një **çështje të veçantë**.



2. **Biseda** është një bashkëbisedim ndërmjet dy ose më shumë njerëzve. Ata flasin **për të forcuar miqësinë, për të kaluar kohën e lirë, për të shkëmbyer ide dhe mendime...**



3. **Dialogu** është një bisedë ndërmjet **dy** ose më shumë njerëzve **që bëhet me pyetje e përgjigje**.

Punë në grup

Ndahuni në tri grupe. Secili grup të zgjedhë nga një temë për: **diskutim, bisedë, dialog.**

Së bashku me mësuesen secili grup të realizojë detyrën, duke respektuar rregullat gjatë diskutimit.




Rendi i pjesëve plotësuese të fjalisë

Kujto

Cilat janë pjesët kryesore në fjalinë: *Vajza këndon?*

Në fjalinë *Vajza kërcen* shtojmë pjesë plotësuese



Fjalët që shtuam sollën të dhëna të reja për kryefjalën dhe kallëzuesin.

Pjesët plotësuese gjenden me pyetje të ndryshme:

Si.....? E vogël.
Ku....? Në oborr.

Pjesët kryesore mbajnë kuptimin kryesor të fjalisë.

Pjesët plotësuese plotësojnë kuptimin e kryefjalës dhe të kallëzuesit.



Ushtrohu

1. Pjesëve kryesore të fjalisë shtoj fjalë plotësuese.

P.sh.: Peshku i kuq noton në akvarium.

Këngëtari këndon
 Piktori pikturon
 Fëmijët ndihmojnë
 Qenushët..... luajnë.....
 Dielli..... ndriçon.....
 Zogu..... këndon.....

Pjesët plotësuese zakonisht qëndrojnë pas pjesëve që plotësojnë. Por ka pjesë që mund të ndryshojnë vend dhe kuptimi i fjalisë nuk ndryshon.

2. Gjej pjesët kryesore dhe pjesët plotësuese. Shkruaji ato në dy shtylla në fletore.

Një buburrec i zi po kërkonte ushqim. Një flutur e kuqe qëndronte mbi një lule. Një milingonë e vockël po shtynte një kokërr gruri. Zogu pushverdhë këndonte mbi degën e pemës.

3. Ndrysho vendin e pjesëve të fjalive të mësipërme, pa e prishur kuptimin e saj.

4. Shkruaj në vendin e duhur këto pjesë plotësuese: shumë, letër, e Dajtit, nëpër pyje e livadhe, me teleferik, në dimër, ekskursionë.

Arjeta i shkruan (çfarë?)..... Norës. Nora mësoi (sa?) për malin (e kujt?) Malet mbulohen me dëborë (kur?) Rruga për në majë kalon (ku?) Njerëzit ngjiten në majë të malit (me çfarë?) Fëmijët organizojnë shpesh (çfarë?)

Tri gëzimet

- O çun, çfarë po pret në kopsht?

Çuni nuk flet. I pëlqen një mollë e kuqe në majë të degës. E shkund degën me një shkop të gjatë dhe molla bie.

Një mollë dhe një gëzim për çunin e vogël.

Te lumi i kaltër çuni gjen peshkatarin. E përshëndet dhe ulet pranë tij. Shikon si rriten rrathët e valëve, kur peshkatarin hedh grepin në ujë.

- A ka peshq të mëdhenj këtu, xhaxha?

- Ka, - thotë peshkatarin.

- A ka sa dora ime?

- Edhe më të mëdhenj, por... Mos fol tani se edhe ata më të mëdhenjtë mund të frikësohen prej teje.

Çuni shtrihet mbi bar dhe ëndërron një peshk të madh sa një dorë, sa një njeri, sa një pemë... Por të gjithë ata frikësohen prej tij dhe kjo i jep njëfarë kënaqësie.

Peshkatarin i fal një peshk çunit. Ja, i shtohet dhe një gëzim i dytë.

Çuni vrapon nëpër kopsht. E merr shportën ku mban mollën dhe vë në të edhe peshkun. Ashtu shend e verë vrapon te shtëpia. Në hyrje të lagjes takon fëmijën e parë. Duket një fëmijë i mërzitur.

-Hej, unë kam një mollë të kuqe! Unë kam edhe një peshk! - i thotë ai plot gëzim. Djali tjetër hesht.

"O ti që ke peshkun dhe mollën, gëzimi i një njeriu nuk zgjat gjithmonë. Pse, atëherë, s'i ndajmë gëzimet bashkë?" - i thotë një zë nga brenda.

Çuni ia zgjat shportën djalit të mërzitur dhe i thotë:

- Hajde t'i ndajmë bashkë, edhe mollën, edhe peshkun.

Kështu lindi gëzimi i tretë dhe ky gëzim jeton gjatë.



Vehbi Kikaj




Fjalorth

shend e verë - shumë i gëzuar

Pyetje rreth tekstit

1. Cili është gëzimi i parë i djalit? **Si** e fitoi djali atë?
2. Cili është gëzimi i dytë i djalit? **Kush** ia dhuroi atë?
3. Cili është gëzimi i tretë i djalit? **Kujt** ia dhuroi atë djali?
4. Pse gëzimi i tretë jeton më gjatë se dy të parët?



Kthehu te teksti

Shëno me dhe fjalitë e mëposhtme:

- Çuni këputi një mollë të gjelbër nga pema.
- Çuni ëndërron një peshk sa një njeri.
- Çuni mërzhitet që peshqit frikësohen prej tij.
- Çuni ka dy gjëra në shportë.
- Djali tjetër i lutet çunit t'i ndajnë gjërat bashkë.




◆ Gjej në tekst

- Sa herë është përdorur fjala *gëzim*? _____
- Sa herë është përdorur fjala *çun*? _____



Po ti?

- A veptoi mirë djali që i ndau dhuratat me djalin tjetër?
- Po ti nëse ke diçka, a të pëlqen ta ndash me të tjerët?
- Kur mendon ti se veprimi yt është më i rëndësishëm:
 - kur i fal dikujt diçka
 - apo
 - kur e bën të lumtur?
- Pse mendon kështu?





Krahasimi dhe kuptimi i figurshëm


Po ti?

Po ty a të pëlqen të bësh krahasime? Pse?

Plotëso

Kur jam në det, më pëlqen të bëhem	si
Kur jam në majë të malit, më pëlqen të bëhem	si
Kur jam në prehër të mamit, më pëlqen të bëhem	si
Kur jam mes fushës së gjelbër, më pëlqen të bëhem	si
Kur shoh lulet shumëngjyrëshe, më pëlqen të bëhem	si
Kur më tremb dikush, më pëlqen të bëhem	si
Kur jam në gara më pëlqen të bëhem	si

- Diskuto për të gjitha rastet e mësipërme.
- Shiko figurat. Me cilët i pëlqen djalit të krahasohet?





Zgjerimi i fjalisë së vogël

Kujto Pjesët plotësuese plotësojnë kuptimin e kryefjalës dhe të kallëzuesit.

◆ Cilat fjalë iu shtuan kryefjalës dhe cilat kallëzuesit?



Fjalja më e vogël është: **Djali ha.**

Kjo fjali u zgjerua duke i shtuar kryefjalës dhe kallëzuesit fjalë plotësuese:

Djali + me syze
Ha + mollën e kuqe.

Kryefjala dhe kallëzuesi mund të zgjerohen edhe me fjalë të tjera.



• Zgjero fjalinë **Djali këputi** me fjalët e dhëna më sipër.

Në grupin e kryefjalës, në përgjithësi, fjalë kryesore është **emri**.
Në grupin e kallëzuesit fjalë kryesore është **folja**.

Fjalja mund të zvogëlohet duke i hequr grupit të kryefjalës dhe grupit të kallëzuesit pjesë plotësuese.

Kujdes! Fjalisë i hiqen ato fjalë që nuk i prishin kuptimin.

Ushtrahu

1. Futi në etiketa me ngjyra të ndryshme grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit. Me çfarë pyetjesh e gjete fjalën kryesore të çdo grupi?

Shokët e Inës **krijuan** **Klubin e Miqve.**

Klubi i tyre kishte pesë veta.

Fëmijët e vegjël hartuan rregullat e Klubit.

Anëtarët e rinj diskutuan për rregullat e klubit.



2. Lidh grupin e kryefjalës me grupin e kallëzuesit.

Fatmiri i vogël	çuditën me macet e Fatmirit.
Hapat e mamit	punon në një zyrë.
Mamaja e Fatmirit	përkëdhelen gjithë ditën.
Shoqet e mamasë	dëgjoen nëpër shkallë.
Macet e Fatmirit	luajnë gjithnjë me macet e tij.
Shokët e Mirit	solli në shtëpi macen e shoqes.



Shkruaji në fletore fjalitë që formove.

3. Zgjero kryefjalën me fjalët plotësuese në kllapa: (e rrugës, i madh leshtor, e vogël e pambrojtur, tyre e përbashkët, e xhaxhi Viktorit, laramane e Kujtimit)

Macja e	quhej Kiti.
Kafshët	janë të rrezikshme.
Macja	kishte frikë.
Një qen	iu sul maces.
Lopa	bëri një viç të bukur.
Bletët	kanë koshere të re.



4. Zgjero me fjalët në kllapa (degën e mollës, miq të mirë, me njëri tjetrin, peshkun e artë, mollën e kuqe)

Djali	<u>pëlqeu</u>
Ai	shkundi
Peshkatori	zuri
Fëmijët	u bënë



5. Shiko figurën.

Krijë katër fjali, që të kenë përveç pjesëve kryesore, edhe pjesë plotësuese. →



Miku i vërtetë

Në zjarr zbukurohet ari,
mik'i mirë është si zjarri,
vërtetë na qorton me gojë,
të prapë kur të na shohë,
po kur të kemi nevojë,
me zemër do na kërkojë
ndë rrezik të na shpëtojë.
Përkundër, një mik i lik
s'tregohet kurrë besnik;
dhe kur sillemi të marrë,
na thot si na vjen mbarë;
dhe në rrezik kur takojmë,
s'na qaset as ta kërkojmë.

Andon Zako Çajupi



UNË + TI = MIQËSI

Fjalorth

i prapë - ai që bën gabime

i lik - i lig; i keq

sillemi të marrë - këtu: sillemi jo mirë

Pyetje rreth tekstit

1. Cilit ia kushton këtë vjershë poeti? Kujt i drejtohet ai?
2. Çfarë cilësish të mikut vë ai në dukje?
3. Ç'ndryshim ka ndërmjet:
mikut të mirë
dhe
mikut të lig?
4. A është shkruar kjo vjershë në formën e këshillës? Ku duket kjo?

Kthehu te teksti

Gjej dhe lexo me zë vargun që tregon:

- se miku i mirë të nderon dhe ty;
- se miku i mirë të qorton përpara syve;
- se miku i keq të bën lëvdada të rreme;
- se miku i mirë të ndihmon kur ke nevojë;
- se miku i lig të lë në baltë.

Detyrë

Përshkruaj mikun tënd. Dallo disa cilësi të tij.

Jemi të ndryshëm



1. Shiko figurat e mësipërme. Shkruaj për secilën prej tyre nga një cilësi. Pastaj krahasoju me shokun e bankës.

2. Ju të gjithë në klasën tuaj jeni të ndryshëm. Secili ka cilësitë e tij të veçanta.

Cili nga shokët ka:

ngjyrën e syve: të kaltër, të gjelbër, të zezë, ngjyrë kafe

ngjyrën e flokëve: të zezë, kafe, të verdhë, të kuqe

formën e flokëve: kaçurrela, të drejta, të shkurtra, të gjata etj.

gjatësinë: 1 e 15 cm, 1 e 20 cm etj.

peshën: 30 kg, 32 kg etj.

Krahaso dy shokë të klasës sate sipas këtij shembulli:

P.sh.: Andi është më i gjatë se Besi. Besi është më i shëndoshë se Andi. Andi i ka sytë të kaltër, Besi i ka bojëkafe. Flokët e Andit janë të verdhë, ndërsa të Besit...

Përdor këto fjalë:

i qeshur, i shkathët, i ngathët,

i inatosur, i trishtuar,

i gëzuar, i mërziur,

gazmor, i urtë etj.




Për shoqen që ndërroi qytet

Gomat e biçikletës kanë rënë përtokë,
qielli është gri dhe plot me re,
çdo gjë që bëj tani më duket kot
që kur ti ike dhe më le.

Lulet nuk mbajnë më erë të mirë
dhe bari më ngjan si kashtë,
qeni i komshiut më duket egërsirë
që kur nuk jemi më bashkë.

Tani asgjë nuk më bën për të qeshur
dhe asnjë lodër s'më tërheq,
gjithë shoqet e tjera i kam braktisur,
prandaj të lutem, kthehu se jam keq!

Sigi Janku



? Pyetje rreth tekstit

1. Çka tregon titulli i vjershës?
 2. Si i duken gjërat vajzës pa shoqen?
A janë ato me të vërtetë ashtu?
 3. Pse vajza është ndarë dhe nga shoqet e tjera?
 4. Çka shpreh vajza me vargun e fundit:
urdhër, **çudi**, **lutje** apo **kënaqësi**?
- ◆ Me ç'shenjë pikësimi mbaron vargu?

! Po ti?

- A të vjen keq për vajzën e vjershës? Pse?
- A mendon se edhe shoqja tjetër që ka ikur është po kaq e mërzitur? Pse mendon kështu?

! Plotëso (me gojë)

- Si do t'i dukeshin gjërat vajzës po të ishte:

pa shoqen



me shoqen





Letra

Kujto rregullën e klubit për miqtë që ndahen.
Shkruaji një letër shoqes të cilën e ke larg.

Ty të ka marrë shumë malli.

Do t'i thuash se e do dhe gjërat
tani të duken ndryshe pa të.

A e di ti se mënyra më e shpejtë për të komunikuar me shoqen ose shokun që ke larg është posta elektronike? Kërkoju ndihmë më të rriturve që të futesh në postën e internetit (e-mail, shqiptohet *i-meil*). Në tastierën e kompjuterit do të shtypësh shkronjat që të duhen për të shkruar letrën.

◆ Provoje dhe ti të shkruash një letër dhe ta dërgosh me e-postë (e-mail).


◆ Cilat janë gjërat e përbashkëta dhe cilat janë ndryshimet ndërmjet të dyja letrave?

E dashur Linda!

Tani që po të shkruaj jam vetëm dhe jashtë bërë shi. Sot kur kalova pranë lodrave, m'u kujtove ti. E mban mend kur luanim gjithë ditën deri sa errësohej dhe roja priste që ne të iknim?

Më mbante mend, sepse më përshëndeti.

Të puth me mall
Elona.



Ekрани i kompjuterit

Tastiera e kompjuterit

Kuzhinieri ynë

Në klubin tonë ka dhe një kuzhinier. Në raste festash ai na përgatit gjëra shumë të mira për të ngrënë. Quhet Beni. Një ditë ai na mësoi si të përgatitnim vetë diçka për të ngrënë.



Keni menduar çfarë mund të bëni ndonjëherë kur ju merr uria dhe jeni vetëm në shtëpi? Mos prisni derisa të vijë mami për t'ju përgatitur diçka për të ngrënë, por lexoni më poshtë. Ne do t'ju mësojmë se si të përgatitni vetë një hamburger apo një sanduiç.



Prisni me kujdes me thikë bukën në dy pjesë. Gjysmën e bukës lyejeni me salcë kosi. Vendosni në bukë proshutën ose qoftën e skuqur (për ata që do të përgatitin hamburgerin). Prisni hollë domaten, kastravecjin dhe këto vendosini në bukë së bashku me djathin e picave. Nëse dëshironi, mund të përdorni edhe patate, por mund ta bëni edhe pa to. Pasi janë skuqur mirë, vendosini dhe ato në bukën tuaj. Në fund lyejeni hamburgerin apo sanduiçin, sipas dëshirës, dhe me salcë ose majonezë.

Tani duhet vetëm që të uleni dhe ta shijoni atë që përgatitët për veten tuaj. Ju bëftë mirë!

N.P.



Ushtrohu

- Mundohu ta përsëritësh pa e parë në libër se si bëhet një hamburger ose një sanduiç.
- Çka kanë të përbashkët hamburgeri me sanduiçin?
- Çka kanë të veçantë?

Detyrë

Ushtrohu në kuzhinën e shtëpisë (ose të shkollës, nëse keni) për të përgatitur hamburgerin ose sanduiçin.

Receta e gatimit

Për të bërë një hamburger apo një sanduiç ju nevojiten:

Bukë në formë të rumbullakët apo në formë të gjatë,
domate, kastravec, salcë kosi, djathë picash, proshutë ose qofte e rumbullakët për hamburgerin, patate, sallatë jeshile, majonezë, salcë.

Mëso

Receta ka dy pjesë:

- Në pjesën e parë shkruhen përbërësit.
- Në pjesën e dytë shkruhet mënyra e gatimit. (Shikoje në tekst.)

◆ Zgjidh dy nga gatimet që ty të pëlqejnë më shumë. Pyet mamin ose babin se si bëhen ato. Pastaj shkruaj dy receta gatimi.

P.sh.: biskota ose kek, supë me perime, sallatë etj.





Në fjalinë e mëposhtme hiq etiketën nr. 4.

Artani dhe Linda

pinë

çdo mëngjes

lëng frutash.

Artani dhe Linda

pinë

çdo mëngjes

..... A ka kuptim kjo fjali? Pse?

Mbaj mend

Grupet e fjalëve të domosdoshme mbajnë kuptimin kryesor të fjalisë.

Grupet e fjalëve jo të domosdoshme plotësojnë kuptimin e fjalisë.

Po të heqim grupet jo të domosdoshme, fjalia nuk priset, por ajo ka më pak të dhëna.



Ushtrohu

1. Hiq fjalët a grupet e fjalëve pa prishur kuptimin e fjalisë:

Mamaja ime

gatuan

shumë shpesh

byrek me qumësht.

2. Lidh me shigjetë fjalët majtas me etiketat e duhura.

Mua dhe vëllait na pëlqen

peshkun e freskët.

Gjyshja ime bëri dje

shumë i shijshëm.

Hamburgeri ishte

keku me mollë.

Babai im pjek në skarë

një tortë të mrekullueshme.

- Hiq fjalët jo të domosdoshme në fjalitë që krijove.

3. Provo të heqësh etiketat e kuqe.

Shëno me kur fjalisë i priset kuptimi dhe me kur fjalia ka kuptim.

Dje pasdite të gjithë shokët u mblodhën me shpejtësi në klubin e miqve.

Dje pasdite të gjithë shokët u mblodhën me shpejtësi në klubin e miqve.

Dje pasdite të gjithë shokët u mblodhën me shpejtësi në klubin e miqve.

Dje pasdite të gjithë shokët u mblodhën me shpejtësi në klubin e miqve.

Dje pasdite të gjithë shokët u mblodhën me shpejtësi në klubin e miqve.

Dje pasdite të gjithë shokët u mblodhën me shpejtësi në klubin e miqve.

4. Hiq sa më shumë etiketa që të jetë e mundur, deri sa të mbetet fjalia më e vogël.

a. Të shtunën shokët e klasës më sollën për ditëlindje një tortë me çokollatë.

b. Në shtëpinë tonë erdhën dje për ditëlindje shumë kushërinj nga jashtë shtetit.

c. Të dielën ata të gjithë u nisën me traget për në Itali.

Lushi shpëtimtari

- Zjarr! Zjarr! Zjarr! - u përhap në klasë thirrja tërë panik e bibliotekares. Në korridor dolën nxënësit dhe mësuesit. Kolliteshin, fërkonin sytë nga tymi e s'dinin ç'të bënin.

- Të hedhim ujë apo..., - tha dikush.

Lushit i shkuan sytë tek aparati për shuarjen e zjarrit, që ishte varur ndërmjet derës së bibliotekës dhe derës së klasës së tij. E rrëmbeu dhe u fut brenda në bibliotekë nëpër tym.

Paspak Lushi doli duke fshirë djersët. Njëra mëngë e bluzës ishte djegur te bërryli.

- Si je?! - e pyetën disa zëra të shqetësuar Lushin.

- E shova, - u përgjigj Lushi sikur s'kishte ndodhur asgjë.

- E shove?! - shprehën habinë shumë zëra përnjëherësh.

- U dëmtuan shumë libra?! -

- Jo, - tha shkurt Lushi dhe vari aparatën në mur.

- Ore, ishte Lushi apo më bënë sytë? - pyeti një mësuese.

- Nuk e njoh

me emër,

- u përgjigj bibliotekarja.

- Nuk më kujtohet të ketë marrë ndonjë libër tek unë.

- Sa çudi! - tha një mësuese tjetër.

Të nesërmen klasë më klasë u lexua një fletë falënderimi për Lushin që kishte shpëtuar bibliotekën. Një nxënës e fotografoi dhe një gazetar shkroi për të një shkrim në gazetë me titull: "Lushi shpëtimtari". Madje dikush iu lut për një intervistë, por Lushi nuk pranoi.

Shoqet dhe shokët e klasës mburreshin me Lushin, por ama edhe donin të ishin në vendin e tij. Të gjithë habiteshin: "Lushi shpëtimtari!? Po ai nuk kishte shkuar asnjëherë në bibliotekë!"

Po më i habituri nga të gjithë ishte vetë Lushi. "Ç'ishte gjithë ajo zhurmë për një grimë zjarr të shuar?! Ja, njëlloj janë këta mësuesit dhe gazetarët. Nuk të ndahen as për të mirë dhe as për të keq."

Arif Demolli





 **Fjalorth**

panik - frikë e madhe

 **Pyetje rreth tekstit**

1. Çka ndodhi brenda në bibliotekë?
2. Cilat janë veprimet që bëri Lushi?
3. Çka ndodhi të nesërmen nëpër klasa?
4. A i bëri përshtypje Lushit që po bëhej i famshëm? Pse?
5. Pse të gjithë u habitën me Lushin?
6. Pse Lushi thotë: Nuk të ndahen as për keq, as për mirë.



 **Kthehu te teksti**

Shëno me dhe fjalitë e mëposhtme:

- Aparati i shuarjes së zjarrit ishte prapa derës.
- Mënga e bluzës ishte djegur.
- Në bibliotekë u dogjën shumë libra.
- Lushit i dhanë një medalje.
- Shokët u mburrën me veprimin e Lushit.
- Lushi i dha një intervistë gazetares.

Bëni portretin e Lushit

Shkruaj **të kundërtat** e fjalëve të mëposhtme:

frikacak
 i ngathët
 i rregullt (si lexues)
 mendjemadh

◆ Shto dhe cilësi të tjera.

 **Detyrë**

Shkruaj katër pyetje për intervistën që do t'i marrësh Lushit.



Biblioteka

a.

- A ke qenë ndonjëherë në bibliotekë?
- Cilët janë librat që ke kërkuar?
- Çfarë ke plotësuar kur ke marrë librin?
- A e ke vënë firmën tënde në kartelë, kur e ke marrë librin?
- A e ke lexuar atë në kohën e duhur?



- ◆ Thuaj disa tituj librash që ke në shtëpi ose në bibliotekën e shkollës.
Vendosi sipas alfabetit.
- ◆ Për çka flasin ata? Cili të pëlqen më shumë? Pse?

b.

Librat në bibliotekë ndahen sipas llojeve:

Libra me vjersha (*Mjaltë nga poezia botërore etj.*)

Libra me përralla (*Përralla të zgjedhura shqiptare etj.*)

Libra me tregime (*Unë dhe qeni im Foksi etj.*)

Romane për fëmijë (*Liza në botën e çudirave etj.*)

Libra enciklopedikë (*Enciklopedia për fëmijë etj.*)

Libra në gjuhë të huaj (*What Do I See? etj.*)

- Shikoj fëmijët në figurë. Çka po bëjnë ata?

◆ Ku ndryshojnë këta libra nga njëri-tjetri?

Cilat lloje të pëlqejnë ty më shumë?
Pse?

- A të ka ndodhur ta dëmtosh librin?
- Çka ke bërë më pas?





Lëvizim fjalët ose grupet e fjalëve në fjali

Kujtojmë

Ne mund të lëvizim fjalët ose grupet e fjalëve në fjali pa ia prishur asaj kuptimin.

1 2 3 4
Ermira **shkon** **çdo të shtunë** **në bibliotekë.**

Lëvizim etiketat në pozicione të ndryshme:

1 3 2 4
Ermira **çdo të shtunë** **shkon** **në bibliotekë.**

1 4 2 3
Ermira **në bibliotekë** **shkon** **çdo të shtunë.**

3 2 1 4
Çdo të shtunë **shkon** **Ermira** **në bibliotekë.**

4 1 2 3
Në bibliotekë **Ermira** **shkon** **çdo të shtunë.**



- Lëvizi dhe ti etiketat në pozicione të tjera. A ndryshon kuptimi i fjalisë?

Pra, ka fjalë e grupe fjalësh, të cilat, po t'ua ndryshosh vendin, **nuk ia prishin kuptimin fjalisë**. Këto quhen grupe fjalësh **të lëvizshme**.

Le të ndryshojmë vendin e etiketave nr.1 dhe nr. 3 në fjalinë e mëposhtme:

Fëmijët e lagjes **i ndihmojnë** **të rriturit** **për të pastruar mjedisin.**

Të rriturit **i ndihmojnë** **fëmijët e lagjes** **për të pastruar mjedisin.**

Në rastin e dytë ndryshon kuptimi i fjalisë.

(Janë fëmijët që i ndihmojnë të rriturit për pastrimin e mjedisit). Emri **të rriturit** duhet të vendoset patjetër **pas foljes**.

Pra, ka fjalë e grupe fjalësh, të cilat po t'ua ndryshosh vendin, **ia prishin kuptimin fjalisë**. Këto quhen grupe fjalësh **të qëndrueshme**.

Ushtrohu

1. Në fjalinë e mëposhtme kanë lëvizur etiketat.

Shëno me kur fjalisë i prishet kuptimi dhe me kur fjalisë nuk i prishet kuptimi.

Punonjëset e bibliotekës **i mësojnë** **nxënësit** **të gjejnë** **librat nëpër raftet.**

Të gjejnë **punonjëset e bibliotekës** **nxënësit** **i mësojnë** **librat nëpër raftet.**



NJOHIM GJUHËN TONË

Për të gjetur librat nëpër raftet punonjëset e bibliotekës i mësojnë nxënësit.

Nxënësit i mësojnë punonjëset e bibliotekës për të gjetur librat nëpër raftet.

I mësojnë punonjëset e bibliotekës nxënësit për të gjetur librat nëpër raftet.

2. Lëvize disa herë etiketën në vende të ndryshme, pa ua prishur kuptimin fjalive.

Lushi pa në qoshen e korridorit fikësen për shuarjen e zjarrit.

Menjëherë Lushi rrëmbeu në dorë fikësen e zjarrit.

Atë ditë Lushi guximtar shoi zjarrin në bibliotekën e shkollës.

3. Shkruaji fjalitë në fletore duke lëvizur etiketat e fjalisë, sipas skemave përbri:

1	2	3	4	5	
Pas mësimit	Lushi	mori	lavdërimet	nga të gjithë.	(1+2+3+4+5)

P.sh.: Nga të gjithë pas mësimit Lushi mori lavdërimet. (5+2+1+3+4)

..... (4+1+2+3+5)

..... (1+3+4+2+5)

..... (1+3+2+4+5)

..... (2+4+3+1+5)

- A iu prish në ndonjë rast kuptimi fjalisë?

4. Lëviz etiketat në fjalinë e mëposhtme. Jep dy raste kur fjalisë i prishet kuptimi dhe dy raste kur fjalia e ruan kuptimin.

Të hënën të gjithë mësuesit njoftuan nxënësit e shkollës për veprimin e Lushit.

5. Formo tri fjali duke lidhur etiketat me njëra-tjetrën:


një herë në muaj shumë biblioteka e shkollës në katin e parë

atje ndodhet takime me shkrimtarë ka

në bibliotekë libra të bukur zhvillohen

Hajdi dhe Klara

Hajdi është një vajzë e rritur në ajrin e pastër të Alpeve të Zvicrës. Ajo lidhi miqësi të ngushtë me Klarën, vajzën nga qyteti, e cila i kishte këmbët të paralizuara. Vajtja e Klarës në kasollen ku banonte Hajdi, ndryshoi fatin e Klarës.



Hajdi shihte herë pas here mos po vinin vizitorët. Më në fund vargu

i vogël iu shfaq para syve. Në ballë qëndronte një udhërrëfyes që drejtonte kalin e gjyshes, dhe pas tij ishte një burrë që mbante në kurriz një kosh. Kur pa dy vajzat të ulura mbi gur, gjyshja thirri e shqetësuar:

- Klara, ku e ke karrigen me rrota? Ç'është e gjithë kjo?

Atëherë Hajdi u ngrit më këmbë, po kështu bëri edhe Klara. Të dyja vajzat lëvizën ngadalë drejt gjyshes. Klara ecte duke u mbajtur vetëm me njëren dorë pas supit të Hajdit. Gjyshja shihte e befasuar. Ato vazhdonin të ecnin drejt saj dhe fytyrat e tyre të trëndafilta po ndriçonin nga lumturia. Duke qeshur e duke qarë njëkohësisht, gjyshja e përqafoi Klarën, pastaj Hajdin. Nuk mund të gjente fjalë për t'i shprehur ndjenjat e veta. Më pas pa xha Alpin, i cili kishte dalë jashtë dhe po vështronte me një buzëqeshje lumturie. Ajo e përqafoi Klarën dhe shkuan tok drejt plakut. Gjyshja ishte shumë e mallëngjyer që shihte, më në fund, mbesën tek ecte përkrah saj.

- Dukesh e mahnitshme, e dashura ime. Mezi të njoh.

Ajo i kapi dorën xha Alpit dhe tha:

- Nuk di si të të falënderojmë! Këtë që po shoh, e ke arritur ti me kujdesin tënd të veçantë.

- Dhe dashuria, dielli, natyra, - shtoi ai.

- Dhe mos harro qumështin e mrekullueshëm të dhive, - vazhdoi Klara.

- Faqet e tua në ngjyrë trëndafili e tregojnë këtë, - u përgjigj gjyshja.

- Nuk më besohet. Kjo që po shoh është një mrekulli. Tani dhe mikeshat jote Hajdi do të jetë pjesëtare e familjes sonë. Që tani kam menduar të heq mënjanë disa kursime për shkollimin e mëtejshëm të Hajdit....Nuk e dija se në këtë botë kishte njerëz kaq të mirë.

Pastaj të gjithë qëndruan në kasolle duke ndarë çaste të veçanta miqësie e lumturie.

Johana Spirit

Fjalorth

e befasuar - e çuditur, e habitur

e mallëngjyer - që i vjen për të qarë nga gëzimi

e mahnitshme - që të habit

Pyetje rreth tekstit

1. Pse Hajdi dhe Klara prisnin me sytë nga rruga?
2. Pse u habit atë shumë gjyshja kur pa Klarën?
3. Kë falënderoi të parin gjyshja? Pse?
4. Si arriti Klara të ngrihej në këmbë?
5. Në cilat fjalë të gjyshes duket mirënjohja për Hajdin?

Po ti?

- A e ke parë filmin "Hajdi"? Fol për të.

- Çka të ka mbetur më shumë në mendje?

- A e vlerëson miqësinë ndërmjet dy shoqeve? Pse?

Kthehu te teksti

Shëno me dhe fjalitë e mëposhtme:

- Klara po e priste gjyshen ulur në karrigen me rrota.
- Gjyshja u mallëngjye shumë kur pa mbesën.
- Gjyshja përqafoi të dytin xha Alpin.
- Faqet e kuqe të Klarës tregonin se ajo nuk ishte mirë.
- Gjyshja nuk u çudit me mirësinë e familjes së xha Alpit.
- Xha Alpi nuk e pranoi se vetëm ai e kishte shëruar Klarën.

Lidh me shigjetë

a. Çfarë cilësish të veçanta dhe të njëjta kanë dy vajzat?

Hajdi - vajza nga Alpet Klara – vajza nga qyteti	e shëndetshme e dobët (nga shëndeti) delikate e fortë e guximshme e besës e dashur e ndrojtur	Klarën e shpëtoi:	natyra e alpeve mjedisi i qytetit ajri pastër mosbesimi miqësia frika besimi guximi
---	--	-------------------	--



Ata janë si ne

a.

Disa fëmijë, për fat të keq, kanë të meta fizike. Ata ose kanë lindur të tillë, ose u ka ndodhur ndonjë aksident. Këta fëmijë quhen ndryshe *me aftësi të kufizuara*.

- Si mendon ti, a janë fëmijët me aftësi të kufizuara njëloj si të gjithë? A kanë dhe ata dëshira dhe ëndrra të njëjta me të gjithë?

- Shiko ilustrimin.

- Çka sheh aty? Në cilin aktivitet sportiv do të marrë pjesë ai?

- A është i mirë sporti për shëndetin e tij? Pse?

b.

Në klubin e miqve është një rregull për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kujtohu dhe thuaje atë.

- Si mendon ti, fëmijët me aftësi të kufizuara ndihen më mirë vetëm kur rrinë me njëri-tjetrin?

- Çka mund të bëjmë ne të tjerët për ta?

- A do të ishte i lumtur një fëmijë i tillë, nëse ne do të rrinim me të dhe do ta quanim shok të vërtetë?

- Kujto tregimin e dy shoqeve që komunikojnë me njëra-tjetrën me shenja. Ç'tregon ai?



Bredhi i parë i Vitit të Ri

Një herë një rojtar pylli jetonte në një



të vogël afër pyllit

me



djemtë e tij. Ditën e fundit të vitit, megjë nuk kishte

që t'u bënte



, çoi në shtëpi një



. Por bredhi



dukej shumë i zhveshur. Kështu, rojtari doli të kërkonte ndonjë gjë për ta

zbukuruar. Rrugës takoi një



me një



plot me dru.

E ndihmoi ta mbante dhe ndërkaq i rrëfeu hallin e tij. Plaku i dha një



me një



dhe e ftoi të bënte fluska me





që




ajo kishte brenda dhe ta vinte te



. Më tej takoi një plakë me






një . E ndihmoi dhe atë dhe ajo i dhuroi një  të gjatë nga

një  që kishte me vete. Në fund fare takoi një plak që kishte ftohtë dhe i dhuroi  e tij. Plaku i dhuroi një copë  dhe i tha ta

vinte në majë të bredhit.


Rojtari i pyllit bëri ashtu siç i thanë  dhe . Nuk

dukej shumë i bindur, por... një mrekulli! Sapo vendosi mbi bredh

, ato u bënë , fija u bë  prej argjendi dhe

copa e drurit u bë një  gjithë shkëlqim.

Kështu lindi **Bredhi i parë i Vitit të Ri!!**

 **Detyrë**

- ◆ Lexoje tregimin rrjedhshëm.
- ◆ Shkruaj në fletore të gjitha fjalët që janë dhënë me figura.



Kartolina

- ◆ Shiko me kujdes kartolinat e mëposhtme. Cilën do të zgjidhje për:
 - shoqen ose shokun tënd,
 - mësuesen,
 - kushëririn që jeton jashtë shtetit.
- Trego përse bëre ato zgjedhje?



- ◆ Plotëso modelet e tri kartolinave në fletoren e punës.
- ◆ Përshkruaj çfarë bëre natën e Vitit të Ri në një fletë ditari.
- Respekto rregullat që ke mësuar vitin e kaluar për shkrimin e kartolinës dhe të ditarit.

Thonjëzat

Vihen në thonjëza: emrat e përveçëm të rrugëve, të shkollave, titujt e gazetave, të revistave etj.

1. Lidh me shigjetë:

titull reviste	Unë mësoj në shkollën "Kongresi i Manastirit".
emër rruge	Familja ime banon në rrugën "Gjergj Kastrioti".
titull libri	Libri "Pipi Çorapegjata" më pëlqeu shumë.
emër shkolle	Në revistën "Alba" botova një vjershë.

2. Vendos thonjëzat aty ku duhen.

Në qytetin tim është monumenti Luftëtari i Lirisë. Përballë tij ndodhet kinema Agimi. Në fund të rrugës Ismail Qemali është shkolla Naim Frashëri.

Rubrika III



Unë mësoj

*nga
natyra*



Gjithçka ndryshon




VAJZA E PARË: Nganjëherë ndriçon dielli,
nganjëherë bie shi.
DJALI I PARË: Nganjëherë bie borë,
nganjëherë fryn stuhi.
**TË GJITHË: Moti ndryshon,
kur koha kalon.**

VAJZA E DYTË: Macet ishin kotele,
qentë kone ishin.
DJALI I DYTË: Fluturat ishin larva,
zogj të vegjël pulat ishin.
**TË GJITHË: Kafshët ndryshojnë
kur koha kalon.**

VAJZA E TRETË: Veçanërisht njerëzit!
DJALI I TRETË: Edhe pse mund të jenë të varfër
ose dhe shumë të pasur.
VAJZA E KATËRT: Edhe pse mund të jenë të mërzi-
tur

ose dhe shumë të qeshur,
të gjatë, të hollë, të shkurtër,
të shëndoshë apo të dobët...
**TË GJITHË: Njerëzit ndryshojnë
kur koha kalon.**

VAJZA E PESTË: Ata që janë të mërziur,
mund të bëhen të lumtur.





DJALI I PESTË: Ata që janë të ngathët,
mund të bëhen të shkathët.

VAJZA E GJASHTË: Ata që janë të varfër,
mund të bëhen të pasur.

DJALI I GJASHTË: Një njeri i panjohur
deri dje,
mund të bëhet për ty
një mik i vërtetë.

VAJZA E SHTATË: Ashtu si ylberi
pas furtune,
Mund të vijë pas lotëve
te ju GËZIMI
dhe LUMTURIA.

DJALI I TETË:
TË GJITHË: Çdo gjë ndryshon
kur koha kalon.



R. P.

Pyetje rreth tekstit

1. Si ndryshon **moti**, kur kalon koha?
2. Si ndryshojnë **kafshët**, kur kalon koha?
3. Si ndryshojnë **njerëzit**, kur kalon koha?
4. A ndalon ndonjëherë koha?
Po ora që kemi në shtëpi a ndalon? Pse?



Kthehu te teksti

- ◆ Gjej në tekst sa herë janë përdorur këto fjalë:
ndryshon____, nganjëherë____, mund _____.
- ◆ Gjej në tekst dhe lexo fjalët që i thonë të gjithë.
- ◆ Gjej në tekst dhe lexo fjalët që i thonë vajzat (I, II, III).
- ◆ Gjej dhe lexo në tekst djalin që thotë vetëm dy fjalë.



Plotëso me mbiemra të kundërt.

- Ai që është **i mërziur** mund të bëhet.....
- Ai që është **i varfër** mund të bëhet.....
- Ai që është **i ngathët** mund të bëhet
- Ai që është **i shkurtër** mund të bëhet.....
- Ai që është **i panjohur** mund të bëhet.....

Detyrë

- ◆ Lexojeni bukur pjesën në role.
Duhet të jeni të vëmendshëm që të ndiqni fjalët e shokut para jush.
Kur të vijë pjesa që flisni të gjithë, duhet t'i thoni fjalët në të njëjtën kohë.



Si ke ndryshuar ti?

Shiko në fotografi si ka ndryshuar moshatari yt.



1. Zgjidh edhe ti katër fotografi dhe fol për ndryshimet.

1

- Si i ke pasur flokët dhe si i ke tani?
- Sa i gjatë ke qenë dhe sa je tani?
- Sa kg ke qenë dhe sa je tani?

2

- Ke qarë, ke qeshur apo dukesh serioz?
- Dukesh i mërzitur apo i gëzuar?
- Je veshur hollë apo trashë?

2. Krahasoje veten tënde me një vit më parë.

3

- Kur ke qenë më mirë me mësimet?
- Çfarë lodrash ke pasur?
- A ke zënë shokë të rinj?

3.Fol për ndryshimet që kanë ndodhur këtë vit në klasën tënde.

4.Fol për ndryshimet e motit gjatë javës që kaloi.



Folja në kohën e tashme, të shkuar, të ardhme



Dje **ishte** ftohtë.

Sot koha **është** e bukur.

Nesër **do të jetë** kohë me shi.

Unë **bëra** një plak prej dëbore.

Unë **bëj** një shëtitje në park.

Unë **do të bëj** një pikturë.

Koha e shkuar

Koha e tashme

Koha e ardhme

Folja **në kohën e shkuar** tregon një veprim që e kemi bërë **më parë**.

Folja **në kohën e tashme** tregon një veprim që e kryejmë **tani**.

Folja **në kohën e ardhme** tregon një veprim që do ta bëjmë **më vonë**.

Ushtrohu

1. Lidh kohën e foljes me foljen.

e tashme

Retë **lëvizin** në qiell.

Bie shi me bubullima.

e shkuar

Ne **nuk do të bëjmë** dot stërvitje nesër.

Dje koha **ishte** shumë e bukur.

e ardhme

Ne **bëmë** stërvitje në fushën e shkollës.

Nesër përsëri **do të bjerë** shi.

2. Gjej foljet dhe shkruaj në kuti kohën e tyre: **T** (e tashme), **Sh** (e shkuar), **A** (e ardhme).

Unë po lexoj një përrallë shumë interesante. Ajo tregon për Tokën, Qiellin dhe Detin. Këta janë personazhet e përrallës. Përralla tregon edhe për Titanët. Ata ishin fëmijët e Tokës dhe të Qiellit.

Titanët kishin një sy. Qielli i burgosi të gjithë djemtë. Toka i tha djalit të madh:

- Unë do të ndahem nga Qielli. Ti do të bëhesh kryetari i familjes. Ti do të udhëheqësh.

3. Zgjidh një folje dhe krijo 3 fjali (në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme).


VJESHTA

Kur vjeshtës vendin i lë vera
dhe zogjtë shtegtojnë larg e larg,
nga pemët gjethet rrëzon era
si fjongo të arta përmbi park.

Kur vjeshta vjen, zverdhon në vreshta
bistaku i rrushit bukuri!
Me begatinë që sjell vjeshta,
gëzohem unë, gëzohesh ti.

O vjeshtë e artë, o stinë e zjarrtë,
ti, mrekulli e punës sonë,
nga fryti yt i begatë
njeriut faqet i kuqojnë!

Xhevahir Spahiu



Pyetje rreth tekstit

1. Çka ndodh kur vjen stina e vjeshtës?

Zogjtë shtegtojnë

.....
.....
.....

2. Pse vjeshta quhet *stinë e begatë*?

3. Cilat vargje tregojnë se njeriu është i lidhur me natyrën?

Çfarë i japin ata njëri-tjetrit?

4. Çka ndier poeti, kur e ka shkruar këtë vjershë:

mall	brenjë
gëzim	keqardhje
dashuri	inat?

Fjalorth

fjongo – shirit, zakonisht prej mëndafshi, me të cilin vajzat lidhin flokët.

bistak - veshi i rrushit

begati - pasuri

• Të ç'lloji janë emrat e mësipërm, me të cilët ne tregojmë ndjenjat e poetit?




Poezia dhe proza

Poezia (vjersha) është një tekst i shkruar në **vargje**, që shpreh **ndjenja, emocione, gjendje shpirtërore** dhe **mendime** të poetit. Poezia ka një gjuhë të veçantë nga proza.

Dallimet

Poezia shkruhet në **vargje**.

Në prozë **fjalja nuk fillon me rend të ri**, por vazhdon aty ku përfundon fjalia e mëparshme.



- Ja si do të ngjante kjo poezi në prozë.

Paragrafi 1

Vera iku dhe tani është vjeshtë. Zogjtë shtegtojnë për në vendet e nxehta. Era i rrëzon gjethet nga pemët. Ato ngjajnë si fjongo të arta.

Paragrafi 2

Vjeshta është një stinë e begatë. Ne i mbushim shportat plot me fruta: mollë, dardha, rrush. Fytyrat e fëmijëve kuqëlojnë nga shëndeti.



Kthehu te teksti

- Kthehu dhe një herë te poezia *Vjeshta*. Cilat janë strofat, vargjet, rimat e saj?
- Analizo poezinë *Në mes të shtatorit*, me të cilën hapet teksti.

Letër në dimër

E dashur nënë Hatibel!

Si je me shëndet? Unë nuk jam shumë mirë, sepse më ka zënë gripi. U mërzita gjithë ditën në shtrat pa luajtur e pa bërë diçka. Dita më duket shumë e mërzitshme. Më e keqja është se duhet të pi dhe ilaçet. Nuk më pëlqejnë fare! Doktorit thotë se ato bëjnë mirë për shëndetin tim dhe do të më shërojnë shpejt.

Tani që po të shkruaj, jashtë bie borë. Këtu është shumë ftohtë. Të gjithë shokët e mi po luajnë në oborr, ndërsa unë i shoh nga dritarja. Beni dhe Mira po bëjnë një njeri prej bore. Ai po del shumë i lezetshëm.

Ah, sikur të ishe këtu, moj nënë, nuk do të mërzitesha fare, se do të më tregoje përralla. Në ditët e ftohta më pëlqen shumë të dëgjoj përrallat e tua. Të kujtohet kur më mbaje në prehër? Unë atëherë isha shumë i vogël.

Tani po e mbyll letrën. A do të më shkruash dhe ti? Mezi pres të fillojnë pushimet e dimrit dhe të vij te ti.

Ju puth fort ty dhe gjyshin,
nipi juaj Sokoli.

Pyetje rreth tekstit

1. Kujt po i shkruan Sokoli? Ku po shkruan: në tryezë, në shtrat, në bankë.
2. Pse Sokolit i duket dita e gjatë dhe e mërzitshme?
3. A i pi barnat Sokoli, ndonëse nuk i pëlqen? Pse?
4. Çka po bëjnë shokët e Sokolit?
5. Për çka e ka marrë malli Sokolin?

Kthehu te teksti

- Gjej dhe lexo si e fillon letrën Sokoli.
- Gjej dhe lexo si e mbaron letrën Sokoli.
- Gjej dhe lexo fjalinë që tregon se Sokolit nuk i pëlqen të rrijë brenda.
- Gjej dhe lexo fjalinë që tregon se e ka marrë malli për kohën e shkuar.
- Gjej dhe lexo fjalinë që tregon se e ka marrë malli për gjyshen.

Çka nuk të pëlqen kur je i sëmurë:

nuk shkon në shkollë

nuk del.....

.....
..... ?

Çka të pëlqen kur je sëmurë:

nuk lodhesh duke mësuar

asnjë nuk të shan.....

.....
..... ?



Përemri vetor dhe folja

Ata **luajnë** me borë.
Unë **vështroj** nga dritarja.



Unë, ti, ai/ajo, ne ju ata/ato janë **përemra vectorë**.

Shiko ndryshimet që pëson folja **vështroj**. Ky ndryshim quhet **zgjedhim**.

Unë	vështro j	ti luan.	
Ti	vështro n	ne	◀ Shkruaje
Ai/ajo	vështro n	ju	foljen <i>luaj</i> , si
Ne	vështroj më	ajo	duhet.
Ju	vështro ni	ata	
Ata/ato	vështroj jnë	unë	

Ushtrohu

1. Nënvizohet foljet në kohën e tashme.

Shokët e mi luajnë jashtë. Unë qëndroja në shtrat dhe pija ilaçe. Në oborr Beni me Mirën po bëjnë një njeri prej bore. Beni bën trupin. Mira e zbukuron. Të dy nxitojnë. Ata po e mbarojnë shumë shpejt. Unë i shihja me zili.

2. Përgjigju pyetjes dhe nënvizohet foljen.

- Çka bën ti në oborr?
- A e këndoj dot unë këtë këngë?
- Çka bën Shpendi në bibliotekë?
- Çka bëjnë zogjtë mbi degë?
- Tani po shkoni në shkollë?
- Çka bëjnë fëmijët në oborr?

Unë luaj me topa bore.

.....

.....

.....

.....

.....

3. Lidh me shigjetë përemrin me foljen.

Unë	lexoj më dhe shkruaj më .
Ti	lexoni dhe shkruani.
Ai (ajo)	lexoj në dhe shkruaj në .
Ne	lexoj dhe shkruaj.
Ju	lexon dhe shkruan.
Ata (ato)	lexon dhe shkruan.

4. Shkruaj një tekst me folje në kohën e tashme që të tregojnë se ç'bën ti dhe familjarët e tu gjatë një dite.

(Përdor këto folje: *shkoj, nxitoj, mësoj, punoj, vizatoj, luaj, shikoj* etj.)

P.sh.: Unë shkoj në shkollë, ndërsa prindërit shkojnë në punë.

Kur bie shi

Retë shkojnë palë-palë,
kur bie shi.
Lumi rritet valë-valë,
kur bie shi.

Flladi këndshëm e njom arën,
kur bie shi.
Bujku gëzueshëm e hedh farën,
kur bie shi.

Lulja e bukur çel te lumi,
kur bie shi.
Një djalë f' vocërr e zë gjumi,
kur bie shi.

Mehmedali Hoxha



Fjalorth


fllad - erë e lehtë

këndshëm - që të kënaq kur e sheh ose e nuhat

i vocërr - i vogël

Pyetje rreth tekstit

1. Si duket qielli kur bie shi?
2. Çka ndodh me lumin kur bie shi?
3. A gëzohet bujku kur bie shi? Pse?
4. Çka i ndodh lulës kur bie shi?
5. Çka bën djali i vogël kur bie shi?
6. Në cilën stinë bie më tepër shi? Pse është i nevojshem sniu?



Kthehu te teksti

- Gjej sa herë përsëritet vargu Kur bie shi _____.
- Gjej dhe lexo *fjalët e shkruara me vizë në mes*.
- Gjej dhe lexo fjalët që zëvendësojnë foljen fle.
- Gjej dhe lexo fjalët që zëvendëson foljen lag.

Detyrë

Mësoje vjershën përmendsh dhe recitoje bukur.

Po ti?

Cilat ditë të pëlqejnë më shumë:
me diell,
me shi,
me dëborë?

Përkruaje ditën që të pëlqen më shumë.



Folja *jam* dhe *kam* në kohën e tashme dhe të ardhme



Tani unë **jam** një bebe e vogël dhe **kam** një qen të vogël.

Pas disa vjetësh **do të jem** një djalë i rritur dhe **do të kem** një qen të madh.

Zgjedhimi i foljes *jam* dhe *kam* në kohën e tashme dhe të ardhme. →



Ushtrahu

koha e tashme			koha e ardhme	
unë	jam	kam	do të jem	do të kem
ti	je	ke	do të jesh	do të kesh
ai/ajo	është	ka	do të jetë	do të ketë
ne	jemi	kemi	do të jemi	do të kemi
ju	jeni	keni	do të jeni	do të keni
ata/ato	janë	kanë	do të jenë	do të kenë

1. Vendos foljet *jam* dhe *kam* në kohën e duhur.

Ne (kam) një shtëpi në fshat. Në oborrin e shtëpisë (jam) disa koshere bletësh. Kosherja e parë (jam) më e madhe. Gjyshi më thotë: “Ti, Alba, (kam) kosheren e madhe, këtë më të voglën e (kam) Albani”. Në kopsht (kam) edhe shumë pemë. Tani në pranverë pemët (jam) me lule, kurse në verë (jam) me fruta.

2. Nënvizo foljen që duhet dhe shkruaj fjalitë në fletore.

Në shkollën tonë (kam, kemi, do të kesh) një kënd të ri sportiv.

Ne (do të kemi, kanë, do të kenë) një trajner të ri.

Ai (jemi, është, do të jem) mësuesi ynë i fizikulturës.

3. Vendos në vendet e zbrazëta foljen *jam* dhe *kam* në kohën e duhur.

Shtëpia ime një oborr, ku një pishinë e vogël dhe një kopsht me lule. Unë i shumë qejf kafshët. Në një qoshe të kopshtit një kotec për pulat. Afër saj edhe kolibja e qenit, sepse pas dy ditësh unë një qen të sapolindur. Ai miku im besnik. **Së shpejti** unë edhe dy kanarina. Ato një kafaz të bukur.

Peizazhi i pyllit të zgjuar

U zgjuan të gjitha
ç'ka e ç'mban pylli.
U zgjuan qukapikët
dhe nisën të bëjnë
injeksione në pemët.
U zgjuan bletët
dhe dolën nga shtëpitë
e tyre prej dylli.
U zgjuan milingonat
dhe ngritën antenat përpjetë,
Dhe lajmet e para të agimit
i dhanë në bar e në fletë.

Dritëro Agolli



Fjalorth ç'ka e ç'mban pylli - të gjitha gjërat që gjenden në pyll.

bëj injeksion - bëj gjilpërën, këtu, qukapiku shpon pemën duke hequr krimbat.



Pyetje rreth tekstit

1. Për cilën stinë shkruan poeti? Nga e kuptuat këtë?
2. Cilët u zgjuan të parët në pyll?
3. Çfarë bënë ata sipas poetit?
4. Numëro dhe kafshë të tjera që zgjohen në pranverë.



Kthehu te teksti

- Gjej sa herë përmendet vargu *U zgjuan...* _____
- Gjej vargun që tregon se qukapiku i shëron pemët.
- Gjej vargun që tregon se milingona ka dy fije të holla në kokë.

Mëso më shumë

Kur vjen pranvera, thuhet se bëhen "pastrimet e pranverës", d.m.th. kafshët zgjohen nga gjumi i dimrit dhe bëjnë një "ripastrim pranveror". Po kështu edhe natyra rilulëzohet...



Detyrë

- Shkruaj se çka bën ti kur vjen pranvera.



ZGJIMI I ARIUT

Një çudi e padëgjuar ndodhi këto ditë në pyll. Një ariu i doli gjumi i dimrit para se të vinte pranvera! Ariu u afrua buzë shpellës dhe shikoi një copë herë jashtë. Atje ishte ende freskët. Disa gëmusha ruanin ndonjë grusht bore, që kishte mbetur pa shkrirë.

Para shpellës fluturoi papritmas një harabel. Ariu, porsa e pa, e thirri:

- Harabel, ndalu! Dua të të pyes për diçka. Nuk e di se si më doli gjumi pa ardhur pranvera e vërtetë. Të lutem, më thuaj a është shkrirë akulli në përrua? A mund të zë të paktën ndonjë peshk?

- Nuk është shkrirë i tërë akulli, por ti mund ta thyesh me turi. Turiri yt është i fortë, - cimdmoi harabeli me gëzim.



- O, jo, jo..., - turfulloi ariu i penduar, - më mpihen dhëmbët edhe nga akulli më i hollë. Më mirë të mos zbres në përrua... Po, harabel i dashur, shiko pak më larg, andej nga lisi njëqindvjeçar... Në trungun e tij banojnë me mijëra bletë. A thua, e kanë hapur deriçkën e tyre? A mund ta ngjyey shputën në mjaltë?

Harabeli fluturoi lart, u soll pak dhe u kthye mbi gëmushë.

- Jo, o ari. As bletët nuk e paskan hapur ende deriçkën, por s'ka gjë. Turiri yt mund të thyejë shumë gjëra... Eh, ta kisha unë sqepin tim të vogël si turirin tënd!...

- tha harabeli me lakmi.

- Uh, uh!... - turfulloi përsëri ariu. - Po në qoftë se më sulmojnë bletët? Ç'të bëj atëherë në këtë të ftohtë?! Jo, o harabel, jo, nuk guxoj të shes trimëri, ashtu si thua ti. Por, të lutem, shiko andej nga fusha. A mos ka lulëzuar qershia?

- Unë prej andej vij, o ari, - i tha harabeli. - Nuk gjeta asgjë për vete. Prandaj erdha këndeje të kërkoj diçka. Eja me mua, nuk do të vdesësh nga uria. Rrallëherë gjej ndonjë ushqim, por më pëlqen kjo natyrë. Është shumë e bukur dhe e dashur...

- He, he, he! ... murmuriti përsëri ariu dhe shtoi: - Mua nuk më pëlqen natyra. Më pëlqen vetëm të ha e të fle dhe asgjë tjetër. Do të provoj të fle edhe ndonjë ditë, ndoshta më merr gjumi përsëri në shpellën time të ngrohtë.

- Hyr, o përtac! - i tha harabeli dhe fluturoi shpejt për të shikuar çdo gëmushë e çdo lis që bëhej gati të zgjohej bashkë me pranverën...

Qamil Batalli



Fjalorth

- gëmushë* - shkurre me degë të dendura, kaçubë
- turfulloi* - shfryu me forcë ajrin nga hundët
- shputë* – faqja e poshtme e këmbës së njeriut ose e disa kafshëve.
- me lakmi* - me zili
- murmuris* – nxjerr një murmurimë (zhurmë e lehtë që mezi dëgjohet).



Pyetje rreth tekstit

1. Çfarë ishte ajo gjë e çuditshme që ndodhi ende pa ardhur pranvera?
2. Për çka e pyeti ariu harabelin:
 - Pyetja e parë*?
 - Pyetja e dytë*?
 - Pyetja e tretë*?
3. Pse në të tria rastet harabeli i ktheu ariut përgjigje negative?
4. Pse ariu u kthye përsëri në strofkën e vet?
5. Po harabeli ç'bëri? A e shau ai natyrën? Pse?



Plotëso

- Gëzofi i ariut është më i se
- Turiri i ariut është më i se
- Ariu kishte frikë se dhëmbët.
- Ariu kishte frikë se mos e bletët.
- Ariu përtonte ushqim.
- Harabeli nuk përtonte
- Harabelit i natyra.

Lidh me shigjetë

- | | |
|----------|-----------|
| Pranvera | shkrin |
| Harabeli | piqet |
| Ariu | sulmojnë |
| Akulli | lulëzon |
| Bletët | turfullon |
| Qershia | cimcimcon |





Përshkruajmë pranverën

- Shiko figurat e mëposhtme dhe bëj një përshkrim të pranverës. Kthehu dhe një herë te faqet ku gjendet *thesi i fjalëve*.

Përshkruaj:

Ngjyrat e pranverës:



e kuqe, e gjelbër,

.....
.....
.....


Aromat e pranverës:



e ëmbël, delikate, dehëse

.....
.....
.....

Tingujt e pranverës:



ciu-ciu, quk-quk, kuak-kuak

.....
.....
.....

Ndjesitë e tua:



hare, gjallëri.....

.....
.....
.....

Në Bregun e Pulëbardhave



Një ditë vere, tre shokët, Beni, Miri dhe Edi u zgjuan herët dhe u nisën drejt plazhit. Dëshira e tyre ishte të bëheshin peshkatarë të dëgjuar.

- Shkojmë në limanin e vogël, - propozoi Beni.

- Mirë, - pranoi Miri. - Aty ka kohë që s'kemi qenë, sigurisht do të ketë mjaft ...

Të tre pranuan dhe vazhduan drejt limanit të bukur.

Secili i kishte marrë pajimet për peshkim: pendët e notimit, maskat për të parë nën ujë, fyzën e frymëmarrjes nën ujë dhe nga një fuzhnje. Me vete kishin marrë dhe nga një qese najloni. Kuptohet pse shërbenin ato: për t'i mbushur me

gjahun e detit.

- Shkojmë te Bregu i Pulëbardhave, - propozoi Miri.

Vazhduan me not. Kështu shkurtonin rrugën se, po të dilnin në tokë, do t'i binin bregut rreth e rrotull.

Në Bregun e Pulëbardhave s'kishte pulëbardha, por kishte valë të bardha. Gaforret trembeshin prej tyre dhe fshiheshin me nxitim nëpër plasat e shkëmbinjve e iknin nëpër ujë.

- Sa lemçe e madhe është kjo këtu! Do ta zë! - bërtiti Beni, kur pa një gaforre të kuqe.

- Kujdes, mos e prish! Ngulja majën e fuzhnjës në gojë.

Beni e zuri me kujdes gaforren interesante dhe me mund e nxori nga plasa e shkëmbit.

- Shikojeni sa është!

Vocërraku e mbajti majë fuzhnjës kafshën e detit me shumë këmbë e me dy dhëmbë të mëdhenj derisa ngordhi. Pastaj, me kujdes, e futi në qesen e najlonit dhe e la mbi një kep.

- Këtu qenka shumë thellë!

- Edhe valët nuk të lënë të marrësh frymë lirshëm.

- Shkojmë te Gjiri i Qetësisë.

E lanë Bregun e Pulëbardhave dhe notuan drejt Gjirit të Qetësisë. Ai gji e meritonte atë emër. Në të ishte një bunacë e papërskrueshme. Mbi ujë shiheshin shumë qartë shkëmbinjte e veshur me alga të kuqe dhe gurët e vegjël në fund të detit.

- Sa peshq! - tha Beni me kënaqësi.

- Këtu duhet të vijmë me grepa.

- Të shohim pranë shkëmbinjve nëse ka iriqë.



Iu afruan shkëmbinjve dhe u zhytën.

- Iriqë sa të duash!
- Paska edhe guaska!?
- Sa kërmij! Pa numër!

Filluan të bënë gara se cili do të gjente më shumë. S`u lodhën fare. Notimi, zhytja e peshkimi për ta ishte kënaqësi.

Më vonë dolën në breg të pushonin. Secili nisi të numëronte gjahun e vet:

50 iriqë, 70 kërmij, 7 gaforre, 3 yje, 60 guaska,

Vogëlushët qeshnin e gëzoheshin për gjahun e madh.

Dielli hipi në kupën e qiellit të kaltër, uji u turbullua nga rryma e ngrohtë e jugut, bregu i gjirit u mbush me notues...

Hajro Ulqinaku



Dëgjojmë

- Pas leximit të mësueses/it plotëso:

Personazhet e tregimit janë:,

.....,,

Ata morën me vete:,

.....,

Gjahu i tyre ishte: iriqë,kërmij,

.....gaforre,yje,guaska,

.....,



Pyetje rreth tekstit

1. Në ç`stinë zhvillohet ngjarja?
2. Ku shkojnë fëmijët për të gjuajtur?
3. Ç`peshkuan në Bregun e Pulëbardhave?
4. Ritregoni bisedën e fëmijëve në Gjirin e Qetësisë.
5. Cila pjesë ju pëlqen më shumë? Pse?

Struktura e tregimit

1. Dallo në tekst **hyrjen**, **zhvillimin** dhe **mbylljen** e tregimit.
2. Ç`lloj tregimi është ky: **realist** apo **fantastik**? Pse?
3. Në këtë tregim mbizotëron **dialogu** apo **përshkrimi**? Pse?



Fjalorth

liman - gji i vogël në breg të detit, ku qëndrojnë anijet.

pendët e notimit - penda (pjesë) prej llastiku që vënë në këmbë notarët për të notuar më mirë.

fyza e frymëmarrjes - maskë që vendoset në hundë dhe me ndihmën e një tubi notari merr ajër, kur është nën ujë.

fuzhnje - thupër metalike si shigjetë që shërben për të goditur peshqit.

kep - shkëmb i madh dhe i thepisur

bunacë - det shumë i qetë, para ose pas stuhisë.

algë - bimë e gjelbër, që rritet në vende me ujë.



Detyrë

- Shkruaj disa emra kafshësh që jetojnë në det:

.....,

.....,

Përshkruaj një prej tyre (madhësia, pesha, ngjyra, mënyra e lëvizjes, e ndonjë karakteristikë tjetër të veçantë).



Plani i veprimtarisë

? Pyetje rreth tekstit

- Ritrego bukur dhe me hollësi sipas këtij **plani**:

Fëmijët shkuan për të peshkuar.
Ata morën pajimet e peshkimit me vete.
Në fillim shkuan te Bregu i Pulëbardhave.
Pastaj shkuan te Gjiri i Qetësisë.
Ata kapën një gjah të pasur.

Punë në grup


Ndahuni në tri grupe dhe secili grup të zgjedhë një veprimtari që do të realizojë.
Por më parë duhet të bëni planin e veprimtarisë.

Lloji i veprimtarisë	
Qëllimi i veprimtarisë	
Pjesëmarrësit	
Udhëheqësi i grupit	
Koha	
Vendi	
Mjetet	
Mënyra e realizimit	
Përfundimi	



Ditari i pemës

Pema ka jetën e saj, siç keni dhe ju jetën tuaj. Me kalimin e viteve ajo rritet, ashtu siç rriteni dhe ju. Gjatë këtyre viteve ndodhin shumë ngjarje në jetën e saj, siç ndodhin dhe në jetën tuaj. Këto ngjarje shumë nga ju i shkruani në ditar ose i ruani në mendjen tuaj. Edhe pema ka ditarin e saj që e ruan brenda vetes.



Ne mund ta lexojmë ditarin e kësaj peme në figurë.

Vëreni me kujdes rrathët që janë në trungun e prerë të pemës. Ata tregojnë sa vjeç është pema. Te rrathët ne mund të

lexojmë disa nga ngjarjet e jetës së pemës. P.sh., rrathët që janë të ngushtë, flasin për një stinë të thatë (pa shira) d.m.th., tregojnë se pema nuk është rritur mirë. Rrathët më të gjerë tregojnë për një stinë me shira të bollshëm, d.m.th., pema është rritur mjaft mirë. Vijat e thelluara (vragat) të pemës tregojnë dëmtimet që ka pësuar pema.

Këto dëmtime mund të jenë shkaktuar nga një zjarr në pyll ose nga këputja e ndonjë dege të pemës. Një degë e thyer është si një krah i vrarë apo i këputur që e ndien tërë trupi ynë. Këto janë plagët e pemës, të ngjashme me brençat tona prej kujtimeve të hidhura.

Fjalorth

brençë –mërzitje e madhe

Shiko figurën dhe gjej:

Sa vjeç është pema? _____

Në cilat vite ajo është rritur mirë dhe në cilat keq? _____

Pyetje rreth tekstit

1. Si mund ta njohim jetën e pemës?
2. Çka tregojnë rrathët e ngushtë?
3. Çka tregojnë rrathët e gjerë?
4. Çka tregojnë vijat e thelluara në trungun e pemës?
5. Pse themi që dhe pema ka ditarin e saj?

Kthehu te teksti

Shëno me dhe fjalitë e mëposhtme:

- Pema ka jetën e saj njëllor si ne.
- Rrathët në trungun e pemës nuk tregojnë gjë.
- Rrathët e ngushtë tregojnë për një stinë me shira të bollshëm.
- Rrathët e gjerë tregojnë për një stinë të thatë.
- Vijat e thelluara tregojnë për një jetë të qetë pa rreziqe.



T'i mbrojmë pemët

1. Përse janë të rëndësishme pemët?

Zbukurojnë mjedisin,
mbajnë ajrin të pastër,

.....
.....
.....

Shto të tjera.



2. Ne duhet t'i mbrojmë pemët:

të mos i thyejmë degët,
t'i mbrojmë nga zjarri,


.....
.....
.....

Shto të tjera.



3. Shiko vizatimet e nxënësve dhe fol për to. →

4. Diskutoni në klasë për kënaqësinë e shëtitjes në pyll.





Folja *jam* dhe *kam* në kohën e pakryer



	jam	kam
unë	isha a	kisha a
ti	ishe e	kishe e
ai/ajo	ishte e	kishte e
ne	ishim i	kishim i
ju	ishit i	kishit i
ata/ato	ishin i	kishin i

Unë **isha** me pushime në Durrës.
Ne **kishim** top, varkë, çadër plazhi etj.

Ushtrahu

1. Nënvizoj foljen *jam* dhe *kam* në tekstin e mëposhtëm.

Verën e kaluar isha me pushime në Durrës. Moti ishte shumë i mirë. Ditët ishin të nxehta. Unë kisha një kamerdare të madhe, motra kishte shumë lodra për në rërë. Ne kishim edhe një varkë. Sa keq që ti s'ishe me ne! Kur ne ishim në det, ju ishit në rërë. Perëndimi i diellit ishte shumë i bukur.

2. Shkruaj si duhet foljen *jam* në kohën e pakryer.

Unë isha me pushime në Dajt.
Ne pranë një burimi.
Ata në një lëndinë me bar.

Ju.....në mal.
Aii gëzuar
Time prindërit.

3. Vendos fjalën e duhur para foljes.

..... kishe një çadër verimi.
.....kishte shtëpi të bukur.
.....kishim festë.

..... kisha patina.
.....kishit shfaqje.
.....kishin ekskursion.

4. Shkruaj në kohën e pakryer foljet në kllapa.

Unë (kam) një kukull të madhe. Ajo (kam)flokë të verdhë. Këpucët e saj (jam)të bardha, kurse fustani (jam) i kuq. Por unë (kam) qejf lodrat elektronike të vëllait. Ai (kam)shumë CD. Edhe ti Albana (jam) dje në shtëpinë tonë. Ti (kam) shumë lodra interesante. Ju (kam)edhe lodra, edhe libra të bukur.

5. Shkruaj një tekst me katër fjali ku të përdorësh foljen *jam* dhe *kam* në kohën e pakryer.



Dielli



A dëshiron të bësh një shëtitje me anijen tonë kozmike? Eja dhe shiko me vëmendje. Tani po i afrohem qiellit, ku ka miliona e miliona yje. Shiko me vëmendje njërin prej tyre. Ti e njeh atë, sepse ai shndrit gjatë gjithë ditës. A e njeh cili është? Po, është Dielli.

Dielli është një yll. Dielli nuk duket aq i vogël sa yjet, sepse është më afër Tokës.

Dielli është **i madh** dhe **rrumbullakët**.

A e di sa i madh është ai? Mendo sa e madhe është Toka. Atëherë Dielli është sa një milion Toka së bashku.



Tani imagjino sikur me anijen tonë po i afrohem Diellit. Ai duket si një top i madh gjigant me re. Por këto re nuk janë si ato që ti sheh në qiell në një ditë me diell. Ato nuk janë as si retë në një ditë me shi. Këto re janë ngjyrë portokalli, të verdha dhe të bardha. Edhe në qoftë se do të mund t'i afrohem Diellit, nuk do të arrinim të shihnim asgjë, sepse Dielli është shumë, shumë i ndritshëm. Ti asnjëherë nuk duhet ta shikosh atë drejtpërdrejt, pasi mund të të dëmtohen sytë.

Tani ne nuk mund të afrohemi më pranë tij, sepse Dielli është shumë i nxehtë. Mendo për disa gjëra që janë të nxehta. Mendo për një ditë vere të nxehtë ose për rërën e plazhit që djeg. Mendo për **zjarrin** . Mendo për furrën, ku mamaja jote pjek byrekun. A janë ata më të nxehtë se sa një yll i nxehtë? Jo. Dielli është shumë, shumë më i nxehtë. Çfarëdo që të mendosh ti, asgjë nuk është aq e nxehtë sa Dielli.

Tani është koha kur shëtitja jonë ka mbaruar. Dielli po të buzëqesh në dritare. Ai është zgjuar para teje. Me siguri di gjithçka për udhëtimin tënd.

Pyetje rreth tekstit

1. Çfarë është Dielli? Ku ndodhet ai?
2. Pse Dielli duket më i madh se yjet:
është më i madh se ato apo është më afër Tokës se yjet?
3. Çka ndodh nëse e shikon gjatë Diellin pa ia ndarë sytë? Pse?
4. Numëro disa gjëra shumë të nxehta? A janë ato më të nxehta se Dielli?

Detyrë

Përshkruaje Diellin me katër fjali.



Drejtshkrim

Folja *jam* dhe *kam* në kohën e kryer të thjeshtë

1. Mëso zgjedhimin e foljeve *jam* dhe *kam* në kohën e kryer të thjeshtë. →

	jam	kam
unë	qeshë	pata
ti	qe	pate
ai/ajo	qe	pati
ne	qemë	patëm
ju	qetë	patët
ata/ato	qenë	patën



2. Lidh me shigjetë dhe shkruaj zgjedhimin e foljes *jam* në kohën e kryer të thjeshtë.

Unë	qemë të gjithë të gëzuar.	Unë qeshë
Ti	qe me tuta sportive.
Aty	qetë në rrugën e hapur.
Ne	qeshë në pyll së bashku me shokët.
Ju	qenë në mes të dëborës.
Skuadrat	qe shumë ftohtë.

3. Lidh me shigjetë dhe shkruaj zgjedhimin e foljes *kam* në kohën e kryer të thjeshtë.

Unë	pata ski të mëdha.	Unë
Ti	patën shumë mbresa.	Ti
Vala	patët me vete trajnerin e skive.	Ai /ajo
Ne	pate çantën shumë të rëndë.	Ne
Ju	pati xhup lëkure.	Ju
Fëmijët	patëm ekskursion dje.	Ata

4. Vendos foljet në kllapa në kohën e kryer të thjeshtë.

Njëherë një baba (kam) tre djem. Djemtë (jam) të rritur. Babai (jam) i sëmurë dhe i thirri djemtë pranë shtratit. Babai s' (kam) pasuri t'u linte djemve. Ai (jam) i varfër, por punëtor e i ndershëm. Ai u la një këshillë të vlefshme djemve. Po s'(kam) pasuri, punoni shumë ta siguroni.

5. Shkruaj në kohën e kryer të thjeshtë foljet që nuk janë në këtë kohë.

Kur qeshë pesë vjeç, unë shkoja në kopsht. Në grupin tim kisha edhe Anin, vajzën e tezes. Unë isha më e vogël se ajo, por kisha trup më të gjatë. Ne qemë shoqe të ngushta me njëra-tjetrën. Atëherë unë kam shumë lodra me kafshë, kurse Ani ka shumë kukulla.

Rubrika IV



Unë mësoj nga përrallat dhe tregimet



PRINCESHA-MOLLË



Na ishin njëherë një mbret dhe një mbretëreshë, të cilët nuk kishin fëmijë.

- Pse të mos bëj edhe unë fëmijë, ashtu si pema e mollës bën mollë? – thoshte e pikëlluar mbretëresha.

Një ditë prej ditësh mbretëresha bëri një mollë kuqalashë të mrekullueshme në vend të fëmijës. Mbreti e vuri mollën në një tabaka të artë dhe e vendosi në tarracën e tij.

Përballë kështjellës së mbretit jetonte një princ. Një ditë të bukur ai pa në tarracën përballë një vashëz të bukur, të bardhë e të kuqe si një mollë, e cila po krihej në diell.

Princi mbeti gojëhapur nga bukuria e vajzës. Por vajza, kur e pa princin, hyri me nxitim brenda në mollë dhe u zhduk.

Që atë ditë princi ra në dashuri me vajzën e mollës. Mendoi e mendoi dhe një mëngjes trokiti në pallatin mbretëror. Ai iu lut me gjithë shpirt mbretëreshës që t'ia jepte atij mollën e kuqe.

- Ç'thoni kështu?! - i tha mbretëresha. - Nuk e dini që e kam dëshiruar me shpirt atë.

Po princi iu lut kaq shumë dhe kaq shumë iu betua se do ta ruante si sytë e ballit, sa mbretëresha më në fund pranoi. Çdo ditë princi mezi priste agimin, kur vashëza dilte nga molla dhe krihte flokët e mrekullueshëm.

Princi jetonte me njerikën, e cila filloi të dyshonte, se përse ai mbyllej vazhdimisht në dhomën e tij.

Një ditë, kur princi u largua nga pallati, ia besoi mollën shërbëtorit të tij më besnik. Njerka e vuri në gjumë shërbëtorin dhe s'la vend pa kërkuar. Më në fund gjeti një mollë të hijshme në një shportëz të artë.

- A thua kjo mollë të jetë e fshehta e tij?!

Mori një biçak dhe filloi ta qëronte mollën.

Kur shërbëtori u zgjua, e gjeti mollën të mbytur në gjak. Vrapoi te halla e tij, e cila ishte magjistare, dhe iu lut t'ia jepte një nga pluhurat e saj magjike.

Shërbëtori u kthye te molla dhe e spërkati atë me pluhurin çudibërës. Molla u çka dhe prej andej doli vashëza e rrethuar me fasha.



Kur u kthye princi, vajza i foli për herë të parë:

- Jam 18 vjeçe dhe sapo u çlirova nga magjia. Nëse vërtet më do, duhet të kërkosh dorën time te prindërit e mi.

- Natyrisht që të dua! – u hodh princi i lumtur.

Dhe u bë një dasmë madhështore dhe e hareshme mu në mes të dy kështjellave mbretërore. Mungonte vetëm njerka, e cila ia mbathi dhe nuk u duk më kurrë.

Italo Kalvino



Fjalorth

mbeti gojëhapur – u shtang; këtu: u habit shumë nga bukuria e vajzës.
biçak – thikë e vogël xhepi, që futet në një këllëf druri ose plastike.
fashë - rrip prej pëlhere të hollë, që përdoret për të lidhur plagët.

? Pyetje rreth tekstit

1. Pse mbreti dhe mbretëresha nuk ishin të lumtur? Çka dëshironin ata?
2. Me kë ra në dashuri princi:
me mollën apo me vajzën brenda mollës?
3. Si arriti njerka t'i bënte keq vajzës së mollës?
4. Trego me fjalët e tua mënyrën se si u prish magjia.
5. Pse autori e titullon përrallën *Princesha-mollë* ?

Plotëso

6. Cilët e shpëtuan *Princeshën-mollë*?

molla pluhuri magjistarja shërbëtori fashat

7. Si përfundon përralla:

Vashëza-mollë dhe princi u martuan dhe jetuan përgjithmonë të lumtur.

Vashëza u kthye përgjithmonë në mollë dhe princi nuk e pa më kurrë.

Njerka nuk u kthye më kurrë në pallat.

- Pra, përralla përfundon: mirë apo keq? Pse?

Detyrë

- Mëso ta tregosh bukur këtë përrallë.



Ndërtimi i përrallës

Përralla është një rrëfim (tregim) popullor për ngjarje fantastike, ku veprojnë personazhe magjike. Duke u mbështetur te përbërësit e përrallës popullore, shumë shkrimtarë kanë krijuar përralla mjaft të bukura. Kujtoni përrallën *Rosaku i shëmtuar*, shkruar nga Anderseni; *Kopshti i gjigantit*, shkruar nga Uajldi ose përralla *Princesha-mollë*, shkruar nga Kalvino.

Ja disa nga përbërësit e përrallës:

Koha

Koha e përrallës është e papërcaktuar.

Vendi

Vendi është gjithmonë përrallor, magjik ose misterioz.

Personazhi kryesor

Personazhi kryesor i përrallës është i mirë (pozitiv) dhe guximtar. Atij i dalin gjithnjë pengesa nga personazhi i keq (negativ), por më në fund del fitimtar.

Personazhe ndihmëse

Personazhet ndihmëse (dytësore) e ndihmojnë personazhin kryesor të kalojë vështirësitë.

Objektet magjike

Objektet magjike i shërbejnë shpesh personazhit dytësor për të ndihmuar personazhin kryesor.

Fundi i përrallës

Përrallat mbyllen gjithmonë me një **fund të lumtur**, ku fitimtar del **personazhi pozitiv**. Ndërsa **personazhi negativ** e pëson.

Diskuto

- Së bashku me mësuesen/in analizojini një nga një të gjithë përbërësit te përralla "Princesha-mollë".



Zgjidh një përrallë që ty të pëlqen më shumë dhe mëso ta analizosh sipas modelit të mësipërm.

Hyrje përrallash

Të gjitha hyrjet e përrallave ngjasojnë me njëra-tjetrën. Ato fillojnë me: *Na ishte njëherë ...*
Ishte se ç'na ishte.... .Shumë kohë përpara...

Shiko se si nisin këto përralla:

Sírenat

Njëherë e një kohë mes kríjesave të mrekullueshme të detit jetonte Mbreti Mjekërbardhë. Ai kishte shtatë vajza, ndërmjet të cilave dallohej njëra. Ajo ishte më e bukura dhe më e magjishmja që kishin parë ndonjëherë kríjesat e detit. Ariela ishte sírenë, gjysmënjeri dhe gjysmëpeshk....



Peshku i artë

Na ishte një herë një peshkatar i vjetër që kishte një grua dhe një kasolle pranë detit. Ai shkonte gjithnjë për të peshkuar, por ndonjëherë kapte peshk dhe ndonjëherë jo. Peshkatarin ishte i varfër, shumë i varfër dhe kasollja e tij ishte bërë me baltë dhe me kashtë...



Hansi dhe Greteli

Shumë e shumë kohë më parë jetonte në pyll një familje shumë e varfër. Pjesëtarët e familjes ishin: djali Hans, vajza Gretel, babai i tyre dhe njerka e keqe. Njerka nuk i donte fare fëmijët e burrit dhe mendohej t'u bënte keq...



Siç e vure re, në hyrje të përrallës jepen disa të dhëna kryesore për personazhet.

Detyrë

Shkruaj dy hyrje përrallash. (Sipas modeleve të mësipërme.)

Rosaku i vogël i shëmtuar



Një zog i vogël i sapolindur rrinte strukur pranë nënës së tij. Gjithë zogjtë e tjerë dolën për të notuar në përrua. Nëna e detyroi më në fund rosakun të dilte jashtë. Por, kur e panë rosat e rosakët e tjerë, filluan ta shajnë:

- Iiii, sa i shëmtuar! Ti nuk e meriton të rrish me ne. Largohu dhe shko diku tjetër!

Ngaqë ishte i shëmtuar dhe ngjyrë kafe, zogjtë e tjerë nuk donin të rrinin me të. Askush nuk e mbrojti rosakun e mjerë. Ai nuk dinte ç'të bënte dhe as ku të fshihej. I vinte turp nga vetja. Çdo ditë që kalonte, ishte dhe më e keqe për rosakun e vogël.

Më në fund vendosi të notonte përpjetë përroit. Iu mbush mendja se askush nga anëtarët e grupit nuk donte të kishte një shok të shëmtuar.

Një ditë ai arriti pranë një shtëpie ku jetonte një grua, e cila kishte një mace dhe një pulë. Më në fund dikush u bë i mirë për të dhe i hapi derën.

Një mëngjes, në oborrin e shtëpisë fluturoi një grup mjellmash të mrekullueshme. Ato e pranuan rosakun e vogël në shoqërinë e tyre. Po rosaku vazhdonte të ishte i mërzitur. Ai mendonte se ishte i shëmtuar dhe nuk e meritonte shoqërinë e tyre.

Në mëngjesin e parë të pranverës ndodhi një gjë e çuditshme. Rosaku i trishtuar shihte mjellmat e bukura dhe mendonte se ishte më mirë të vdiste sesa ta tallnin, ngaqë ishte i shëmtuar. Fluturoi drejt e në ujë dhe u drejtua nga mjellmat duke thirrur:

- Vritmëni, - dhe uli kokën. Por ç'të shihte?! Rosaku nuk arriti ta njihje veten e tij, kur e pa të pasqyruar në ujë. Nga një shpend i dobët dhe i shëmtuar ai



ishte shndërruar në një shpend të mrekullueshëm me pupla të bardha, që shkëlqenin në rrezet e diellit.

Mjellmat e tjera e rrethuan duke thirrur:

- Ua, paska ardhur një mjellmë e re! Sa e mrekullueshme qenka!

Mjellmës së re i rrodhën lot nga gëzimi. Kurrë nuk e kishte menduar se një mëngjes të bukur pranvere do të zgjohej një mjellmë e re dhe e bukur.

Kujt i intereson se ke lindur në pulari, nëse ke dalë nga veza e mjellmës.

Hans K. Andersen

Fjalorth

përrua - rrjedhë uji më e vogël se lumi

ishte shndërruar - kishte marrë një pamje krejt të ndryshme nga e para

Pyetje rreth tekstit

1. Pse rosaku i vogël nuk dilte të luante me rosakët e tjerë?
2. Çka i thanë atij anëtarët e grupit ?
3. Ku shkoi më pas rosaku i vogël?
4. Pse rosaku u ndje keq me mjellmat:
 - sepse e shanë;
 - sepse e përbuzën;
 - sepse nuk ndihej mirë me veten?
5. Pse në mëngjesin e parë të pranverës shpendi u ndje i lumtur?
6. Çka kishte ndodhur?
7. Si i kupton fjalët në fund të përrallës?

Kthehu te teksti

- Gjej në tekst sa herë është përmendur fjala *i shëmtuar*.
- Gjej në tekst sa herë është përmendur fjala *i mrekullueshëm*.
- Gjej dhe lexo fjalitë thirrmore.
- Gjej dhe lexo dy fjalitë që tregojnë se rosakut i vjen turp nga vetja.
- Gjej dhe lexo fjalinë ku shprehet se dikush nuk e përzuri rosakun.
- Gjej dhe lexo fjalinë që tregon se veza e mjellmës ishte ngatërruar me vezët e rosave.

Plotëso cilësitë e jashtme

<i>Rosaku i vogël</i> i shëmtuar	<i>Mjellma e rritur</i> e bukur
.....
.....


Mbyllje përrallash

- Të gjitha përrallat kanë **një fund të lumtur**. Ata që janë të mirë, jetojnë të lumtur. Ata që bëjnë keq, dënohen. Ata që bëjnë gabime e pësojnë dhe mësojnë nga gabimet (si peshkatori i varfër).

Sirena

- Urime vogëlushë! - i tha i mallëngjyer Mbreti i Detit. - Qofsh e lumtur me princin tënd!

Dhe, ndërsa anija po largohej mbi valët e detit, dy të rinjtë u puthën me njëri-tjetrin. Në këtë çast të gjitha krijesat e detit thirrën: **URRA! Jetë të lumtur!**



Peshku i artë

Nuk kishte më mrekulli. Nuk kishte më gjëra të bukura. Nuk kishte çudira që vinin prej peshkut të artë. Gjithsesi, peshkatori ishte shumë **i lumtur** që u kthye në jetën e tij të zakonshme.



Hansi dhe Gretel

Hansi, Greteli dhe babai i tyre u kthyen në shtëpi **të lumtur**. Varfëria e tyre kishte marrë fund njëherë e përgjithmonë dhe njerka e keqe nuk ishte më.



Detyrë

Shkruaj me katër fjali mbylljen e **dy përrallave** që të pëlqejnë më shumë (sipas shembujve të mësipërm).



Sinonimet - fjalët me kuptim të njëjtë

Kujto

Sinonimet janë fjalë të ndryshme që kanë kuptim të njëjtë ose shumë të afërt.



Park i **gjelbëruar**.
Park i **bleruar**.

Nxënës të **zgjuar**.
Nxënës të **mençur**.



Mësuese e **zonja**.
Mësuese e **aftë**.

Sinonimet janë një pasuri e madhe për gjuhën.

Ato ndihmojnë për ta shprehur më bukur mendimin dhe në situata nga më të ndryshmet.

Ushtrahu

1. Lexo fjalët dhe shkruaj në fletore grupet e sinonimeve:

shikoj, vështroj, mirëqenie, vajzë, cucë, shtëpi, dhomë, sodit, banesë, odë, pallat, konak, gocë, apartament, vërej, vilë, çikë, mirësi, mbarësi, çupë.

2. Shtoju sinonimeve të dhëna dhe sinonime të tjera.

ëndje, qejf,
habit, çudit
ënjtëm, mbufatëm,
bisedë, kuvendim
i paarrirë, i papjekur.....

3. Dallo sinonimet që janë përdorur me kuptimin e parë dhe me kuptim të figurshëm.

Kalamajtë po luanin në oborr. Beni është kalama.

Ti bën si bebe. Bebja solli gëzim në familje.

Fëmijët fjetën herët. Ajo nganjëherë bën si fëmijë.

3. Nënvizto me të kuqe sinonimet e mësipërme.

Luani dhe miu



Njëherë një luan i madh po flinte. Një mi i vogël po vraponte afër tij dhe e zgjoi:

- Ti do të jesh darka ime sot, - tha i nervozuar luani.

- Jo, të lutem, më lësho, - iu lut duke qarë miu. - Ndoshta ndonjë ditë ti mund të kesh nevojë për mua.

- Ti je shumë i vogël për të më ndihmuar, - qeshi luani.

Por megjithatë e la të ikte. Më vonë miu dëgjoi luanin duke ulëritur. Ai shkoi të shihte çfarë po ndodhte dhe e pa luanin të lidhur me një litar. Me shpejtësi filloi të priste litarin me dhëmbët e tij të mprehtë. Luani u lirua.

- Faleminderit, o mi i vogël! - i tha luani. - Tani po e kuptoj se ajo që më the ti ishte shumë e vërtetë.

Fabul

Miqtë e vegjël janë
po aq të rëndësishëm
sa miqtë e mëdhenj.


- Thuaje fabulën me fjalët e tua.
- Çfarë mësimi nxore nga fabula?
- A të ka ndodhur t'i japësh ndihmë dikujt që është më i madh se ti?




Luajmë në role (Personazhet e fabulës)

Luajmë së bashku

- Kur ta luani pjesën në role është mirë të përdorni disa maska.
- Ose krijoni kukulla prej lecke që futen si dorashka në duar.



- Nëse ke dëshirë që t'i luash në role me shokët e tu fabulat, së pari veço fjalët që thonë kafshët.
- Në fabulën “Luani dhe miu” veçojmë fjalët e luanit dhe të miut.



(Ti mund të shtosh edhe vetë fjali të tjera, që biseda të jetë pak më e gjatë).

◆ Shiko figurën e fabulës: “Korbi dhe dhelptra”.

Korbi kishte në gojë një copë djathë. Dhelptra i bëri lajka (i tha fjalë të bukura) dhe iu lut të këndonte. Sapo hapi gojën, korbit i ra djathi nga goja.

Shkruaj fjalët që thonë: *Korbi dhe dhelptra*.

Dhelptra: Mirëmëngjesi, o korb i bukur!

Korbi nuk flet se ka djathin në gojë.

Dhelptra:

Korbi hesht.

Dhelptra: etj.



Iriqi dhe mollët



Një ditë Iriq Gjembaçi kishte dalë nga strofka e tij për të gjetur ushqim. Bëri një copë udhë dhe u ndal nën një pemë. Vendi ishte mbushur me mollë të vogla, që kishin rënë nga era. "Sa mirë! - tha me vete Iriq Gjembaçi. - Tani do ta mbush barkun plot. Apo s'më ka marrë dhe uria!"

Dhe ashtu bëri. Filloi të hante i uritur. Mollët ishin të shijshme. Hëngri sa hëngri, mendoi edhe për iriqët e tjerë. Po si t'i mernte mollët? Në gojë ai mund të mbante vetëm një kokërr. Mendoi pak dhe gjeti një zgjidhje. Atëherë u kthye me kurriz nga toka. Trupi iu mbush me mollë.

Kur arriti te strofka, njëri nga iriqët thirri:

- Erdhi Iriq Gjembaçi plot me mollë!

Të gjithë iu afruan. Morën nga një mollë dhe filluan ta hanin.

Iriq Gjembaçi shikonte i kënaqur shokët e tij.

Përrallë



? Pyetje rreth tekstit

1. Ku po shkonte iriqi dhe çfarë pa?
2. Cila ishte zgjidhja që i erdhi në mendje?
3. A u gëzuan shokët me veprimin e Iriqit? Po iriqi si u ndje? Pse?

Kthehu te teksti

Lexoje dhe një herë fjalinë: *Gjeti një zgjidhje.*

Kujto ku është përdorur ajo te pjesët e kaluara.

- Gjyshi i sëmure gjeti një zgjidhje. Cilën?
- Babi që punonte në fshat gjeti një zgjidhje. Cilën?
- Iriq gjembaçi gjeti një zgjidhje. Cilën?

! Po ti?


Po ti a je i zoti të gjesh zgjidhje në çastet e duhura?

Trego një rast.



Antonimet - fjalët me kuptim të kundërt

Qumështi im është **i ftohtë**.



Qumështi im është **i nxehtë**.

Qumështi mund të jetë: **i ftohtë - i vakët - i ngrohtë - i nxehtë**

Fjalët **i ftohtë - i nxehtë** janë antonime të plota.

Fjalët **i vakët - i ngrohtë** janë antonime të pjesshme.

Mëso! Shumë antonime formohen me parashtesa që i japin fjalës kuptimin e kundërt.

lodh - **çlodh**

ngul - **shpërngul**

vesh - **zhvesh**

armatos - **çarmatos**

përbëj - **shpërbëj**

mbathur - **zbathur**

Ushtrohu

1. Shkruaj fjalët e kundërta të këtyre mbiemrave.

i mirë	-	i bukur	-
i madh	-	i bardhë	-
i gjatë	-	zemërgjerë	-

2. Shkruaj mbiemrat e kundërt duke përdorur parashtesa.

i lodhur	-	i veshur	-
i liruar	-	i edukuar	-
i armatosur	-	i organizuar	-
i interesuar	-	i emëruar	-

3. Ktheji mbiemrat e mësipërm në folje, pastaj shkruaj foljet me kuptim të kundërt.

i lodhur - lodh - çlodh

4. Shkruaj emra abstraktë me kuptim të kundërt.

ngrohtësi	fatmirësi
gëzim	lumturi
zemërgjerësi	butësi
shpirtmadhësi	ngathtësi

Zogu dhe djali



Një zog të bukur zuri një djalë,
ai po dridhej dhe i thosh ca fjalë:
- Nuk të vjen keq që jam i mitur,
si ti i vogël dhe i parritur?
Jam bir i vetëm, mëma më pret
E kam lënë keq brenda në fole.
Dheu me borë gjithë u mbulua,
edhe s'ka mbetur gjëkund pothuaj!
Më pret imëzë si ty jot ëmë,
Të mos i vete, ç' bëhet prëmë?
Kam dhe unë shpirt e dua të rroj,
të lëviz, të bredh, të loz, të këndo.
Fjalët e zogut djali i dëgjo,
qau, e puthi, pastaj e lëshoi...

Naim Frashëri



Fjalorth

- i mitur* - i vogël
- imëzë* - ime më (mamaja)
- prëmë* – mbrëmë (në mbrëmje)
- bredh* – shkoj andej-këtej pa qëllim

Pyetje rreth tekstit

1. Për cilën stinë të vitit flet vjersha?
2. Çka i ndodhi zogut të vogël?
3. Pse djalit i erdhi keq për zogun?
4. A bëri mirë ai që e lëshoi? Pse?
5. Çka do të bëje ti nëse një zog bie nga foleja? Pse?


Kthehu te teksti

Shëno me dhe fjalitë e mëposhtme:

- Mëma e djalit është brenda në fole.
- Mëma nuk shqetësohet për zogun e vogël.
- Nuk ka rënë shumë dëborë.
- Zogut i pëlqen të jetojë.
- Djali e përqafoi zogun.

Krahasonjë

Çfarë kanë njëloj dhe çfarë kanë ndryshe zogu dhe djali? Lidh me shigjetë.



Detyrë

Mësojevlershënpërmendsh dhe recitoje bukur.
(Kur të thuash fjalët e zogut duhet të bësh sikur ke frikë dhe ftohtë.)

Dheu është flori

Një bujk plak para se të vdiste, thirri tre djemtë e tij dhe u tha:

- O bijtë e mi, në arën para shtëpisë unë kam punuar gjithë jetën time dhe me drithin e saj ju kam ushqyer e ju kam rritur deri tani. Tamam në këtë arë kam fshehur një qyp me florinj. Gërmoni thellë dhe kërkoni në të gjitha anët e saj për ta gjetur qypin. Dhe ju nuk do të jeni të varfër asnjëherë.

Të tre bijtë e plakut, pas vdekjes së babait, zunë ta gërmonin arën në të gjitha anët. Ata e gërmonin dheun dhe mot për mot e thellonin nga një pëllëmbë më tepër. Po qypin përsëri nuk e gjenin dot.

Sa më shumë që e punonin arën, aq më tepër prodhime jepte ajo. Nga prodhimet e saj vëllezërit jo vetëm që jetonin, por u tepronte shumë edhe për të shitur. Të hollat që merrnin nga prodhimet e shitura, i hidhnin në një qyp për t'i kursyer.

Për pesë vjet qypi u mbush plot me florinj. Vetëm atëherë vëllezërit e kuptuan se ku ishte qypi me florinj, që u tha i ati.



Plaku me shkop, Andrea Kushi

Sami Frashëri

KUPTOJMË TEKSTIN

Fjalorth

qyp - enë balte për ujë ose ushqime

të hollat - paratë

Pyetje rreth tekstit

1. Çka u tha babai djemve para se të vdiste?
2. A e mbajtën vëllezërit fjalën e babait?
3. A e gjetën vëllezërit qypin që u tha babai?
4. Si arritën ata të bëhen të pasur:

me punë

apo

gjetën thesarin e babait?

Kthehu te teksti

Shëno me dhe fjalitë e mëposhtme:

- Bujku plak thirri katër djemtë e tij para se të vdiste.
- Babai u tha se kishte fshehur një qyp me florinj.
- Vëllezërit e gërmuan dheun vetëm një vit.
- Qypi u mbush plot me florinj për pesë vjet.
- Vëllezërit më në fund e gjetën të fshehur qypin me florinj.

Plotëso

Sa më shumë **gërmonin**, aq më shumë e **thellonin** arën.

Sa më shumë e **thellonin**, aq më shumë.....

Sa më shumë **prodhonin**,

Sa më shumë **u tepronte**,

Sa më shumë **grumbullonin**,

Kthimi i Ymer Agës

Ymer Aga ishte një nga djemtë më trima dhe më të hijshëm të vendit. Ai u martua me më të mirën dhe më të bukurën e vashave të vendit. Por ata nuk e gëzuan dot njëri - tjetrin. Të nesërmen e dasmës Ymer Aga u nis në luftë për të mbrojtur vendin nga pushtuesit. Para se të nisej, ai i tha vashës:

- O, e bukura ime! Sa kohë do të më presësh ti mua? Unë po nisem për luftë dhe nuk i dihet a kthehem përsëri.

- Nëntë vjet e nëntë ditë, o im zot, - iu përgjigj e pikëlluar vasha.

- Nëse nuk kthehem për nëntë vjet e nëntë ditë, ti martohu, - i tha





Ymer Aga dhe e puthi nusen në ballë.

Lufta ishte e gjatë dhe armiku shumë i egër. Ymer Aga luftoi me trimëri dhe qëndroi si burrat deri në fund. Kur u plagos rëndë, atë e zunë rob. E shpunë në burg dhe mbeti atje për shumë vjet. Po Ymer Aga ishte i ri, trim dhe plot gëzim në shpirt. Ai dinte të qeshte, të këndonte dhe në burg. Por, papritur, një mëngjes ai u ngrys. Nuk pranoi as të hante, as të pinte. Vetë mbreti u interesua për trimin shqiptar:

- Çfarë ke, o Ymer Agë? Pse nuk ha e pse nuk këndon më?

- Nesër mbushen nëntë vjet e nëntë ditë që nga dita kur u nisa në luftë dhe i dhashë leje vashës sime të martohet.

- Çfarë më lë peng, o Ymer Agë, që të të liroj.

- Unë s'kam pasuri, o mbret, por po të lë besën time. Pas tri ditësh do të kthehem përsëri këtu.

- Pa ta shohim, sa e mbani besën ju shqiptarët! - u tall mbreti dhe dha urdhër që ta lironin.

Tërë ditën e tërë natën udhëtoi Ymer Aga mbi kalë. Kur arriti në shtëpi, nusen po e merrnin krushqit. Ai i tregoi asaj nishanin në vetull e në sqetull dhe nusja iu hodh e lumtur në krahë e pastaj këndoi:

Udha e mbarë, o krushq bujarë, se unë njoha fatin e parë...

Ymer Aga u kthye përsëri në burg. Rojet e kështjellës u çuditën kur e panë, ndërsa mbreti i tha:

- Ta gëzosh lirinë, o Ymer Agë shqiptari, se e meriton atë!

(Legjendë shqiptare)

Flamuri magjik

Kur u gdhi, njerëzit panë të ngazëllyer në majën e një katedraleje flamurin kuqez. Ai valëvitej me forcë nga era e veriut. Pas pak armiku filloi ta gjuante me topa.

Në rrugët e zbrazëta, ku bënë hije vetëm ushtarët e huaj, vrapoi një djalë. Kur arriti tek at Gjergj Fishta, i tha me lot në sy:

- Atë, po e gjuajnë me topa flamurin tonë...

- Ani, mos qaj, biri im. Është në nderin e flamurit ta përshëndetin me breshëri.

Të nesërmen djali shkoi prapë tek at Gjergj Fishta.

- At, flamuri u dogj e shtiza u rrëzua.

- Ani, mos u mërzi, biri im. Ai është flamur magjik. Do të mbijnë prej tij flamuj të tjerë.

Atë natë në çdo shtëpi shkodrane valëvitej një flamur kuqez.

Të nesërmen djali vrapoi përsëri te atë Gjergji.

- At, - i tha i emocionuar, - kanë mbirë kushedi sa flamuj. Kishit të drejtë. Ai ishte flamur magjik.

Gjergj Fishta e puthi djalin në ballë. Tek po e përqafoje, me dashuri i tha:

- Ja, edhe në zemrën tënde të vogël paska mbirë një flamur.

Djali u çudit, kur pa në dorën e tij një flamur. Pastaj e përqafoi i lumturuar atë Gjergj Fishtën.

Pandeli Koçi





Pyetje rreth tekstit

1. Çka panë mëngjesin e parë njerëzit në majën e katedrales?
2. Çka i tha djali at Gjergj Fishtës:
mëngjesin e parë,
mëngjesin e dytë,
mëngjesin e tretë?
3. Cilat janë përgjigjet e Fishtës në të tria rastet?
4. Si iu përgjigjën qytetarët armikut që u dogji flamurin?
5. Pse Fishta i tha djalit: *Dhe në zemrën tënde ka mbirë një flamur!*

Fjalorth

katedrale - →
top - armë lufte
at - prift



Kthehu te teksti

- a.
Gjej dhe lexo fjalitë ku përmenden fjalët *veriu, nder, magjik, ka mbirë*.
- b.
Sa herë përmendet në tekst fjala *flamur* në numrin *njëjës* dhe sa herë në numrin *shumës*? ____
Sa herë përmendet në tekst fjala *kuqezi*. ____

Plotëso

Në zemrën e djalit ka lulëzuar:
flamuri (Cili?)
guximi (Për çfarë?).....
urrejtja (Kundër kujt?).....
dashuria (Për kë?)

◆ Shiko si formohet kjo fjalë:

KUQ + E+ ZI = kuqezi





Himni i flamurit shqiptar

Flamuri është shenja dalluese e çdo kombi.

- A të pëlqen flamuri shqiptar? Pse?



“ Mësoni ta këndoni së bashku me mësuesen **himnin kombëtar**.

Kur këndohet ky himn,
ngrihemi në këmbë në
shenjë nderimi.

Fjalët e himnit i ka shkruar
poeti Aleksandër Stavre

Drenova (ASDRENI)

(1872-1947)

Rreth flamurit të përbashkuar
me një dëshir' e një qëllim
të gjith' atij duk' ju betuar
të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet,
që është lindur tradhëtor,
kush është burrë nuk frigohet
po vdes, po vdes si një dëshmor!



- Cilave shtete u përkasin flamujt e mëposhtëm?
(*Italisë, Gjermanisë, Maqedonisë, Kosovës, Bashkimit Evropian*)
- Ku ndryshojnë ata nga njëri-tjetri (nga ngjyrat, figurat, shenjat)?





Kështjella

Tregim me figura



1
Ishte shek. XV. Ushtria osmane me në krye Tursun Pashën u përgatit të pushtonte një nga kështjellat kryesore të Arbrit, kështjellën e Krujës.



2
Shqiptarët, të udhëhequr nga Skënderbeu, u përgatitën të mbrojnë kështjellën. Çadrat e turqve mbinë rreth kështjellës si kërpudha të helmatisura.



3
Mbi kullat e kështjellës shqiptarët kanë dalë e po veshetrojnë ushtrinë më të fuqishme dhe më të egër të kohës.




4
Kryekomandanti turk ka mbledhur Këshillin e Luftës. Ata vendosin t'u kërkojnë kështjellarëve të dorëzohen.

5




Por përgjigja e
kështjellarëve është e prerë:
- Largohuni nga keni ardhur!

6



Sulmi filloi.
Mijëra shigjeta fluturuan mbi
muret e kështjellës.

7



Kështjellarët që nga
bedenat gjuajnë me
shigjeta dhe hedhin zift të
përvëlur mbi armiqtë.

8



Shumë ushtarë turq
rëzohen nga shkallët.



9
Megjithatë sulmi vazhdon. Në luftë futen reparte të reja me ushtarë, që mbajnë lart flamurë turq.



10
Po asnjë flamur turk nuk arrin dot të vendoset mbi bedena. Mijëra ushtarë janë vrarë.



11
Për të mos humbur më ushtarë Tursun Pashai jep urdhër që ushtria të tërhiqet.



12
Në kullat e kështjellës kështjellarët kanë dalë e vështrojnë armiqtë e mundur. Flamuri shqiptar valëvitet lart.

*Ismail Kadare
Ilustrimet: Naxhi Bakalli*

Vjersha

Kjo është një vjershë që ka shkruar shoku juaj për Skënderbeun.

Skënderbeu
 Marrim një **S** si skifteri i fortë.
 Marrim një **K** si krenaria jonë.
 Marrim një **Ë** si ëndrrat.
 Marrim një **N** si nata e errët.
 Marrim një **D** si dielli i nxehtë.
 Marrim një **E** si era e fortë.
 Marrim një **R** si retë në qiell.
 I shtojmë **BE** në fund
 dhe ja ku del
 Madhështori **SKËNDERBE**.



Elsid Halili

Ushtrahu

1. Shkruaj një vjershë për **atdheun** sipas shembullit të shokut.

Marrim një **A** si *ajri i pastër*,
 Marrim një **T** si ,
 Marrim një **DH** si..... ,
 Marrim një **E** si ,
 Marrim një **U** si
 Dhe ja ku del i shtrenjti **ATDHEU**

2. Shkruaj një vjershë për mësuesen, sipas shembullit të mësipërm.

Marrim një **M** si mjalti ,
 Marrim një **Ë** si

Mbaj mend
 Vjersha shkruhet në vargje.
 Vargjet organizohen në strofa.
 Më shpesh strofat kanë 4 vargje.



GJYSHJA IME SEVASTI QIRIAZI

Në moshën 8-vjeçare u ndava përgjithmonë nga njerëzit më të dashur të familjes sime dhe nga gjyshja Sevasti. Ishte data 30 Gusht 1949. Gjyshja ndikoi shumë në edukimin tonë. Mbrëmjeve, para se të flinim, ajo na tregonte histori nga jeta e saj ose na përkthente nga anglishtja libra të mrekullueshëm, si: David Koperfildi, Oliver Tusti etj. Unë e dëgjoja e mahnitur duke ia ngulur sytë. Gjyshja ishte një grua e pakët në trup, me një fytyrë të ëmbël, vështrim të butë. Tani që jam e rritur çuditëm se sa e fortë dhe me vullnet ishte gjyshja ime si mësuese dhe politikanë e zonja.



tregonte, kur së bashku me vëllanë e saj, Gjerasimin, hapën shkollën e parë të vajzave në Korçë.

Për karakterin atdhetar të shkollës, Sevastia u ndoq nga armiqtë e Shqipërisë. Ata u përpoqën disa herë ta helmonin e ta vrisnin. Tri herë i vunë zjarrin shkollës, por njerëzit e mirë e lajmëronin dhe e mbronin atë. Kështu, kur shkolla digjej, armiqtë mendonin se bashkë me të digjej dhe trimëresha Sevasti. Por ajo ndodhej në gjysmën e rrugës për në Manastir e shoqëruar nga njerëz të

besës e patriotë. Dhe Sevastia, e ndihmuar nga këta njerëz, e çelte përsëri shkollën në gjuhën shqipe.

Nuk do t'i harroj kurrë historitë që ajo më

Vitore Dako



Mëso më shumë

Kjo pjesë është marrë nga **biografia** për patrioten Sevasti Qiriaz, shkruar nga mbesa e saj.

Teksti është **biografik** kur autori shkruan për jetën dhe veprimtarinë e një personi tjetër.

• Çfarë mësove ti nga kjo pjesë?

- Për cilësitë fizike të Sevastisë
- Për cilësitë e karakterit
- Për përpjekjet e patriotëve shqiptarë

Shkruajmë

Biografia

Kërkoju prindërve të tu ose gjyshërve të të tregojnë një ngjarje që u ka ndodhur atyre. Pastaj bëj dhe ti një **shkrim të shkurtër biografik**.

- Kur ka ndodhur
- Ku ka ndodhur
- Ngjarja
- Mbyllja.....



Të kuptojmë fjalët (Fjalori)

Kur mësojmë ose lexojmë një libër, një revistë ose gazetë, shpesh hasim fjalë që nuk i kuptojmë. Ndodh që nuk kemi pranë ndonjë të rritur të na i shpjegojë. Kujt duhet t'i drejtohem?

Për këtë na shërbejnë fjalorët.

Fjalori përmban fjalë dhe shprehje të ndryshme të gjuhës shqipe.

Këto radhiten sipas rendit alfabetik. Në krah të çdo fjale jepet shpjegimi dhe hollësi të tjera.



drejtshkrimi

shpjegime gramatikore

VERI, ~ **U** m.

Veriu - emër i gjinisë mashkullore, që mbaron me u në trajtën e shquar.

Kuptimi i parë

1. Pika e horizontit që është përkundrejt jugut, drejtimi në të kundërtën e jugut, ana që është në të majtë kur kthehem me fytyrë nga lind dielli. *Ylli i Veriut. Në veri të qytetit (të fshatit). Me dritare nga veriu. Sheh nga veriu. Fryn nga veriu. Vjen nga veriu. Busulla tregon veriun.*

Kuptimi i dytë

2. Vend që gjendet në këtë drejtim; banorët e këtij vendi. Veriu i Evropës (i Afrikës). Detet e veriut. Banorët (popujt) e veriut. Poli i Veriut. gjeogr. pika më veriore e rruzullit tokësor.

Fjala VERI,~U është **forma bazë e fjalës**.



Ndalo në fjalinë: Kryeplaku thërriste nga maja e karakollit me fuçi.

• Kërkoji në fjalor fjalët e nënvizuara.

Hap “Fjalorin e gjuhës shqipe”. Si do t’i gjesh në fjalor fjalët: karakoll, kryeplak, fuçi?
Kujtojmë rendin alfabetik.

a, b, c, ç, d, dh, e, ë, f g, gj, h, i, j, k l, ll, m, n, nj, o, p, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, xh, y, z, zh.

Në fjalor fjalët renditen sipas rendit alfabetik: në fillim janë fjalët që nisin me **a**, më pas ato që fillojnë me **b** e kështu me radhë: **acar, baba, cak, çantë** etj.

Për fjalët të cilat në fillim kanë të njëjtën shkronjë, renditja bëhet në bazë të shkronjës së dytë të fjalës (p.sh.: abetare, ankth, artist).

Fjala **k**arakoll gjendet para fjalës **k**ryeplak. Pse?

Në qoftë se edhe shkronja e dytë është e njëjtë, renditja bëhet sipas së tretës e kështu me radhë (dallëndyshe, dallgë, dallim).

Ushtr

1. Renditi fjalët sipas rendit alfabetik të çdo grupi.

- | | |
|--------------|--------------|
| laps | sallon |
| fjalor | sapun |
| banor | sallam |
| kuletë | satër |
| acar | salsiçe..... |
| dafinë | sahan |

2. Shkruaj formën bazë të çdo emri.

- vajzat
- kafshën
- pirunit
- kasetës



Andrea i vogël

Përveç mësimin të rregullt me vajzat, kisha edhe një grup të madh djemsh që vinin pas orës 4 pasdite. Nga prilli deri në fund të qershorit mësimin e bënim në oborrin e shkollës. Kënaqesha pa masë nga serioziteti dhe dëshira e tyre për të mësuar gjuhën e nënës. Numri i djemve sa vinte e rritej. U premtova se do t'u kushtoja edhe pushimin e mëngjesit e të pasdites. Gjithmonë vinin në kohë dhe prisnin pas dere sa të vinte ora e caktuar. Mësimin s'donin ta humbisnin për asnjë arsye. Kështu që përveç vajzave, pata mundësi të mësoja edhe një numër të madh djemsh. Mirënjohjen e shprehnin me dëshirën e madhe për t'ua treguar edhe të tjerëve forcën e alfabetit të gjuhës shqipe.

Një ditë, aty nga fillimi i pranverës së vitit 1896, më vjen në shkollë bashkë me djalin e saj tetëvjeçar nëna e tri nxënëseve, që u jepja mësim. M'u lut ta regjistroja si nxënës të rregullt. Me gjithë dëshirën e tyre të bukur, i thashë se nuk mund të shkelja rregulloren e shkollës. Por sytë e djalit më bënë që t'u them: "Do të mendohem përsëri". Djali mori zemër nga fjalët e mia dhe të nesërmen u ul në një bankë me të motrat. Kur hyra në klasë, nuk e vura re. Por me të mbaruar apelin, befas dëgjova një zë të brishtë nga fundi i dhomës: "Të lutem, mësuese, ma vër dhe mua emrin! Andrea më quajnë!" Më vuri para faktit të kryer. Nuk desha t'ia prishja qejfin e t'ia shuaja dritën e syve të lumtur. E pranova si një rast të veçantë. Dhe vërtet, ai ishte aq i vogëlth, por shumë i zgjuar. Gjithnjë përpiquej të ishte i rregullt si shenjë mirënjohjeje për të mirën që i bëra.

Kjo pjesë është marrë nga **Autobiografia** e Sevasti Qiriazit.

Autobiografi quhet teksti që autori e shkruan për jetën dhe veprën e tij.

1. Çfarë të dhënash të tjera mësove nga ky tekst:

- për shkollën shqipe,
- për nxënësit e asaj kohe,
- për mënyrën si zhvillohej mësimi?

2. Siç e vure re, tani portreti i gruas së shquar shqiptare po bëhet më i plotë. Ngjarja që e tregon vetë autorja zbulon një anë të shpirtit të saj të mrekullueshëm. Plotësoje me shkrim portretin e saj.

• Shiko fotot e mëposhtme. Janë marrë nga filmi "Mësonjëtorja", që i kushtohet Sevastisë dhe motrës së saj.



- Bisedoni me mësuesen/in për ngjarjet e filmit, aktorët që luajnë rolet etj.
- A ka skena të ngjashme me shkrimet që lexuat? Ç'tregon kjo?



Fjalë të urta

Fjalët e urta janë krijuar nga mësimet që dalin prej përvojës së jetës.

Fjalët e urta kalojnë gojë më gojë e brez pas brezi.

Mesazhet e tyre janë të rëndësishme për çdo kohë.

- Plotësoji me fjalë të tjera më të thjeshta këto fjalë të urta:

- Të vërtetën mbroje burrërisht.
Duhet të jesh i singertë.
- E vërteta nuk mbytet në ujë, as nuk digjet në zjarr.
Të vërtetën nuk e mbulon dot.
- Një bletë e vetmuar, nuk bën dot shumë mjaltë.
Vetëm nuk mund të arrish asgjë.
- S'ke shok, kërkoje ta gjesh; e gjete, ruaje.
.....
- Edhe një gotë ujë që të jep shoku, është më e ëmbël se mjalti.
.....
- Shoku të kundërshton në bisedë, armiku veç të pohon.
.....
- Mos e njih shokun për tri ditë, por për tre vjet.
.....
- Një shok i vjetër është më i mirë se dy të rinj.
.....
- Nuk shkruhet me penë, por me mend.
.....
- Dija është dritë, padituria është errësirë.
.....
- Zogun e zbukurojnë pendët, njeriun mësimi.
.....
-

Mblodhi: Jorgji Kodra

Poezia në dialekt

Naim Frashëri

Nuk e harron mëmëdhenë

Njeriu kudo të rronjë
 Nuk e harron mëmëdhenë
 Zogu le të fluturonjë,
 Po në mënt e ka follenë.
 Uji sado që të ngrihet,
 E të hapetë ndë erë.
 Të mblidhetë e të shtrihet,
 Prap mbi dhet do të bjerë;
 Ngado të vejë e të bredhë,
 Të ndryshohet e të ndrrohet,
 Prap mbi dhet do të rrjedhë,
 Veç atje mund të qetohet.

Andon Zako Çajupi

Robëria

E dashura mëmëdhe,
 Të dua dhe kshtu si je!
 Po kur të të sho të lirë,
 Do të të dua më mirë.

Qani pyje, fusha, gurë,
 Qani male me tëborë!
 Shqipëria mbet e gjorë
 Dhe nukë she dritë kurrë;
 Një mjegull keq e shkretë
 E ka mbuluar për jetë.

E dashura mëmëdhe,
 Të dua dhe kshtu si je!
 Po kur të të sho të lirë
 Do të të dua më mirë!

Gjergj Fishta

Gjuha shqipe

Porsi kanga e zogut t'veres,
 Që vallzon n'blerim të Prillit;
 Porsi i ambli flladi i eres,
 Që lmon gjit e drandofillit:
 Porsi vala e bregut t'detit
 Porsi gjâma e rrfës zhqjetare,
 Porsi ushtima e nijj termetit,
Njashtû â' gjuha e jonë shqyptare.

Ndre Mjeda

Guxo


Lundërtari që s'rezikohet
 Kur asht' deti shkum' e valë,
 Vetë me vedi mos t'ankohet
 Se i shkoi dita pa fitim.

Tuj u tall' e tuj pritue
Kurrqjasend nuk qitet n'dritë;
 Çfarëdo sendi me fitue
Trimni lypet e guxim.




Pyetje rreth tekstit


Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Andon Zako Çajupi, Ndre Mjeda janë shkrimtarë të mëdhenj shqiptarë dhe figura të shquara të Rilindjes sonë Kombëtare. Gjithë jetën e tyre ata punuan për pavarësinë e vendit, kulturën shqiptare dhe gjuhën shqipe.



Naim Frashëri



Gjergj Fishta



A. Z. Çajupi



Ndre Mjeda

1. Përse flasin poezitë e mësipërme?
2. Flisni për mesazhet e rëndësishme që na sjellin poetët.
3. Pse këto mesazhe janë shumë të vlefshme dhe në ditët tona?

Kthehu te teksti

4. Me ndihmën e mësueses/it shkruaji sipas drejtshkrimit fjalët dialektore

P. sh.: Toskërisht

të rronjë

Me drejtshkrim

të rrojë

Gegërisht

i ambël

Me drejtshkrim

i ëmbël

Detyrë

- Zgjidh poezinë që të pëlqen më shumë dhe mësoje përmendsh. Kujdes, duhet të respektosh veçoritë e të folmeve dialektore.



Dialektet e gjuhës shqipe

Gjuha shqipe ka **dy dialekte**: toskërishten dhe gegërishten. Në pjesën jugore të Shqipërisë flitet dialekti i toskërishtes, ndërsa në pjesën veriore, në Kosovë, si dhe te shqiptarët e Maqedonisë e Malit të Zi flitet dialekti i gegërishtes.

Dialektet e gjuhës shqipe janë shumë të rëndësishme. Ato janë pasuria më e madhe e gjuhës shqipe. Sa më mirë t'i njihni ato, aq më mirë do t'i kuptoni dhe do t'i shijoni veprat e bukura të shkrimtarëve shqiptarë.

Dallimet në dialektet e shqipes nuk janë të shumta.

Ato vihen re: **në përdorimin e tingujve (fonetikë)**

Fjalët me **â** (hundore) të gegërishtes

në toskërishte shqiptohen me **ë**. P.sh.:

nânë	nënë
âsht' (â)	është
âmbël	ëmbël
kânga	kënga
gjâma	gjëmë

Fjalët me **-n-** ndërmjet dy zanoreve

në toskërishte shqiptohen me **-r-**:

ve <u>n</u> a	ve <u>r</u> a
trim <u>n</u> i	trim <u>r</u> ë
ra <u>n</u> a	r <u>r</u> ë

Ndryshon shumësi i emrave mashkullorë:

brina	brinjë
demela	dembelë
pusa	puse

Disa fjalë përdoren vetëm në gegërishten

ose vetëm në toskërishten:

dryn-çelës, ftyr- ftyrë
 rren-gënjen
 shpin-shplodh
 tinëz-fshehurazi
 tlyn-gjalpë
 kry-kokë



Kthehu te teksti

- Lexo edhe një herë me kujdes poezitë.
Me ndihmën e mësueses/it gjej dallimet ndërmjet dialekteve.



Lulja ma e bukur

Lule e kishte emnin dhe lulet i donte. Në kopshtin e lulzuem dukej si lule e gjallë që shetiste me përshëndet lulet e tjera. Lulja ende s'ishte rritë për shkollë, prandaj, sa herë që ndalej diku, i kthehej s'amës dhe e pyeste:

- Ç'ka asht kjo?

Nana: Lule, Lulja ime.

Lulja: Pse lule?

Nana (tue qeshë): Sepse asht e bukur si ti. Shife sa ngjyra ka...

Lulja: Kush po këndon kështu, nanë?

Nana: Zogu, bija ime!

Lulja: Pse po këndon?

Nana: Me të gëzue ty, zemra ime.

Lulja: Pse bie shiu, nanë?

Nana: Të rriten bimët, të rriten lulet.

Lulja kqyrë retë e denduna, kqyrë botën për qark dhe merr frymë thellë. Mandej pyet:

Lulja: Nanë, a mundem me i pasë unë të gjitha lulet?

Nana: Oh, bija ime... Në botë ka shumë lule: të bardha, të kuqe, të kaltra, me pika, me erë të këndshme... yh, yh, sa ka... ti ke lulet e kopshtit tonë. Kur të rritesh, mbill edhe të tjera...

Lulja: A i kanë edhe të tjerët lulet si na?

Nana: Po, lulja e zemrës sime.

Lulja: A njisoj, njisoj?

Nana: Njisoj...

Lulja: Oh, sa mirë! Edhe ata gëzohen si unë...

Nana: Po, bijë, edhe ata gëzohen, sepse edhe ata jetojnë si ti në kët vendin tonë...

Lulja: Ku asht vendi, nanë?

Nana: Qe, ku ke shkelë, ku po rrin në kambë, te dera, jashta derës, andej kah vijnë e shkojnë njerëzit, automobilat dhe aeroplanët që fluturojnë në qiell...

Lulja: Oh, sa i madh qenka... (Lulja mendohet edhe këqyr kah kopshti). A ka lule atje ku po thue ti?

Nana: Ka bijëz, ka gjithfarë, por vetëm njana asht ma e bukura...

Lulja: Ma e bukura?... Cila?

Nana: Ajo që ka çelë n'atdheun tonë, ajo që gjindet në zemrën tande, në zemrën time,



Lulja: Si asht ajo, nanë?

Nana: Ajo asht ma e bukura, ajo i ka pesë flaka të kuqe, ajo nuk mbillet në tokë, Lulja ime, ajo asht mbjellë në zemër... Ajo rritet me ty dhe me gjithë fëmijët e vendit tonë. Ajo zbukuron kopshtin e jetës s'atdheut tonë... Kur të shkosh në shkollë, do t'ia mësojsh edhe emnin.

Lulja (hidhet në krahët e nanës): Oh, sa po due që të shkoj në shkollë e të mësoj për lulen tonë ma të bukur.

Tajar Hatipi

Pyetje rreth tekstit

1. Si quhet vogëlushja? Me kë ngjason ajo?
2. Ç'përgjigje i jep nëna së bijës:
 - për lulet,
 - për zogun,
 - për shiun?
3. Çka dëshiron Lulja?
4. A gëzohet ajo që edhe njerëzit e tjerë gëzojnë?
Ç'tregon kjo, që Lulja është:
zemërngushtë apo zemërgjerë?
5. Çka mbillet në zemër:
lulja apo dashuria për vendlindjen? Lexo me zë të lartë fjalët e nënës që e tregojnë këtë.

Plotëso

- a. Si ia shpjegon nëna Lules se cili është *vendi*?
vendi ku ke shkelë

VENDI

.....
.....
.....

- a. Shkruaj disa emra njerëzish që e kanë origjinën te emrat e luleve dhe bimëve:
Mimoza, Trëndafile,,,

Detyrë

Lexojeni pjesën në **role**: nënën – mësuesja, ndërsa Lulen – një nxënës. Shqiptojini bukur fjalët në dialektin e gegërishtes



Gjuha standarde shqipe

Ju u njohët me disa krijime në të dyja dialektet, që janë shkruar shumë kohë më parë. Ato tingëllojnë bukur, por ndryshojnë nga gjuha që ju mësoni në shkollë, dëgjoni në televizor ose lexoni në gazeta e revista. Poezitë: *Nuk e harron mëmëdhenë* dhe *Robëria* janë shkruar në toskërisht, kurse poezitë: *Guxo* dhe *Gjuha shqype* dhe tregimi *Lulja ma e bukur* janë shkruar në gegërisht.

Po ne ç'dialekt mësojmë, do të pyesni ju? Ju mësoni gjuhën standarde shqipe, e cila është mbështetur mbi këto dialekte.

Për gjuhën standarde shqipe gjuhëtarët kanë punuar për një kohë shumë të gjatë. Në vitin 1972, në Tiranë, u mbledhën gjuhëtarët nga të gjitha viset shqiptare dhe mbajtën Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Aty u vendosën rregullat e gjuhës standarde. Kjo gjuhë përdoret si gjuhë zyrtare në të gjitha trevat ku jetojnë shqiptarët.

Gjuha standarde përdoret në mjedise publike: në shkollë, në shtyp, në televizion, radio dhe në të gjitha dokumentet zyrtare.



Kali i drunjtë

Një degë peme të mjafton
 ta bësh kalë me katër këmbë,
 ta shalosh, të rendësh rrugëve
 si kalorësi më i shpejtë.
 Më i zoti i gjithë kalorësve
 të kaptosh male, lumenj
 që vetëm ti i sheh me sy.
 Të çash si trim nëpër beteja
 midis shpatash e hingëllimash
 që i dëgjon veç veshi yt...
 Vrapo, vrapo, o vogëlush,
 më vonë do të vijë një ditë,
 kur "kali" do të jetë thjesht degë,
 "fusha e betejës" - një lëndinë,
 "shpatat e tua" - copa druri...
 Vrapo, vrapo, o vogëlush!

Ndoc Papleka



Pyetje rreth tekstit

1. Çfarë i propozon poeti fëmijës që të bëjë me një degë peme?
2. Çka do të kuptojë fëmija me kalin e tij?
3. Ku realizohen ato që thotë poeti:
në realitet apo në fantazi? Pse?
4. Lexo me zë vargjet ku poeti i bën thirrje fëmijës. A të pëlqejnë ato?
5. Për çka e paralajmëron poeti fëmijën?

Plotëso

	Në botën e fëmijëve	Në botën e të rriturve
Dega është
Kali i drurit
Fusha e betejës
Shpatat e drurit
Unë	<i>kalorës, hero</i>	<i>njeri i zakonshëm</i>

Punë në grup

Ku ju shpie fantazia në lojërat tuaja.



Krijojmë një personazh

Karlo Kolodi ka krijuar personazhin e Pinokut, që është i njohur nga të gjithë fëmijët e botës.

Shiko figurën.

1. Si e krijoi Xhepeti djalin e tij prej druri?

Shkruaj disa nga veprimet që bëri ai.

Mori një copë dërrasë dhe mjetet e punës së marangozit.

.....

.....

.....

.....

.....

- Krijo dhe ti një personazh.

1. Përcakto se çfarë tiparesh fizike dhe të karakterit do të ketë personazhi yt.

2. Gjeji një emër origjinal dhe tërheqës.

3. Për ta bërë historinë më interesante takoje personazhin tënd me një tjetër që ta shoqërojë në vende fantastike.

4. Pikturoje personazhin tënd.






Filmat me kartonë

Princesha dhe Hëna



Ky është një film shqiptar, i cili flet për një vajzë të vogël me emrin Dea. Ajo u nis për në Hënë së bashku me lepurushin e saj, Lulunë. Vëllai i saj, Arbi, shkoi për të kërkuar motrën me mikun e tij, Bufin. Në Hënë ata kaluan aventura shumë të bukura dhe zunë miq të rinj. Pas disa kohësh ata u kthyen në Tokë, ndërsa Hëna i përshëndeste me mall nga larg.



Për të përgatitur **filmin me kartonë**, marrin pjesë shumë veta. Dikush shkruan pjesën, (skenarin) dikush bën ilustrimet, dikush xhiron, dikush bën muzikën e filmit, të tjerë ia përshtatin zërin e tyre personazheve të filmit etj. Të gjithë drejtohen nga regjisori.

1. Shiko fotografitë e marra nga filmi dhe fol për to?

- A të pëlqejnë si janë vizatuar personazhet?
- Po mjedisi përreth?
- Të pëlqejnë ngjyrat që kanë përdorur piktorët?

2. Po ty të pëlqejnë filmat me kartonë? Pse?

- Trego për njërin prej tyre.
- Cilat janë personazhet?
- Çka bëjnë ato?
- Si përfundon filmi?



Skenarist: Ergys Faja

Piktorë: Ardit Faja, Migena Papajani

Regjisorë: Ergys Faja, Bert Shijaku

Tinguj dhe ngjyra



Të flesh në verë

Në dimër unë zgjohem me natë
Dhe vishem me dritë të bardhë,
Në verë ndryshon puna krejt
Më duhet të fle më shpejt.



Më duhet të shkoj në shtrat e të shoh
Pemët e zogjtë që luajnë mbi to,
Të dëgjoj zërat e njerëzve nëpër rrugë
E hapat e tyre të rëndë me zhurmë.

A s' do ta kishit të vështirë dhe ju,
Kur qielli është kaq i kthjellët dhe blu,
Që kur të donit të luanit dhe pak
T'ju dërgonin kaq herët në shtrat?

Melsi Qirici



Po ti?

- A je ndier dhe ti si fëmija e kësaj poezie? Pse?
- Ç'janë ato gjëra që të lënë pa gjumë në verë?
- Mësoje përmendsh poezinë.



Përshkruajmë verën

- Përshkruaje me fjalë stinën e verës sipas modelit që ke mësuar.
Fol për: tingujt, ngjyrat, aromat dhe aktivitetet që bëhen në verë.

